


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

84H-32  
K 95

STAVRI KRISTO  
RRUGA GJER TEK  
YJET  
NOVELE



814-32


K 95

STAVRI KRISTO

# RRUGA GJER TEK YJET

Novelë

1927



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

*Kjo novelë fitoi çmim të parë në konkursin  
e 30-vjetorit të Ushtrisë Popullore*

*Parti, nënë Parti,  
sa lart që na ke ngritur!*

V. S.

## KUJTIME, KUJTIME...

Mbrëmë të kujtova përsëri. Thonë se koha i shlyen kujtimet, se në trurin e njeriut ndodh si në një vitrinë librarie, ku librat e rinj u zënë vendin të vjetërve... Po s'është kështu. Ç'gur i ri, ç'qemer, qoftë edhe i skalitur me mjeshtëri, mund t'i zërë vendin gurit të qoshes në themelin e një godine! Nuk harrohen kujtimet e fëmijërisë, jo!

Ja, mbrëmë të kujtova përsëri...

Po lexoja përbledhjen «Yje të pashuar». Më tërhoqi pa masë një shkrim për një dëshmor të Luftës nacionalçlirimtare.

...Një herë, andej ngà fundi i pranverës së vitit 1943, njësiti guerril i një qyteti të njojur s'kish-te mundur të hidhte në erë një urë shumë të rëndësishme që e lidhte atë me tërë krahinën. Dy orvatje të guximshme kishin dështuar. Se ura ruhej ditë e natë. Se në të dy krahët e saj krekoeshin, si përbindësh me dhëmbë të skërrimitur, dy bunkerë me nga katër gryka mitralozi secili. Se ajo ndriçohej

tejendenë, poshtë e lart, nga dy projektorë të më-dhenj, që kryqëzonin fashat e dritës si dy shpata të zjarra mu në mes të saj.

Por ura duhej hedhur në erë dhe këtë aksion e paskësh marrë përsipër anëtarë më i ri i njësitet, një punëtor gjashtëmbëdhjetëvjeçar i punishtes së gazozave, i së vetmes fabrikë të atij qyteti.

Dhe e kishte hedhur urën në erë!

«Një ditë, në ditët e para të verës, përpara punishtes ishte mbledhur një grumbull njerëzish. Një fashist po fliste i shqetësuar, me këmbë e me duar, dhe, pasi përplasi përtokë me inat shishen e përgjysmuar të gazozës, tregonte me gisht djaloshin që i kishte rrëmbyer motorin dhe po bëhej erë.

— Ta sjell, ta sjell ai, mos u bëj merak — e qetësonte fashistin dikush. — E njoh unë atë çamarok. Ja, do të bëjë një xhiro dhe do të vijë... .

Por djaloshi nuk u kthye... Pas dhjetë-pesëmbëdhjetë minutash të gjitha dritaret e qytetit u tronditën nga dy shpërthime që buçiten vërtik, njëri pas tjetrit, si dy gjëmimet e para të një shtrëngate në mes të verës. Dhe kudo u përhap lajmi: «Urën e madhe e hodhi në erë djaloshi që i rrëmbeu motorin fashistik. Ai kishte ngarkuar dy arka me dinamit, i kishte vënë se cilës nga një fitil. Me t'u afruar te postbloku i ndezi fitilat dhe ia shkeli me gjithë shpejtësinë. Arkën që mbante përpara e hodhi mu te këmbët e rojeve, në të hyrë të urës, tjetren, atë me fitilin më të gjatë, në të dalë... Fashistët në fillim e humbën fare toruan, pastaj e morën veten dhe filuan ta qëllonin. Por më kot. Ura fluturoi dhe ata s'panë nga vajtë nën breshërin e dendur të ciflave të gurëve dhe të betonit... .

Motorin e gjetën fill pas kthesës, ndanë kodrës, me rrrotat përpjetë. Gomat qenë bërë shoshë nga plumbat. Një vazhdë gjaku të shpinte gjer te lumi dhe pastaj zhdukej...»

Lexoj. Autori i shkrimit më çoi në një kasolle barinjsh, ku djaloshi, për tri javë rresht, kishte shëruar dy plagë të rënda dhe, më në fund, së bashku me të zotin e saj, baba i katër fëmijëve, kishte dalë partizan. Se fjala e tij, si trimëria e tij, ishte kushtrim...

Dhe mua m'u kujtove ti. Të them të drejtën, nuk e vura re qysh në fillim se kush qe dëshmorë. Por, edhe sikur ta kisha lexuar më me kujdes, çfarë do të më thoshte mua ai emër e mbiemër: «Thoma Stefan Gunëziu. 1928-1944». Kaq.

Mbiemrat, kur kemi qenë të vegjël, i përdorim aq rrallë, sa pothuajse nuk ia dinim fare shokushokut. Emrat i shkurtonim; për njëri-tjetrin s'ishim veçse Tili e Talo, Gogo e Çome. Dhe rrallë, kur hynim në gojën e ndonjë të rrituri, na shtohej edhe emri i babait e bëheshim Taloja i Tilit dhe Gogoja i Telos, se edhe baballarët na plakeshin me emrat e fëmijërisë. Po ty nuk të thërrisin as kështu. Ty të thërrisin thjesht: Çome ose Çomja i Savyës. Ty të shtonin emrin e nënës, se babai të kishte vdekur shpejt, se as ti, as ne nuk e kishim parë kurrë babanë tënd, as në fotografi. Se ai edhe fotografinë e vetme, atë të letrës së njoftimit, e kishte marrë me vete, në fund të detit...

Në fillim as fotografia nuk më tha gjë. Një djalosh thatim, me një triko leshi, pa xhaketë, me një gjerdan fishekësh në mes, me një nagant pa këllëf, futur gjer te mulliri në rripin e gjerdanit dhe me patickën e gjatë në sup, të zënë nga tyta, si bariu

kërrabën, me ca flokë të dendur mbi vetullat kaleshe... Një pikë e zezë në vend të hundës. Dy buzë të holla që s'kishin dalë dhe aq mirë në klishe... . Kaq.

Dhe vetëm kur iu ktheva fotografisë për të dytën herë, vetëm kur pashë dy pika të bardha, të vogla, shumë të vogla nën vetullat kaleshe, kur pashë atë vështrim ngulmues, të vetmen shenjë që kishte mundur të ruante prej teje klisheja, thirra:

— Po ky është Çomja, more, Çomja i Savës!

Menjëherë mora albumin e fotografive dhe që-ndrova gjatë mbi të vetmin kujtim që ruaj nga ti. Është ajo fotografia që dolëm kur morëm rrögën e parë. Të kujtohet? Ti nuk i kishe shumë qejf fotografitë dhe vetëm dhemshuria e malli për nënën të detyruan të qëndroje para aparatit. «Të çmallet e varfëra, the, se kushedi a do t'i bjerë rasti të na shohë më? Nga ai pusi ynë si zor është të dalim të gjallë!» (Ne punonim atëhere për hapjen e pusit të frigoriferit në punishten e gazozave. Na kishin zgjedhur ne, se ishim trupvegjël e mund të punonim njëkohësisht me kazmë e me lopatë...)

Kështu the dhe buzëqeshe. Ashtu si dije të buzë-qeshje ti: picërrrove sytë dhe lëshove paksa buzën e poshtme.

Pastaj, si shkuam të një kushëriri yt, që do të vinte në fshat dhe i dhamë gjysmën e lekëve për në shtëpi, si blemë edhe nga një paqetë «Diamant» (ashtu kot, për ta ndjerë veten të rritur, se as ti, as unë nuk e pinim), ti deshe të më qerasje me birrë e shishqebap te Barraka e Molos. Ishe disa muaj më i madh dhe ngule këmbë të më qerasje ti. Por nuk e dije a do të na mjaftonin paret dhe, për të marrë

vesh çmimin, qëndruam një copë kohë sa pagoi njëri. Na vinte zor të pyesnim. As çmimin, as shijen nuk ia njihnim birrës. Dhe nuk e provuam dot. Nuk që për xhepin tonë. Po ti s'më le pa qerasur, blemë nga një gazozë, të kujtohet?

Pastaj ikëm dhe i paguam Colit paratë. Se na kishte ushqyer me bukë pesëmbëdhjetë ditë, veresie. Të kujtohet Coli? Po Pipi, të kujtohet?

Sa kam dëshirë të të ul përballë dhe të të them këtë fjalë. Më lindin dëshira me të vërtetë të çuditshme këto kohët e fundit. Dua të të përfytyroj dyzet-dyzetepesëvjeçar, me flokë të thinjur e të rënë paksa. Të të përfytyroj inxhinier në një uzinë mekanike, se për hekura e për motorë të qante syri. Të të përfytyroj hipur mbi motor: prapa gruan, në kosh fëmijët...

Po nuk të përfytyroj dot. Ti më del para syve vetëm kështu, si te kjo fotografi: më këmbë, me vështrim të ngulur në aparat (prandaj, sa herë marr fotografinë në dorë, ti më shikon ngultas, mu në bebe të syrit), duke buzëqeshur paksa ndanë buzës së poshtme. Dhe... si nuk e paskam vënë re më parë: në ballin e ngushtë, si një rrip toke rrëzë malit, të shoh dy rrudha, dy rrudha të lehta, si dy brazda të cekëta plori. Ja dhe flokët që të ngriheshin përpjetë, të dendur e kaçurrelë, i ke shtruar dhe i ke ndarë me vizë në mes... Unë vë buzën në gaz sa herë më shkojnë sytë te flokët e tu. Se më kujtohet ç'hoqe atë ditë për t'i shtruar; i krehe të lagur me shkumë sapuni. Ja, kështu përpinqem të të përfytyroj dyzet-dyzetepesëvjeçar dhe ti më del para syve me ato qillotat ushtarake, që i preve me thikën tënde me dorezë briri, gjer te gjunjët dhe prapë të rrinin

të gjata e të binin mbi këpucët e mëdha me qafa. Të kujtohet si i premë? «Mbaji!», më the dhe m'i lëshove në dorë. Vetë nxore thikën, more njerën këmbë, pastaj dhe tjetrën... Dhe e prera doli hundë-hundë, si pizhamet me dantellë të zonjës së fabrikantit. Kështu ke dalë dhe në fotografi. Ke përveshur mëngët dhe e qepura e supit të bie mu te bërryli. Se edhe këmisha të rrinte e madhe. Të gjitha të mëdha, të gjitha. Asgjë pas trupit. Sot, po të dilje asisoj në rrugë, do të të merrnin për ndonjë çamarok të veshur me rrobat e të et... Atëhere s'binim në sy. Kështu vishej sëra jonë... Me rroba të mbajtura, se ato kushtonin lirë; i shisnin fshehurazi ushtarët italianë për një paqetë cigare, për një shishe gazozë...

Ja, kështu të përfytyroj. Sa larg ishe ti nga ky djali me nagant, të futur gjer te mulliri në brezin e gjerdanit! E si të të njihja menjëherë?

Dhe, duke krahasuar të dyja fotografitë, më lindi dëshira të shkruaja për jetën tënde, që nuk ishte veçse fëmijëri. Se, kur hodhe atë urë në erë, ti apo kishe mbushur të gjashtëmbëdhjetat... E shikon ç'dëshira më lindin?

## II

### DARDHA E PRIFTIT

- *Dëgjo, unë nuk i lë ato dardhë t'i hajë prifti.*
- *Rri, o Çome, tani...*
- *Or, po s'i lë!*

Ne u habitëm nga fjalët e tua. C'po ndodhë? Ti, që nuk i kishe trazuar askujt një majë gjilpërë, ti, që të mburrnin në fshat, po na shtije në ngasje... Edhe vetë dardha e vëtmuar, në mes të asaj are rrëpirë, që i ngjante një fete të madhe buke midis dy mureve korre, na u duk sikur ngriu në vend nga ato fjalë. Nën dritën e hënës së plotë ajo dukej sikur ishte ngritur në majë të gishtave, si një nuse e re e zënë në befasi nga i ligu, sikur shikonte rrëth e rrotull e trembur dhe donte të çante, por s'bënte dot asnjë hap, nga frika se mos i roniteshin stolitë e arta vezulluese. C'ngjyrë u kishte dhënë hëna atyre dardhëve të arrira!

- *S'i lë, jo! Për nder të familjes...*
- *Po gjurmët? E sheh si e ka çapitur rrëth e qark dardhës? Kot e ka çapitur? Rri, o Çome, tani...*

Prifti e ruante si sytë atë korrikje. Thoshte se e kishte shartuar degën e një gorrice të egër. Se e kishte sjellë «kalemin» që nga Besarabia... Se prifti ynë kishte qenë i dalë. Ai qe dorëzuar prift vetëm pasi kishte plagosur një këmbë (disa thoshin se e kishin qëlluar ca barinj, kur kishte dashur të vidhët një dash, të tjerët thoshin se ia kishte thyer me kopan një nuse e re, që e kishte burrin në kurbet).

— Ore, më është mbushur mendja mua. Për eshtrat e atij, që s'i kam parë sytë... Po ç't'i bëj kësaj hënës, thuaj...

Ne s'po të njihnim. E dinim që nuk e kishe zakon t'i merrje gjënë tjetrit. Nuk e kishe as nga uria. Se në ata muaj ne silleshim të velur.

Ne vrisnim mendjen: Ç'kishe? Ç'të shtynte?

(Ti s'na tregove atëhere. Sa i mbyllur që ishe, bre Çome! Dhe unë e mora vesh vonë, shumë vonë shkakun. Dhe të dhashë të drejtë.)

... Sapo kishim ngrënë darkë dhe dolëm për të kullotur bagëtinë në arat e posakorrura, me velencat në sup e me gomarët për dore. Flinim jashtë. Kështu e kishim gjetur e kështu e lamë. Djemuria gjithë verës, gjersa zinin shirat në vjeshtë, flinte jashtë.

Fshati kishte mbetur prapa. Lart, te Qafa e Kuqe, sapo kishte dalë hëna. Gjithshka përreth, gjithë faqja e malit, shkëmbinjtë, muret e përhimta ndanë arave, shtëpitë prej guri me rrasha përsipër, ku shkël-qenin mijëra pika vese, kishin marrë një ngjyrë përrallore. Të thuash se hëna, me të dalë mbi atë faqe mali të gurtë, kishte hedhur një dorë nga pluhuri i saj i artë, e kishte bërë çdo gjë të kristaltë dhe tanimë rrinte e shikonte krenare, por edhe paksa e habitur. Edhe gurët e kalldrëmit, edhe trungjet e

pemëve, edhe gjethet, edhe foletë e zogjve dukeshin si prej qelqi. Tamam si në përrallat e gjysheve. Apo ajo dardha e vëtmuar e priftit me atë tokën e puanar rrëth e qark!

Dhe ne të dëgjuam ty: nuk shkuam tek arat e malit. Qëndruam aty. Vendosëm t'i kullotnim gomarët ledheve.

Shtruam velencat e arnuara. Toka përreth lëshonte një afsh të ngrohtë. Afshi binte mbi gurë e mbi rrasha e bëhej vesë. E vesa xixëllonte nën hënë. Dukej sikur toka djersitej nga lodhja. Se mezi mbaheshin arat, me thonj e me dhëmbë në atë faqe mali të pjerrët.

Dikush tregoi një përrallë. Tregova një dhe unë. Ti ishe shtrirë përkundrejt dhe me një fije kashte të thatë në buzë i kishe ngulur sytë hënës.

Dy herë me radhë të provuam, se na u duk sikur s'na dëgjoje, po ti të dyja herët na i përsërите fjalët e fundit aty ku e kishim ndërprerë. Vetëm kur të erdhi radha për të treguar vetë, u ngrite si i trembur e the:

— *E gjeta si do t'ia punoj!*

Dhe tunde kokën. Dhe picërrrove sytë. Dhe lëshove paksa buzën e poshtme.

— *Te livadhi, në shullë, éshtë lidhur gomari i Makes. Ai nuk e kullot atë se éshtë plakur. I biri sapo éshtë martuar dhe fle me çupën e priftit. E lidh me litar të gjatë në mbrëmje Makja dhe në mëngjbez e ndërron... Kush do të vijë me mua?*

Shkuam bashkë. Zgjidhëm gomarin. I hipëm të dy, ti në samar dhe unë në vithe. Kur arritëm te shokët, ata shikonin njëri-tjetrin të habitur. Ti nuk zbrite. More torbat tonë, kapërceve shtegun dhe iu afrove dardhës. Lidhe gomarin te dega e fundit

dhe iu qepe pemës. Veç kur na erdhe me katër torba të mbushura plot e përplot me dardhë të arrira. I zbraze larg, shumë larg, afër kullusmave. Dhe i mbushe përsëri e përsëri, gjersa dardha mbeti si një grua me flokë të shpupurisur, vetëm me nga dy-tri pare lart në ballë. Që nga ledhi me bar, gjer te rrënja e dardhës u mbush vendi me gjurmë gomari. Asnjë këmbë njeriu. Ne luajtëm me dardhët e priftit gjithë natën e natës. S'lamë gur e trung peme pa vënë në shenjë. Ndaj të gdhirë, morëm kafshët, i ramë fshatit përqark dhe hymë nga rruga tjetër, sikur kishim fjetur nga Kroi i Malit, lart te arat mbi Qafë, andej nga kishte dalë hëna.

Të nesërmen, kudo, në çesma e në puse, te sofatet e te lëmenjtë dëgjohej vetëm një bisedë:

- Gomari i Makës ka vjedhur dardhën e priftit.
- Uau! Ç'thua, vjedh gomari?!
- Gjurmë njeriu s'kanë gjetur.
- Do të ketë qenë qoftëlargu...
- Mirë thonë, në këtë botë lahlen të gjitha!

Prifti, bekciu e kryeplaku nuk kishin gabuar asnjë grimë. Ata i kishin njojur gjurmët, por, meqë ishin të gomarit të krushkut...

### III

## LARGIMI NGA FSHATI

Po atë vit ne të dy u larguam nga fshati. U larguam në vjeshtë, si mblođhém ftonjtë e qëmtuam arrët. I dhamë dorën njëri-tjetrit në mbrëmje, pranë avllisë së shtëpisë sime dhe lidhém fjalën: kush të dëgjojë gjelin e parë, të zgjojë shokun. Ne nuk e dinim atë çast se kishin lidhur fjalë me njera-tjetrën edhe nënët tonë, që donin të na përcillnin. Ato do t'i zgjonte Gore Qeraxhiu.

Po ti u zgjove para të gjithëve... Megjithëse, kush fjeti atë natë? Përgjonim këngën e gjelit të parë. Mua sa po më kishte zënë gjumi dhe s'të dëgjova kur thirre. U zgjova nga dora e vakët e nënës që më fërkonte në ballë.

— *Ngrehu, hë, bir...*

Ju po na prisnit jashtë, te avllia, gati për rrugë. Dhe ajo natë kishte goditur me hënë, veçse hëna nuk ishte e plotë; kishte filluar të thërmohet paksa në anën e djathtë dhe dukej e ftohtë. Gjithshka përreth ishte e ftohtë. Një ftohtësi që ta ndrydhëte

zemrën, të ngjallte një gjendje shpirtërore të nderë, një ndjenjë pasigurie.

Ylli i Karvanit ende nuk kishte dalë. Ndofta do të kishte qenë ora nga tre. Mëngonim. Nxitonim. Se domim që rrezet e para të diellit të na zinin përposh, në qytet. Se donim të shisnim sa më parë rakinë, mollët e ftonjtë pér të blerë një këmishë sateni që ta vishnim mbi fanellën e leshtë dhe ndonjë palë opinga... Se domim të prisnim biletën dhe të arrinim maqinën e vetime që nisej aq herët nga qyteti ynë i vogël. Se nënët që na përcillnin e gjithë pazarakët donin të kthehen shin përsëri në fshat, e rruga në kthim ishte më e gjatë, ishte e përpjetë...

U nisëm.

Lart — hëna paksa e ngrënë. E habitur. E ftohtë. Prapa — faqja e malit me brymë të praruar. Përpara — monopatet e thella midis dëllënjava, shkozave e mareve, errësira që përpinte njërin pas tjetrit pazarakët. Ne ecnim në heshtje. Ecnim e përtypnim vetëm një mendim: ç'na priste?

Rruja ishte e tatëpjetë. Diku prapa nesh pësh-përisnin dy gra të ngarkuara. Përpara trokitnin patkonjtë e mushkës së Gore Qeraxhiut dhe herë-herë, kur godiste që rrëshqisnin mbi faqen e lëmuar të ndonjë popli, lëshonin xixa. Thonjtë e pambathur të gomarëve tanë krijonin një ritëm monoton, si isojja e të shurdhit...

Ne ecnim në heshtje. Ecnim shpejt. Se e kishim pér turp të mos i ndiqnim kafshët këmba-këmbës e të mos u ndodheshim pranë në atë të tatëpjetë të sertë, ku mund të zinin kokën nën vete kur të doje, po të mos i mbaje fort pér bishti sa herë zbrisnin shkëmbinjtë shkallë-shkallë. Paçka se nuk na arrin-të gjoksi, kur u shtrëngonim bishtin as gjer te fundi i samarit. Ne ecnim...

Dhe, vetëm kur zbritëm ndanë Lumnicës, Gore Qeraxhiu theu heshtjen e tha duke qeshur:

— Ja këtë të keqe kanë këto rrugët tona. Vëtëm dy herë nuk u hipën dot kafshëve: kur zbret dhe kur ngjitesh...

Më kujtohet si tani: Ti vure buzën në gaz, ktheve kryet prapa, i hodhe sytë brinjës së malit, pe shpellën që zbardhte në atë mugëtirë dhe the:

— Ç'e përpjetë! Ja, kur rrokullisen gurët e çukës, këtu e mbajnë vrapin.

Dhe me të vërtetë, ndanë lumi, ku zbriste rruga malore, s'shihje gjë tjeter veçse popla që ishin mbështetur njëri mbi tjetrin e ngjanin si vezë të një shpendi përrallor.

— Gurët dhe njerëzit, bir. Gurët dhe njerëzit — përsëriti Gorja.

Pas pak, në një lëndinë, ndanë një gorrice, Gore Qeraxhiu dhe dy-tre pazarakë të tjera, që takuam rrugës, u ndalën për të 'ngrënë një çapë bukë, për të dredhur një cigare duhan dhe për të pritur gratë që vinin lehtë-lehtë me teliket e tyre të leshta duke thurur çorape, edhe pse kishin barrën mbi shpinë...

Ato erdhën. Thanë se nuk kapërcenin dot gjë dhe ne u nisëm përsëri. Tanimë rruga ndanë lumi ishte më e shtruar; frika se mos qorolliseshin kafshët kishte mbetur brinjës së malit dhe të gjithëve iu zgjidh gjuha. Filloi të bënte shaka me ne edhe Gore Qeraxhiu e të na porosiste që, me të dalë në xhade, të vinim nga një fijë kashtë në gojë, se zbrisnim për herë të parë në qytet e përndryshe s'do të na linte Arapi i Zi ta kapërcenim urën e madhe.

Ndërkaq ti nuk u përbajte:

— Na njeh ne Arapi i Zi, na njeh, se kemi ku-

*llotur gomarët me të atë natë që i vodhi qoftëlargu dardhën priftit...*

Gore Qeraxhiu u çel. Duke lënë t'i dukeshin dhëmbët e zverdhur (tanimë kishte zbardhur dhe ishin zhdukur pothuajse të gjithë yjet, me përjashtim të Yllit të Karvanit) midis mustaqeve të zeza dhe buzës së poshtme flakë e kuqe tha:

*— Tani që po ikni, do të më tregoni të drejtën. Kush nga ju e vodhi dardhën e priftit? Se nuk ia ka punuar njeri gjer tani kësisoj...*

Mua po më hante gjuha të kundërshtoja, po ti më ngule sytë dhe më buzëqeshe ndanë buzëve. Unë të kuptova mirë se ç'deshe të thoshe. Sigurisht dhe ata e dinin, se ajo ngjarje mori dhenë dhe tre gohej darkave edhe në fshatrat e tjera, e dinin se ishe ti, Çomja i Savës që ia kishe punuar aq bukur... Dhe të jepnin të drejtë. Po, ti kishe shumë të drejtë. Veç këtë gjë edhe unë, shoku yt më i ngushtë, po e merrja vesh vonë, shumë vonë...

## IV

### URATË, MË HUAJ NAVLLON...

Sava pothuaj e kishte harruar fare emrin e vet. Kishte dy vjet martuar në atë fshat të largët malor të Dangëllisë, kufi me Skraparin dhe askush nuk e thërriste me emrin e vajzërisë. Të shtëpisë e farefisi i burrit, madje edhe fëmijët e vegjël të kushërinjve të parë të Stefanit e thërrisinin vetëm «nuse». «Mirë mëngjez, nuse!», «Mirë dita, nuse!», «Natën e mirë, nuse!», «Nuse, më jep pak shtizat, janë aty mbi kamare!» «Nuse, më sill një gotë ujë!» «Nuse, po të qan djali!» Nuse, nuse, nuse! E gjatë, shumë e gjatë qenkesh kjo nusëria!

Edhe fshatarët nuk e thërrisinin kurrë në emër. Ata më të afërmit e thërrisinin: E Fanit, më të largëtit: Nuse e Stefanit. Savës iu deshën disa kohë që të mësohej edhe me këtë emër të dytë, siç i dukej asaj, të burrit. Fankën e saj, që kur ishte martuar të rriturit e thërrisinin Stefan...

Por Sava ishte e kënaqur me fatin e saj. Edhe kur kishte ndonjë volltë të paplotësuar, që i shqet-

tësonte kraharorin, kishte me se të ngushullohej: «Me fatin nuk hahet dot njeriu, thoshte, si të gjithë dhe unë».

«Si të gjithë dhe ne». Fjalë qetësuese për nënënat tonë, fjalë që u ruanin vështrimin e qetë dhe buzë-qeshjen eëmbël të nusërisë, gjersa u mbushej fytyra me rrudha ose gjersa u tretej ai vështrim e ajo buzë-qeshje nën curkën e lotëve dhe fytyrën ua mbulonte shamia e zezë...

Vetëm një gjë nuk e kuptonte Sava në ata dy-tre vjetët e parë të martesës: si ishte e mundur të ndryshonte aq shumë Stefanë i saj në sy të njerëzve?! I dukej sikur ata dy emra nuk ishin kot, sikur ajo kishte dy Stefanë: një në vetmi, natën, në jastë-kun e nusërisë, që e dëgjonte me vëmendje, që i mbështeste faqen me mjekrën, që sapo kishte filluar t'i forcohej në gushën dhe në gjoksin e saj, që shpesh në netët me hënë rrinte shtrirë në shpinë dhe ajo i shikonte sytë e zinj, vetullat kaleshe të ngjitura mbi hundën e gjerë, që herë-herë bashkoheshin e bëheshin një me flokët e dendur kaçurrelë, ku ajo guxonë të fuste gishtat e saj të argasur në punë, por të hollë e të ngrohtë... Një burrë i dashur, që dukej se do të ishte baba i dhemshur. Ajo e ndjen-te këtë sidomos kur ishte shtatzanë me djalin, kur ai i vinte dorën mbi bark, tregonte paksa dhëmbët e tij të bardhë sërë-sërë nën mustaqet e zeza e buzën e poshtme flakë të kuqe dhe e pyeste: «Ç'thotë ai kolopuci, bën zallahira atje brenda, apo jo?» Dhe ajo buzëqeshte, shkrihej në atë lumturi bashkëshor-tore, i ngjitej e i përkëdhelej si mace e butë dhe i thoshte, duke tundur kokën dhe duke ngritur lart vetullat e saj të holla: «Më vrau, Fankë, më shoi!» Dhe ai i përgjigjej po me atë ton: «Ah, pizevengu!

Prit, prit, duro dhe ca, pa ia tregoj unë qejfin. Ta marr unë hakun ty»! Ajo mbyllte sytë e lumtur. Mbështeste kokën mbi gjoksin e tij leshtor dhe e zinte gjumi. Kur zgjohej, e trembur se mos kishte kaluar koha për të ndezur zjarrin, ndjente te faqet e buta gishtat e tij si gëzhdalla lisi, që përpinqeshin ta fërkonin, ta ledhatonin, por e kruanin e, pse jo, nganjëherë edhe e gërvishnin... Po ajo nuk ia hiqte. I vinte dorën e saj përsipër dhe, duke e parë drejt në sy, i thoshte: «Kot më thua mua mace! Ti të gërvish!» E ai qeshte. Dhe ajo mendohej: «Ja ka argasur lëkurën kazma, sëpata, beli, dhiqeli. Se është punëtor Fania im!»

Dhe në këto çaste i vinte mirë, bile, që e thërrisin: «E Fanit». Po, ajo donte të ishte për jetë e tij, e tij...

Nga dilte pra ai Stefani tjetër: me buzët të mbledhura, me vështrimin përtokë, që çdo mëngjez, me të zbardhur dita, hante përsheshin në heshtje, hidhte kazmën në krah e nisej pa i thënë as «ditën e mirë?» Edhe kur thoshte «ditën e mirë», ai i drejtohej së ëmës dhe të atit që kishte zënë prej një viti kryen e vatrës, sepse i pat rënë një gur i madh mbi këmbë, kur hapte arën e re. Si nuk i ngriti sytë një herë ditën, xhanëm e ta takonte vështrimin e saj të përgjëruar për vështrimin e tij! Edhe kur ishte një herë në arë, tek hapte qilizmë atje, tek ara e re dhe ajo i shpuri bukën, prapë nuk e pa në sy. Buzëqeshi, por nuk e pa. Nguli kazmën, nxori këmbët nga dheu i shkrifët që kishte gërmuar, pastaj zbathi njerën opingë, e shkundi te gjuri, zباتhi dhe tjetren, e shkundi dhe atë dhe me sytë përdhe, duke e parë si i vëngër, i tha:

— Pse erdhe ti? S'kishte atje ndonjë fëmijë të më dërgonit drekën? Dhe ia mori boçen nga dora, e zgjidhi, e shtroi mbi dheun që nxinte më shumë midis guriçkave të bardha dhe u ul të hante me lugën e drunjtë që e kishte punuar vetë. E shoqja priti më këmbë gjersa mbaroi. «Grua e ngarkuar, me barkun te gryka. Po ç't'i bësh? Si të gjitha! Ç'është ai burrë që i flet gruas jashtë, në dy-tre vjetët e parë të martesës!»

Edhe një gjë tjetër i kishte mbetur maraz Savës: si nuk e mori një herë djalin në dorë, ta përkëdhelte! Vetëm një herë, një herë, natën vonë, ato ditë që do të largohej. Kur Savën e kishte zënë gjumi, ai qe ngritur, i kishte shkuar dorën me gishtat gëzh-dalla-gëzhalla djalit mbi faqet, qe ulur edhe e kishte puthur mu në ballë. Po dhe për këtë nuk ishte shumë e sigurt. Mos vallë kishte parë ëndërr? Se ishte zgjuar djali (sigurisht nga gëzh dallat e tij) dhe ai, me ta parë të shoqen ngritur, kishte thënë rëndë-rëndë: «Hë, moj, ngrehu! Nuk e dëgjon djalin që plasi?!!»

\* \* \*

— Dëgjo, Çome! Edhe për ty tjetrin i them këto fjalë — m'u drejtua Gore Qeraxhiu. — Këto mend të mbash edhe atje ku të vesh. Nënën të mos e harrosh. Unë e di ç'ka vuajtur ajo për të të rritur ty: me dy pleq të sëmurë në të dy kryet e vatrës. Dhe s'ia dëgjoi njeri zërin. Prandaj të bëhesh i mbarë! Dhe kurbeti është i rëndë, se mos e dish... Se i kam menduar të gjitha unë. Nuk e

kam lidhur fatin kot, timin e të fëmijës pas bishtit të kësaj mushke. Po ç'të bëjmë? Vetëm me fatin që nuk kapet dot njeriu! Se njeriu është si guri! I gjërryhet gurit nën vete dheu, i kalbet, a i këputet ajo rrënje dëllënje që e mban në vend të tij dhe ai rrokuilliset... E pe ti se ku e kishin mbajtur vrapi poplat e brinjës sonë? Kështu dhe njeriu.

Yt atë, ndjesë pastë, e filloj mirë. E hapi dhe arën e re, i ngriti dhe muret sipër e poshtë, e mbushi ledhin e sipërm me pjergulla dhe i hodhi lastarët mbi lisa, mbolli e ç'nuk mbolli! Do të rronit si ju.

Po se kush ia ngriti mendjen pér të shkuar në kurbet! Dhe gaboi. Nuk ia mbushi synë edhe ara e re. «S'të mban dot me bukë edhe kjo copë arë, o Gore, jo», më tha një ditë. «Tokë tjetër s'ke ku hap. S'bëhet ara kështu! Hiq gurët, shkundi... përzieje atë pluhur me gjethet e shkurreve... Ja, ajo është gjithë toka. Po më vjen keq se motin e kemi të mirë. Ja, edhe në të plasurat e gurëve mbin shkurrja e bari!» Ishte punëtor i madh. Duart flori i kishte. Po ç'e do, u gënjiye! E nxiti dhe sëmundja e të et. Iu ngrit mendja. Kishte shpresë mos fitonte shpejt e shpejt ca të holla. Se donte ta çonte të atin te doktorët, jashtë, në Janinë, në Stamboll. Po, po, ajo ia ngriti mendjen. Se ka qenë punëtor i madh dhe ai! Mos e shiko tani!

Edhe plaka ka qenë nikoqire e madhe. Pekmezi i saj, reçelejt e saj, turshitet e saj, armeja e saj! Posi, pos! Me nam në gjithë Dangëllinë! Ja, pyet kë të duash...

Dale, pa dale një çikë ta zë pér kapistre këtë xanxaren time unë. Se trembet nga maqinat kjo! — Shikoni djem, mos harroni fijen e kashtës, se

po afrohem. — Dhe Gore Qeraxhiu nxori përsëri dhëmbët e zverdhur midis mustaqeve të zeza dhe buzës së poshtme flakë e kuqe.

Kishim dalë tanimë në rrugën e automobilit, buzë Vjosës. Po qyteti ishte ende larg. Dhe kohë kishte. Rrezet e para të diellit sapo shkrepëtinë, ashtu të kuqërremta e plot ngrohtësi, sipër në majën më të lartë të Nemërkës.

Ne ecnim. Gore Qeraxhiu tregonte. Ne dëgjonom e ecnim.

Ecnim... Ne shkonim në kurbet. Eh, more Çome, q'më vjen tani për të qeshur, kur kujtoj ata dy vocërrakë që zvarriteshin pas karvanit të pazarakëve, duke u treguar më të rritur, me atë seriozitet të shtirë në fytyrat e njoma. Më vjen për të qeshur, edhe pse një ndjenjë e hidhur ma ndrydh zemrën.

Ne shkonim në kurbet...

E kujt i shkon tani ndër mend ajo kohë, kur njerëzit linin të dashurit e, në krahët e shpresave, që rrallë jetësoheshin, kapërcenin toka, dete e oqeanë për t'u kthyer pastaj «parallinj!» Paçka se ndonjërit mund t'i mbeteshin kockat andej! Paçka se ndonjerës do t'i tretej si qiri në vetmi rinia e bururia, duke nxjerrë nga goja e gjarpërit bukën për të ushqyer dy pleq të sëmurë dhe për të rritur fëmijën jetim. Kurbeti! As mua s'do të më shkonte mendjë kaq larg sikur të mos të të kujtoja atë natë ty. Sikur të mos kujtoja Gore Qeraxhinë, ato fjalët e tij:

— Në fillim, i ndjeri Stefan, i kërkoi të holla për navllon një kushërirë të tij që kishte vajtur më përpëra në Amerikë. I shkroi letër dhe i tha se do

t'ia lante atje, kur të vente. Iu lut t'i zinte edhe ndonjë punë ai i kushëriri. Po ai nuk i dërgoi para. I shkroi bile një letër të ashpër: «Rri, ha atë misér-nike aty, bukë e hi e në shtëpi, se s'ka ç'të duhet Amerika ty. Tani këtu është krizë. Miletin vuan përbukë, e grurin e djegin. Miletin pa sheqer e sheqerin e hedhin në det... » Kështu i pat shkruar ai i kushtëriri. «S'po bëjmë prokopi ne që jemi, po rri rehat», i shkruante ai.

Mirëpo ky Stefani ishte sedërli i madh, ndjesë pastë! E kam njojur mirë unë, se jemi rritur bashkë. Po t'i mbushej mendja për një gjë dhe s'pyeste më njeri ai pastaj. Iu mbush mendja dhe bitisi. Ishte e shkruar thua...

Dhe vendosi t'i gjente paratë e navllos vetë. U këshillua me të atin, u këshilluan me të emën. Dhe vendosi t'i linte priftit rehem arën e re për navllon. Brenda pesë vjetësh, po të mos ia lante, ara do t'i mbetej priftit. E kam dëgjuar vetë me këta veshë, se më mori dëshmitar edhe mua kur i tha:

— Uratë, më huaj navllon, se s'do të të dalë keq...

— Të thashë një herë, arën e re rehem...

— Rehem?

— Rehem.

— Ah, papu, papu! Unë do të desha të të linja rehem fjalën e burrit, po ti do arën... Ashtu qoftë, po të mos... Po vetëm arën, ama, se dardhën ia kam shënuar djalit... Po të mos...

Aha, s'ia tha goja gjer në fund atë fjalë. Iu mbushën sytë me lot...

E ja, po ju them, ore djem, po mbushte tridhjetë vjeç burri (e njihja që kur delnim në rrugë me kë-

mishë jashtë) dhe lot në sy nuk i kisha parë. Atë çast u përlot.

Dhe dëgjo, atë dardhë, ti e di, xhanëm, se do të ta ketë thënë jot ëmë patjetër, por ta dëgjojnë këta të tjerët... atë dardhë e ka shartuar vetë yt atë me dorën e tij. Ishte një goricë në brinjë. Ia ruajti rrënjet nga kazma, kur hapi qilizmë dhe në të hyrë të marsit e shartoi. Se nga gjeti një kalem që e kishin sjellë nga Besarabia... Pa lëre ti ç'hotë mjekërcjapi... Ohu, ashtu thotë edhe për këmbën ai, sikur ia kanë plagosur në Besarabi, por...

\* \* \*

Savës për një kohë të gjatë nuk i besohej se shamia e zezë që hodhi aq shpejt mbi flokët, e dendur, shamia që mbuloi ballin dhe e uli gjer mbi vetturat e rrudhura do t'i mbetej për tërë jetën.

E priti të shoqin si pret toka e zhuritur shiun, si pret fleta e vyshkur vesën në piskun e vapës. E priti se mos i vinte letra e parë, kur mbushi i biri tre vjeç. E priti kur mbushi i biri pesë, shtatë, nëntë, dhjetë...

Nuk i besohej që kishte mbetur e ve. Nuk i besohej që Çomja i saj kishte mbetur jetim. Ajo edhe atë ditë, ngarkuar me atë kofinin me mollë e ato dy shishe raki mbi shpinë, që ndiqte pazarakët, duke thurur një palë çorape të reja leshi për të vjehrrin, që po i tretej në krye të vatrës si një tog bore nën hijen e një lisi, prapë nuk besonte që Stefani i saj të kishte vdekur... «Janë myllur rrugët nga lufta», thoshte, «e njerëzit trillojnë lloj-lloj his-

torish. Nuk është e mundur të ketë vdekur Stefani im në atë mënyrë...» Nuk besonte, megjithëse një kushëri i saj i kishte treguar fill e për pe çfarë kish-te ngjarë:

«... I kthyem e i rrotulluam krevatet nga të katër anët. Po dhoma ishte e vogël dhe nuk nxinte më. Vendosëm t'i shtronim përdhe... Ishim katër vetë ne. Erdhi dhe Stefani, u bëmë pesë. Ç'të bë-nim? Jashtë nuk e linim dot. Se ishte i drobitur nga rruga. Kishte mbetur pa ngrënë, po nuk e jepte veten. Atë natë kutinë e mishit, tahinin e darkës, e ndamë në pesë pjesë. Më kujtohet si tani ajo fytarë e zbetë, ata sy të vlagët, që rrotulloheshin nga rrotulloheshin e binin mbi pjesën e pestë të kutisë, ku zbardhët një dhjamë i qullët midis mishit të kuq.

Ai férkoi qafën që i ishte holluar si ulluk druri. Buzëqeshi si ndonjë i shurdhër që i duket sikur e qeshin ngaqë s'merr vesh se ç'thonë për të dhe u ul të hante. Po s'futi gjë në gojë atë natë. Nuk e duronte dot erën e mishit të kutisë. «Është mish kali, i flamosuri», tha dhe u ngrit e doli jashtë. Ne hëngrëm. Qemë mësuar. Kur u fut përsëri dhe pa kutinë bosh mbi kapicën e kutive të tjera në fund të dhomës, qeshi ndanë buzëvë dhe tha:

«Hajde, moj Ameriqi, mbushur qoshja me kuti...»

Kushedi se si e pat menduar Amerikën, i varféri Stefan! Nuk e dinte se ç'jetë qeni bënim ne për të kursyer ato të holla që dërgonim në shtëpi. Po ne, të paktën, kishim nga një copë punë. Atë nuk e futëm dot gjëkundi. Qenë vitet e krizës, pa ndonjë punë, nga ato që i linin dhe zezakët, mund t'ia gjënim... E mora ca kohë në garazhin ku isha pajtuar unë. Lanim maqinat e të pasurve. I zoti i garazhit pu-

nonte vetë dhe mua mezi po më mbante për vete, por s'ma prishi: «Rrogë nuk i jap dot, më tha, po s'i them gjë. Le të rrijë. Po të jetë i zoti të nxjerrë ndonjë santim nga bakshishet, le ta nxjerrë, rriskun e fëmijëve të tu do të marrë». Dhe i jepte lecka të pastra për të fshirë maqinat. Eh, si punonte! Po pse, fitoi gjë, thoni ju? Asnjë santim! «Nuk e zgjat dot dorën unë», më thoshte: «Ta di që të vdes nga uria dhe nuk ia zgjat dorën tjetrit...» S'e mposhti që s'e mposhti dot krenarinë që kishte sjellë me vete! Unë, i varfëri, bëhesha copë. Sa i pastroja maqinën ndonjërit, rrëmbeja furçën, i fshija myshterisë supet, bëja sikur i hiqja një qime e pluhurin e rruqës, pastaj i përkulesha me respekt dhe nxirrja atë përrpara që të merrte bakshishin. Po pse, dëgjonte koka e tij? Rrinte si trung dhe më shikonte me bisht të syrit, si mishin e kuq të kutisë atë natë që erdhi... Po dorën s'e zgjati që s'e zgjati. Një amerikan i pasur, që ia bleu mendjen, deshi të tallej me të një ditë. Si ia bëra unë të gjitha shërbimet dhe u prapsa, ashtu, duke u përkulur, për të lënë atë përrparë, ai amerikani futi dy gishtat në xhepin e jelekut, priti sa priti me bërrylin peshë se mos zgjaste Stefani dorën, pastaj ai ia hodhi të hollat mu para këmbëve, vuri duart në ije, u mbllaçit nja dy-tri herë dhe qeshi me të madhe. Po qeshi aq fort, ama, sa erdhi aty edhe i zoti i garazhit (Lavazh bëhej atje, po kështu i thoshim ne, garazh, se kishte një kanal ku futeshim për të larë maqinën nën të...) E, ky Stefani, ndjesë pastë, në vend që t'i merrte e të përkulej me nderim e buzëgaz, siç fitohet paraja në Amerikë, i merr ato dhjetë a pesëmbëdhjetë santimet dhe ia përplas amerikanit mu në fytyrë. Ashtu, të lagura e me baltë siç qenë. Skandal! Mezi e shpëtuam nga

*gjoba. Unë e di çfarë kam hequr. Po aty s'puthi më, ama!*

*Pas nja dy javësh, veç kur e shoh krah për krah me një negër hamall, që punonte në port. Pat qenë aty ai negri, kur kishte ndodhur sherri dhe e mbante Stefanin mbi krye e sipër. Ama as për të fjetur s'kishte ardhur në dhomën tonë. Flinte bashkë me negrin në një barrakë të mbuluar me llamarinë, buzë molos. Çfarë t'i thosha?*

*Punoi atje në ngarkim — shkarkim nja tre muaj të verës, pastaj, me të filluar shirat e vjeshtës, si gjithë hamejtë, filloj dhe ai të hante kursimet, gjersa e gjeti shkurti pa një santim në xhep. Më erdhi një ditë në garazh. Pa pritur e pa kujtuar, pa më përshëndetur fare më tha: «Ke ndonjë porosi përgruan, se do të iki në Shqipëri». Në fillim kujtova se mos kishte lajthitur. Por nuk më la të habitesha gjatë. «Më ka rregulluar negri im, tha, një vapor që ikën në Itali. Që andej do të bëj si të bëj e do të iki në fshat. Ia pashë hajrin dhe Amerikës». Kaq më tha. Më shtrëngoi dorën, më përqafoi dhe krisi e iku pa kthyer kokën prapa.*

*Pas afro motmoti mora vesh ç'kishte ngjarë.*

*Për t'u shpëtuar kontrolleve, negri kaldaist e kishte futur në depon e qymyrit. Qenë nisur dhe kishin udhëtar dy muaj rresht për mrekulli. Stefanit ditën flinte dhe natën vente e ndihmonte negrin në kaldaje. Mirëpo në ditët e fundit të udhëtimit, kur kishin ndaluar për ta mbushur depon, negri s'kishte pasur voli ta zgjonte dhe e kishin mbuluar me qymyr. Vajti ai më vonë ta kërkonte dhe e gjeti, po ç'e do, e gjeti të vdekur në një pellg vreri. E kishte mbytur afshi dhe pluhuri i qymyrit. I li-*

*dhën një gjyle të rëndë në këmbë dhe natën, fshe-  
hurazi nga kapitani, e hodhën në det...*

*Eh, i ka kurbeti këto! Tafti bafti!»*

*E, si t'i besohej Savës një vdekje e tillë?*

# V

«TY TË MBAJKAN ERË DHE FJALËT,  
MOJ QIRICKE...»

Të ashpër janë këta tituj. E di! Ndonjëri mund të mbledhë dhe buzët me përcimim. Ndofta. Po këto janë fjalët e tua, i dashur, dhe unë i ruaj ato në kujtesën timë si gjyshet tona stolitë e nusërisë në fund të sepeteve të tyre të drunjta.

Mua nuk më hiqen nga mendja ato çaste, kur i dëgjova këto fjalë.

... Nuk të kisha parë ndonjëherë tjetër aq të zemëruar si atë ditë, kur na la maqina me gisht në gojë, sepse nuk arritëm të shisnim mollët e rakinë e të blenim biletë, këmishë e opinga me gomë... Shqetësim në sytë e nënave, shqetësim në sytë tanë. Po ti prapëseprapë e mbaje veten. Vetëm kur dëgjove ato fjalë, u zemërove. Unë i mbaj mend mirë ato çaste: në fillim t'u njomën sytë, të shkëlqyen e pastaj, kur u skuqe gjer në rrënje të flokëve, erdhi e u përqëndrua ai shkëlqim i vlagët në bebet e syve dhe dukej sikur të shponte si një majë gjilpëre.

Po, unë besoj, kur thonë se shkrepëtijnë sytë. Ty të tërboi qëndrimi i tyre. Ty të tèrbuan ato fjalët e qirickës... Nuk them se mua s'më bënë përshtypje, jo. Dhe mua më bënë përshtypje të madhe. Po unë nuk i shikoja sytë e mi. Mua m'u ngulit në tru, për tèrë jetën, ai vështrimi yt që të shponte si shigjetë. Shigjetë e lyer më helmin e zemërimit të njeriut të rritur në djepin e fisnikërisë dhe të pastërtisë fshatare...

Po, unë besoj, kur thonë që sytë shkrepëtijnë!

Ne hynim në pazar për herë të parë. Sa shumë gjëra na tèrhoqën vërejtjen: njerëz që bërtisin si të çmendur, sa u lëshonte shkumë goja, për të lavdëruar mallin e vet; gra leshprera, me fustane të shkurtëra e këpucë me takë që mbanin nën sqetull nga një çantë, sikur të ishin fëmijë shkolle. Secilës i vinte nga pas me zymbyl në të dyja duart. . . «një jevg» i vogël. (Si flisnin ato! Nuk e kishin për pesë ta përqmonin tjetrin, duke dredhur e përdredhur buzët e lyera me një okë të kuq). Por ajo që na bëri më shumë përshtypje ishte «budallallëku i këtyre njerëzve të qytetit», siç menduam në atë kohë.

— Çudi me këta njerëz, moj nënë, rakinë na e rrëmbyen nga duart, e pemëve nuk ua hedhin sytë fare...

(Unë, për veten time, ku ta gjeja të kisha atë fat e t'u shtrohesha këmbëkryq atyre mollëve që më kishin bërë të më lëshonte lëng goja që nga dita kur kishin filluar të skuqeshin sipër pemës e gjer atëhere kur e shihja që u shkëlqente të kuqtë mbi cipën e verdhë si mjaltë rojke, ashtu siç qenë, të vendosurja njera sipër tjetrës në kofinë...) .

Nëna më pa dhe heshti. Mua, nuk e di pse, më

doli përsëri përpara syve «ai burri që na bleu rakinë», me a'ë trup rondokop, me atë fytyrë të bullavasur që fliste ashtu, shpesh e shpejt, sikur fjalët shtynin njera-tjetërën e mezi prisnin të delnin jashtë nga ajo gojë e qelbur, nga ata dhëmbë të krimbur. E më erdhi të qeshja me atë hundën e tij të trashë e të mavijosur, në majën e së cilës mbante një palë gjyzlykë si të priftit tonë. Dhe, për çudi, njëlloj si ai, njerën anë e kishte shkuar në vesh me pe. Siç asaj ane e kishte të plasur. Po, për çudi, të gjithë rreth e rrotull, sa e shihnin, shtrinin pëllëmbën mbi gjoks dhe i përkuleshin me nderim.

Nëna që, siç dukej, e shtyri në mendime ajo pyetje, duke mbledhur buzët me keqardhje mërmëriti:

— Eh, mor bir...

Po nuk arriti ta mbaronte fjalën. Një grua e ngjallur, që dukej sikur ngrinte me kast hundën e saj me çipa dhe gjinjtë e fryrë, e ndërpreu:

— Po ti, moj, sa i mban ato mollë? — dhe, si u hodhi një vështrim përcmues, të shtirë, rregulloi nën sqetull çantën e saj të hollë e të gjatë që i ndrinte si lëkurë gjarpéri...

— Sa ç'shiten, moj motër.

— Motër?!

Nëna bëri sikur nuk e vuri re qesëndinë në fytërën e saj të lyrosur dhe i tha se mund t'i jepnim më lirë, po t'i blente të dy kofinët. I tha se rronin, se zinte molla mollën, po të dije t'i ruaje në kashtë...

Gruaja kërkoi që t'i shpinin kofinët gjer në shtëpi. Ne nuk kundërshtuam.

Pasi ecëm, të katër bashkë, (gruaja shkonte përpara, mjaft larg nesh) na ndali përpara një shtëpie të ngritur me gurë të skalitur e të rrethuar me një avlli të lartë, e cila mbaronte në një gardh hekurash të lyer me bojë jeshile.

Hapi njërin kanat të portës së hekurt dhe neve të dyve na tërhoqi vëmendjen tringëllimi i një zileje, vendosur sipër te vendi i mandallës... Para nesh doli një oborr i shtruar me rrasha guri, i lyer nëpër via me gëlqere. Rreth e rreth qenë vendosur gjysma qypash e gjysma teneqesh vajguri (të lyera po me gëlqere) të mbushura me lule e borzilok...

Nënët tona, njera pas tjetrës, u bënë gati të futeshin me kofinët përpara duarve, kur një «Mos»! i prerë na shtangu të gjithë në vend.

— Mos! Prit aty!

Ndërkaq doli në krye të shkallëve një burrë i dobët me gjyzlykë, që i foli gruas trashaluqe me zë të ashpër:

— E ç'i ke këta, moj! Ç'është ajo grua?

— Këto — dhe vështroi nënën time nga koka në këmbë — janë dy, me nder, fshatarka, që u kam blerë mollët... Prit, moj, prit! Ty të thonë! — iu kthyë nënës sime dhe deshi t'ia rrëmbente kofinin nga duart. — Se ma mbushe oborrin me erë bajgash...

Ajo as që kishte për ta mbajtur dot kofinin, sikur të mos zbriste burri me vrap dhe ta merrnin të dy bashkë.

— Dhe ti, ama... Pse s'i fute nga dericëka? — u qa ai, duke shtrënguar nofullat nga barra e rëndë...

Unë të vështrova ty. Nuk po e kuptoja pse

gruaja tha «me nder fshatarka» e pse u nxeh ashtu, pa asnjë shkak.

Vetém kur pashë me bisht të syrit teliket e leshta të nënës, të arnuara poshtë me lëkurë kau, që i kishte hequr dhe i mbante në duar, m'u bë sikur më mbeti kraharori bosh...

Dhe atë çast ndesha në sytë e tu atë vështrimin — shkrepëtimë, si dy maja gjilpëre.

— Ty... ty të mbajkan erë dhe fjalët, moj qirickë — shpértheve ti. — Ju... Ju ta lani gojën me ujë trëndafili, kur të zini në gojë nënët tona! Bullafiqe e drejtit...

Ty të tërroqi jot ëmë për krahu, duke miratuar me kokë fjalët e nënës sime:

— Po të mos ia kishim shitur që në pazar e po të mos kishim hallin tuaj, mu në lumë kishim për t'i hedhur dhe s'do t'ia linim t'i hante ajo copë mish ato deli mollë... Ah, zot, mos durofsh...

\* \* \*

Ndërkaq autobusi me njëzet vende, i vetmi automjet që mund t'u vinte rrrotull kthesave të rrugës nga qyteti ynë malor në qytetet e fushës, kishte ikur. Ai do të kthehej të nesërmen e do të nisej përsëri të pasnesërmen. Ne u dëshpëruam. Nuk qanë hallin e të fjeturit, ishte ende ngrohtë dhe ishim mësuar të flnim jashtë, por na dëshpëroi shumë ndarja me nënët. Nënët tënde e prisnin dy pleq të sëmurë në krye të vatrës; nënën time një vatër me fëmijë, njëri motmot më i vogël se tjetri...

Dhe ne qamë të dy. Jo në çastin që u ndamë

*Ti fole pér shkollen. S'ka në fshatin tuaj... Po a e di ti se edhe këtu në qytet, ku janë ngritur, po na mbeten shkollat bosh? Kujt i shkon ndër mend të vazhdojë klasën e katërt e të pestë, kur është i detyruar të punojë pér të siguruar bukën e gojës, me të arritur të dhjetë vjeçët?..*

*Shiko si ziejnë rrugët e qytetit nga fëmijët! Sikur janë pushimet! Të gjithë janë të detyruar të punojnë. Ca shesin gazeta, ca bërtasin «lustra-boja», ca janë pajtuar shegertë, si puna e Pipit, të tjerët, më keq ende, thyejnë gurë me çekiçë pér të shtruar rrugët, si puna juaj... Në çdo dyqan që të kthehet, do të shohësh fëmijë që ngarkojnë e shkar-kojnë... Vete në kafene, ta nxjerrin kafenë të vegjelit... Në çdo shtëpi pasaniku që të vesh, do të shikosh shërbëtorë. Erdhën «shyqyr» italianët, ua ndërruan ujët shushunjave dhe ato u gjallëruan... Ju po lëkurën e keni të njomë! Mall i lirë kjo puna e fëmijëve... Nejse!»*

Mësuesi na ra të dyve prapa kokës me përkëdheli, u tha «natën e mirë» Pipit dhe ustait të tij dhe u largua...

Ne shtangëm. Shikonim njëri-tjetrin në sy, si bufi ditën. Veç Pipit i shkëlqyen ata sytë e tij dinakë bojë bari të çelur dhe kafshoi buzën pér të mos qeshur. I kishte bërë katër klasë Pipi, pse të mos...

Kot i lashë prapa ngjarjet, kot. Ç'paskam dëshirë sot të shkel hap pas hapi mbi gjurmët e atij udhëtimi...

... Ne shkuam drejt e tek yt kushëri, atë do ta kishim mbështetje. Qe i vetmi i njohur në atë qytet të madh, ku sapo hodhëm çapin e parë, na shushati

me zhurmën dhe dritat e shumta. Por kushëri yt nuk banonte në qytet, ai punonte diku në shtrimin e rrugëve, jashtë qytetit, në një sipërmarrje italiane dhe banonte në Skelë. Kishte ngritur, së bashku me nja dy hamej, një si tendë, si kasolle, nga ato që ngrinim ne në fshat, në arat e largëta dhe atje banonin. Tenda ishte në buzë të detit.

Kur vajtëm ne, në mbrëmje, paksa vonë, meqë s'pamë dritë, u trembëm mos kishin fjetur. Por jo. Me t'i dalë kasolles përpara, i gjetëm duke biseduar rrëth zjarrit që kishin ndezur përjashta...

Ai na priti shumë mirë: na puthi e na shtroi të hanim bukë misri të thekur me djathë. Ata të gjithë thanë se kishin ngrënë. Mos i lamë, vallë, atë natë pa darkë? Ne s'ndjenim të ngopur. Hanim si të babëzitur.

Yt kushëri vajti e mblođhi ca copëra dërrasash, ca degë e gjethë të thara dhe ne, megjithëse na hapej goja e na mbylleshin sytë për gjumë, i treguan fije pér pe të gjitha të rejat e fshatit. Fjetëm vonë, shumë vonë. Dhe u ngritëm herët. Se herët e fillonte punën ai! Kur të binin rrezet e para të diellit, përkundruall, mbi Malin e Thatë, ai duhej të ishte në kantier dhe hamejtë në punë, përndryshe Kapoja...

Ai na tha se do të bisedonte me Kapon dhe, po të siguronte pëlqimin e tij, do të na merrte në punë që të nesërmen. «Për të fjetur, do të flini këtu», na tha ai.

— Ahu, ka vend boll — shtuan hamejtë... — Ju merrnim edhe në molo, se këtë muaj çka, ka pasur punë, po jeni të vegjël e ju vret barra e rëndë...

— Ndërsa për të ngrënë... shohim e bëjmë —  
shtoi yt kushëri.

Kapua na paskesh qenë me orë të mira dhe u  
nisëm të pasnesërmen pa gdhirë për në punë. Në  
të dalë të qytetit na priste një kamion i hapur me  
karroceri llamarine. I hipëm atij dhe ikëm. Do të  
venim në gurore. Do të mbushnim maqinën me gurë,  
do ta shkarkonim te vendi i punës, pastaj do të ule-  
shim këmbëkryq dhe do t'i thyenim... «Vend pë-  
llumbash!» Punë më të mirë për ne as që ëndërronte  
njeri nga ata që na rrëthonin. Vërtet paga do të  
ishte më e ulët, po, në fund të fundit, fëmijë ishim,  
sa për bukën e gojës do të na mjaftonte...

Që atë mbrëmje u pajtuam ta merrnim bukën  
veresie te Coli dhe, po të donim të pinim nga një  
gotë qumësht e të hanim nga një pjatë kos te Pipi...  
Garant ishin yt kushëri dhe tre hamejtë që flinin me  
të.

Dhe që atë mbrëmje u njohëm me Pipin e usta-  
në e tij...

— O Pipo! Na dhe këta dy rabushë, o burazer,  
e vuri në xhep të përparsës. Po shiko se mos i  
ngatërrosh me çetelen time, se hëngérkan shumë  
këta, o burazer, dhe do të më nxjerrin me këpucë  
të kuqe në fund të kuindiçinës — qeshi një nga  
hamejtë, Mullai dhe i zgjati vërsnikut tonë dy çetelat,  
ku do të shënonim gotat e qumshtit dhe kosin  
që do të merrnim veresie. Sa qesharak na u duk atë  
mbrëmje Pipi! Se kishte vënë një përparse të gjerë  
e të gjatë, që nga fillimi i gjoksit gjer në fund të  
këmbëve. Pantallonat nuk i dukeshin fare dhe ve-  
tëm rrallë, shumë rrallë i delnin që poshtë përparsës  
majat e trasha të këpucëve të mëdha ushtarake që

mezi i hiqte zvarrë... Ai ishte vërsniku ynë, por vinte pak më i gjatë dhe më i mbushur se ti.

Pipi na pa drejt në sy, duke mbledhur vetullat, për t'u dukur më serioz dhe na zgjati dorën si një i madh:

— Spiro Kosta!

Ne nuk i shqiptuam atëhere emrat tanë. Nuk i kishim mësuar ende ato rregulla. Ku dinim ne se si prezantoheshin njerëzit! Dhe vetëm kur na pyeti «po ju si ju quajnë?», ne i thamë njëri pas tjetrit emrat tanë të shkurtuar...

Që nga ajo mbrëmje ne hymë në forcë në bulmetoren e vogël ku punonte Pipi. Sa herë pinim qumësht, gdhendnim vetë me thikën tënde një shkallëz nga kreu; kur i hanim kos, shënonim dy shkallë në anën tjetër dhe ia hidhnik Pipit. Ai i mbante ato në xhepin e madh të përparses së tij dhe në fund të pesëmbëdhjetëditheshit na thoshte sa i detyroheshim ustatit të tij. Kështu, pesë muaj rresht neve s'na mbetej asnë qindarkë në xhep. Paratë, siç i merrnim, i dorëzonim te Coli dhe te Pipi. Dhe përsëri hanim veresie...

Një ditë, më kujtohet si tani, ti i qave hallin Pipit për këtë dhe i the t'i lutej ustatit të tij që t'ia paguanim paratë në fund të muajit dhe të ble nim nga një kuti, furçë, bojë për të zënë ndonjë qoshe si lustraxhinj. Se na dukej sikur do të fitonim më shumë e na vinte zili kur u shikonim atyre pare nëpër duar. Po Pipi mblodhi buzët e holla, na hodhi një herë njërit, pastaj tjetrit sytë e tij të lëvizshëm bojë bari të çelur dhe na tha:

— E ku gjen qoshe bosh? Nuk i dëgjoni si gua-

sin në çdo dhjetë hapa: «lustra-boja», si guakët në shullë! Rrini atje dhe ca, pastaj shohim e bëjmë. Do të hapen punë të tjera...

Ne e dëgjuam këshillën e Pipit.

Çdo mëngjerez ngriheshim herët. U hidhним syve dy duar ujë deti, fshiheshim me boçet që kishim mbështjellë dikur kulaçin e fshatit, (ato kishin filluar të gëriseshin nga kripa e detit) venim vrap e rrëmbenim bukën te Coli. Kur kishim kohë, pinim nga një gotë qumësht e shënonim një shkallë te çetelet tonë, i hidhним në xhep të Pipit dhe... nga sytë këmbët, se kamioni në të dalë të qytetit nuk na priste gjatë dhe vendi i punës sa vente largohej. Zgjatej kalldrëmi, zgjatej... E neve duart na qenë mbushur me plasa. Çdo mbrëmje i lyenim me një ilaç që na e pregetiste Mullai me dyllë blete dhe më vaj ulliri, ose palcë kockash. Çfarë të gjente më lehtë.

Kishin ikur ato ditët e para kur na ngjitej lëkurë e duarve pas faqes së ftohtë të gurëve dhe kur dridheshim si macet me kokën rrasur në supe. U mësuam. Por edhe moti ishte zbutur. Po vinte pranvera. Ja, një ditë na vajtën sytë te lulet e verdha të thanëve. Dhe ato na kujtuan Ditën e verës, nënët, fshatin. Kur ishim atje, në fillim të çdo marsi prisnim nga një degë thane dhe e vinim te qemeri i derës. E vetmja ditë që e kishim të siguruuar kokrrën e vezës së zier! Dhe lanim faqet me verë. Pastaj venim e u hidhним verojkat dallandyshëve:

Dallandyshe, faqeikuqe,  
merr këtë verojkë, shpjere në det,  
na sill bukë dhe kësмет...

C'na shtyri në mendime ajo lule e thanës...

«Ah, nëna, nëna të dashura! Sa shpresat kishit ju, kur na nisët pranë detit! Ja, erdhëm dhe pranë detit. O të dashurat nënët tonë: është njësoj, njësoj kudo!»

Ç'na mallëngjyen atë ditë ato gonxhet e verdha  
të thanëve! Dhe ne u harruam pas fjalëve. Dhe ne  
nuk e dëgjuam fare zhurmën e motoçikletës së  
Kapos, që kishte ardhur për të na kontrolluar. Ai,  
meqë s'na gjeti këmbëkryq, të mbërthyer për guri,  
filloj të bërtiste. Dhe mua m'u ngulitën në mend  
fjalët e tua: "...së hërtet kështu si... së shoges?"

— Pa ky, c'ka që bërtet kështu si... së shoqes?

Dhe ti nuk e shqiptove fjalën jevg. Se dy nga hamejtë që flinin me tët kushëri ishin jevgj. Dhe ata ishin shpirt njeriu.

Kjo ishte hera e tretë që kishim ndjellë zemërimin e Kapos. Herën e parë ai na bërtiti, kur erdhi që në mëngjez herët te gurorja. Mua atëhere s'më ishin mësuar ende duart dhe më shpëtoi një gur i madh e i ftohtë dhe më ra mbi këmbë. Sa s'më rata fikët nga dhembja. Gishti i madh m'u shtyp dhe sa s'm'u nda më dysh. Kur m'u shërua, pjesa e përparme më mbeti më e hollë dhe ti qeshje me mua, sidomos kur delte nga çorapet e grisura. «Doli koka e breshkës!» — thoshe... Të kujtohet? Se gishti i vrarë dukej vërtet i stërgjatë, si kokë breshke.

Herën e dytë na bërtiti, kur ty të rrëshqiti guri që mbaje në dorën e majtë dhe çekiçi i rëndë të zhvati mollëzën e gishtit. Të kujtohet? Ti tundje dorën nga dhembja e shtrëngajoje nofullat pér të përbajtur lotët, ndërsa ai bërtiste si i tërbuar e s'linte gjymtyrë të trupit pa lëvizur.

Dhe ja tanë hera e tretë. Por tanimë nuk ia kishim edhe aq frikën. Pipi na kishte premtuar se do të na rregullonte në një punë tjetër. Flitej se, me të hyrë pranvera, do të fillonte ndërtimi i një fabrike gazozash. «Aty do të ketë punë sa të hajë dreqi e të lërë». Kështu na thoshin. Pipi kishte shumë të njojur dhe na kishte premtuar se do të na rregullonte...

Ne s'pritëm të na përzinte Kapua, siç na kishte kërcënuar, ne u larguam vetë. Qëndruam lart mbi bregoren e bleruar, ku kishin çelur thanët, u ngrohëm në diellin e marsit, mbushëm gjokset më avujt e ngrohtë e gjithë aromë që lëshonte toka e shihnim detin tek shkëlqenin rrezet e diellit.

\*

\* \* \*

Në punën e re na regjistroi Mësuesi. Mësuesi që kishim njojur te Pipi. Mësuesi që hante atje veresie si dhe ne, me të vëtmin ndryshim se ai i shënonët në defterin e ustait llogaritë me numra dhe me dorën e tij, ndërsa ne shtonim shkallët në çetele... Po Mësuesi, pse kishte ikur Mësuesi nga shkolla?

## VII

### A B E C k — ja

Skela, nuk kishte asnje godinë dykatëshe. Që lart, nga kodra përmbi qytet, ajo dukej si ndonjë spirancë që sapo e kishin nxjerrë nga gjiri i detit dhe e kishin shtrirë buzë tij. Dyqanet, pijetoret, restorantet e bulmetoret, furrat e kinkaleritë, të ngriitura njera pas tjetrës, në të dyja anët e një sheshi, krijonin gjysmëharkun dhe rruga për në qytet ishte bishti i saj... Sa shumë dyqane kishte! Dhe ato shtoheshin përditë e më tepër. Gjysma e pronarëve ishin italianë. Edhe ata kishin marrë shërbëtorë të vegjël që i përdornin për gjithfarëlloj punësh dhe i shpërblenin njësoj, pak, sa për të siguruar bukën e gojës. Shumë nga gjellëbërësit e kasapët nuk i kishin dyqanet e tyre, por i kishin marrë me qera. Kështu ishte Coli, kështu ishte ustai i Pipit dhe shumë e shumë të tjerë. Por nga kjó çirakëve, shegertëve dhe kamerierëve nuk u lehtësohej puna. Përkundrazi, ata duhej të punonin më shumë, sepse ustallarët e tyre, veç të tjerash, duhej të nxirrin

edhe për të shlyer qeranë. Po një të mirë me gjithatë e kishin ata ustallarë. Shumica, ashtu si dhe sheger-tët e tyre, kishin zbritur në qytet nga vende të ndryshme, kryesisht nga vende malore; të detyruar nga kushtet e rënda. Ata qenë mësuar me punë, ndaj në dyqanet e tyre punonin edhe vetë (sigurisht bënин punët më të kualifikuara) dhe ia dinin vlerën punës. Kjo i detyronte t'i mbanin shegertët më afër se sa pronarët e dyqaneve. Madje ndaj pronarëve ushqenin një urrejfje të fshehur, se ata nuk lidhnin kurrë kontrata të gjata me ustallarët dhe, sa herë i përsëritnin ato, u ngrinin qeranë. Kjo i detyronte ustallarët që, për të shtuar të ardhurat, të gjenin mënyra të ndryshme. Kështu përsimbëll ustai, ku punonte Pipi, pasi përsëriti kontratën me një qera më të lartë, vendosi ta kthente bulmetoren në «Bar-restoran». Filloi të gatuante gjellë, të shiste pije, bile edhe fruta. Por qumshtin e kosin nuk i la. «Ata myshterinj i kam e i kam», thoshte. Ne ishim në dijeni të planeve të tij, pasi na qante hallin Pipi. Atij i qenë shtuar shumë punët. Veç tenxhereve dhe gotave të qumshtit, veç sahaneve dhe tavave të kosit, ai duhej të lante edhe pjatat, lugët, pirunjë dhe tenxheret e gjellës. Ai ishte bërë «polishegert», siç queshte me të Mësuesi e siç e përsërisnim ne, me vend e pa vend, pa ia ditur mirë kuptimin kësaj fjale.

Ne, megjithëse lodheshim në punë, detyrohemishim të ndihmonim edhe Pipin. Nuk e shikonim dot ashtu, të djersitur e të lodjur. Bëhej copë, i shkreti Pipi! Nga të vente më parë. I pari fillove ta ndihmoje ti. «Hajde, Pipi, ç'ke ti, qumshtin ta ziej unë», i the një ditë, «vetëm lutju ustait të na lërë

të gdhihem i në dyqan, se na bëri pastërma era e detit, na thau brinjët.»

Aty, te zierja e qumshtit e kishte pikën më delikate Pipi i varfër. Aty e kishte marrë paralajmërimin nga ustai. Dhe ne e ngacmonim për këtë...

... Pipi zgjohej herët, shumë herët, që në orën tre e gjysmë të natës. Ndizte zjarrin, zbrachte bidonat që i sillnin pa gdhirë pajtimtarët nga stanet, i vinte në zjarr, merrte një dërrasë të gjatë, të trashë në fund, si lopatat e bukëpjekësit dhe të hollë në krye, ulej ndanë zjarrit, përballë kazanit dhe e trazonte, gjersa qumshti zinte e fryhej... Mirëpo, i pangopur me gjumë siç qe, duke trazuar vazhdimisht fundin e kazanit e duke i mbajtur sytë vazhdimisht mbi atë sipërfaqe të përhimtë (kështu dukej qumshti në gjysmerrësirë) nganjëherë dremiste dhe vinte në vete i trembur nga ndonjë èndërr e llahtarshme. Kur zgjohej pa u fryrë qumshti, ishte gjysma e së keqes (se duart i punonin Pipit edhe duke fjetur) dhe qumshti nuk ciknosej, por disa herë nuk përmendej, gjersa, kur derdhej qumshti, shpuza dhe hiri i nxeh-të që ngrihej përpjetë i përvëlonin fytyrën. Një herë kishte djegur ca dhe këmbën. Po të gjitha këto i duronte Pipi dhe ne ishim të vetmit që e kishim marrë vesh se qumshti i firasur qe zëvendësuar me ujë pusi. Një herë e kishte parë pisk. Pas një èndrrë të llahtarshme, me sytë që i lëshonin xixa kishte parë ustanë përkulur mbi kokë. Ai po bëhej gati, t'i hiqte edhe një dackë në faqen tjetër... Por përfat qumshti sapo kishte filluar të bulonte shku-mën dhe Pipi, pasi kishte mbajtur faqen me dorë, kishte lëshuar buzët dhe i kishte thënë ustait:

— Kot më re, usta! Qumshti do dhe dhjetë minuta, pa të ziejë.

— S'ka gjë, më mirë. Po të derdhej, do të qe vonë. — Dhe ustai, siç duket, paksa i penduar pér atë që kishte bërë, i tregoi historinë e atij tregëtarit qifut që e rrihte të birin para se ta niste me shtambën pér ujë...

Po sa bukur i tregonte këto gjëra Pipi! Dhe ne shkuleshim me të! Tani më rri serioz, rrudh ballin e më flet pér teorinë e relativitetit, pér raketat balistike dhe gravitetin e tokës, të thuash se nuk është ai Pipi që lëvizte lopatën duke dremitur. Si? Kemi mësuar ca fjalë të reja, i krekosemi njëri-tjetrit dhe i kemi harruar ato vuajtje? Jo, Çome, ato i kujtojmë, edhe ty të kujtojmë. Po ç'të bëjmë, ç'të bëjmë? Si të të fusim ty në bisedat tonë, i dashur?

\*

\* \* \*

Ustai i Pipit pranoi që ne të venim e të flinim atje. Andej nga ora njëmbëdhjetë, kur në rrugë s'dëgjohej më asnje hap, të tre bashkë myllnim qepenat (ustai në këtë kohë sistemonte arkën) e, pasi lanim enët e pasi fshinim kockat dhe copat e shisheve e të gotave të thyera, që i përplasnin ushtarët e dehur italianë mbi çimento, prapsnim tryezat, vinim nga tri karrige përballë njera-tjetërës, xhakëtat nën kokë dhe shtriheshim. Brenda ishte ngrohtë e gjumi na zinte menjëherë. Shpesh as e ndjenim fare ustainë, kur kyçte derën e prasme dhe vente e flinte në një të ndarë midis depos ku zienim kazanët dhe sallës.

Sa pak flnim! Sidomos Pipi, se neve, kur na shkrepej, flnim edhe më përpara, në depo. Edhe atje ishte ngrohtë. Se nuk shuhej zjarri i madh as

ditë as natë; kur nuk valonte qumshti, valonte ujët pér të larë enët dhe mbulesat e tryezave. Por në mëngjez ngriheshim herët, gjithmonë para orës pesë, se nuk na rrihej pa ndihmuar Pipin.

Darkave, ditëve të zakonshme, kur s'para kishte ushtarë italianë, mblidheshin rrëth tryezave hamej, punëtorë të kantierit tonë (të frigoriferit dhe të punishtes së gazozave) dhe bisedonin. Në shumicën e rasteve njerëzit shfrynin kundër kapove që nuk i linin të merrnin frymë. Shanin haptazi ushtarët italianë që ishin të bezdisur e të fyenin pér hiçmosgjë. Në këto biseda qëndronte shpesh edhe Mësuesi. Ai dëgjonte me vëmendje dhe rrallë fliste. Zakonisht rrinte në ballë të vendit, se të gjithë e respektonin dhe, kush e gjente në fund, e shtynte më lart ose, kur na gjente të mbledhur, i lironim vendin. Ishte i shtruar dhe nuk e ngrinte zërin kurrë. Veç një natë e pamë të nxehur. Ti e vure re, kur i doli si një sfurk damari mbi ballë dhe më pëshpërite: «Epo ka hak, gjithnjë ky zoti Myrteza kështu flet, si e ëma e Zëqos majë thanës...»

Zoti Myrteza ishte kryellogaritar në një zyrë të shoqërisë italiane që merrej me transportimin e bitumin dhe të naftës pér në Itali. Kur një nga punëtorët tanë tha: «Na bien kërbishtet në punë që nga mëngjezi në darkë dhe nuk mbajmë dot fëmijët me bukë», zoti Myrteza u hodh:

— *Ehu, dava zARBOSH! Nuk ju gjendet karari juve. Sa ishte ZOGU, e bënit gojën çorape: «S'ka punë, s'ka punë, vdiqëm pér bukë! Erdhi Italia, prapë i njëjtë avaz. Nuk thoni shyqyr që u hapën gjithë këto punë, se më dridhej zemra kur shikoja njerëzit që endeshin pa shpresë rrugëve, po më bëni fjalë! Pér*

*punëtorët rroftë Italia! Këtë di të them unë. Kur ka pasur në vendin tonë më shumë punë se sot? Ja, më thoni, ju të gjithë jeni moshë e thyer, dyzet vjeç e lart, kur ka pasur kaq shumë punë?*

Të gjithë heshtën. Dukej se nuk ishin në një mendje me zotin Myrteza, por heshtnin. Atëhere u fut në bisedë Mësuesi. U fut ashtu i nxehur, po foli shtruar. Si e përbajti tërë atë inat! Atëhere ne nuk e kuptionim pse u zemërua aq shumë.

— Ah, zoti Myrteza, zoti Myrteza! Sa përciptazi e shikoni ju çështjen! Ju gëzoheni që ikën feudalët, që s'dinin të hapnin punë, që i mbyllnin florinjtë në qypa dhe i fusnin nën dhe, gëzoheni që erdhën kolonialistët «e mënçur» dhe hapën punë? Natyrisht, të mos kesh punë fare, është më keq, se sa të kesh punë dhe të marrësh si shpërblim një të katërtën e djersës së derdhur. Por, po të punosh për vete është më mirë. Ja, më thoni, është më mirë, apo jo?

Zoti Myrteza qeshi me ironi.

— Posi! Ja, do të hapin ndërmarrjet e tyre hamejtë dhe shegertët tanë! Ju fantazoni, zoti mësues! Unë ju tregoj ujkun, ju kërkoni gjurmët... Tani çdo njeri e gjen një punë... Të ishte për regjinin obskuratorist të Zogut, po, jam dakord... Po këta qahen nga Italia, që e shpëtoi kombin tonë.

Ne s'kuptionim pse heshtnin punëtorët, pse nuk ishin dakord me zotin Myrteza? «Ai u qan hallin, se për vete e ka gjithmonë kuletën plot...», dhe pamë njëri-tjetrin të habitur.

Heshti dhe Mësuesi. Mullai i shkeli synë dhe tha:

— A, sa për punë, na vret Perëndia të qahemi. Në kohën e Italisë së parë po, atëhere...

— Atëhere, atëhere... Italia po vdiste për vete. Fashizmi, fashizmi e gjallëroi Italinë. E bëri të zonjën për vete dhe për ne... Tetë milion bajoneta...

— Epo s'janë tetë, de! Se ca humbën në Luftën italo-greke — u hodh e tha njëri nga punëtorët e kantierit tonë.

— E mo, xha Braho, se kanë prodhuar prapë fabrikat. S'është gjë e madhe për një mbretëri si Italia, që prodhon tanke, të prodhojë bajoneta... Ne ç'të bëjmë? — tha përsëri Mullai.

— Hë, më të lumtë! — u hodh zoti Myrteza, që nuk e kuptoi fare ironinë e punëtorit. — Ne ç'të bëjmë? Ne, pa mbrojtjen e Italisë, do të na copëtonin fqinjët...

— Mor po fqinjët nuk i linim ne, xhanëm, ua prisnim kokat me nagaçe, si në njëzetën... — u hodh përsëri xha Brahoja.

Të gjithë ia dhanë gazit. Zoti Myrteza vetëm tani e kuptoi se punëtori po e hiqte për hundësh. U ngrit i nxehur:

— Ju të gjithë, të gjithë jeni zgjebarakë të kuq! Juve... juve të gjithëve jua ka prishur mendjen ky. Po...

— E, a rrënjjëdalë, do ta shohim se ç'do të na punosh ti. Pse, me frikën tënde do të rrojmë ne? Ikë, ore, po ikë! Sa ishte Zogu, ti i lëpiheshe prefektit të tij. Tani që theu qafën ai, po u lëpihesh italianëve! Ikë, të them, se t'i theva dhëmbë e dhëmballë! Dhe i thua vetes shqiptar!

Ishte nxehur keq ai punëtori i vjetër kuçjot dhe me siguri do ta kishte qëlluar rëndë zotin Myrteza, sikur të mos e kishin mbajtur Mësuesi dhe ustai i Pipit, që erdhi apostafat për të ndarë sherrin.

\*  
\* \* \*

Edhe xha Brahoja me Mullanë kishin ikur nga moloja dhe qenë futur në punë në kantierin e frigoriferit. Edhe ata i kishte regjistruar Mësuesi dhe punonin të dy me ne në pus. Rrotullonin rrođhanin e madh që ulte e ngrinte kovën. Me atë kovë zbrisnim e hipnim ne, me atë kovë hiqnim dhe dheun që rrëmonim. Me atë kovë xha Brahoja na zbriste nga një sheqerkë në krye të dy-tri orëve. Se ç'e kishte atë zakon, as ne nuk e kuptonim! Veçse na vinte mirë, kur shikonim në kovën bosh kutinë e madhe të duhanit të xha Brahos. E hapnim dhe gjenim nga një shqerkë që, sapo e fusnim në gojë, na mbushte me aromën e duhanit të fortë të çarkut që pinte xha Brahoja. Por më vonë e morëm vesh edhe këtë shkak. Xha Brahos para dhjetë vjetësh i kishte vdekur djali i vetëm, moshatari ynë dhe atij nuk i hiqej nga mendja ai djalë. Dikush nga ne, më duket ti, i ngjaje dhe ai, sa herë i tekej për duhan, sa herë e dridhte vetë, derdhte duhanin mbi një letër dhe na dërgonte me kutinë e tij sheqerkat. Ç'njeri që ishte! Në kohën e Italisë së parë, siç thoshte vetë, kishte luftuar së bashku me çetën e Musait, në fillim me një nagaçe dhe pastaj me një patikë italiane që ia kishte hedhur një zdap i gjatë mu te këmbët dhe i kishte ngritur duart lart, me t'i dalë papritur që pas një dëllënje...

Të nesërmen e sherrit në dyqanin e ustait të Pipit, xha Brahoja nuk kishte bisedë tjetër. I mbeti në gojë zoti Myrteza. E, si mbaronte bateritë e fjalëve, ofshante:

— Ah, more djem, që s'më latë t'i jepja një

*mësim tē mirë atij pizevengut! (Me gjithëse ne tē dy as e kishim penguar fare). Po e do nië dru ai, e do! Ah, ta kem andej nga gryka e Kuçit e më t'i hyj me hu, ashtu vence. Si më flet, more, sikur është kulish pipinoje! Ah, more djem. E ç'do tē më bënte mua, m... do tē më hante. Mësuesi tē ruhet, se me atë e ka ai. Do t'ia kenë qepur italianët si pullë poste nga pas. Do t'i blejë mendjen. Por dhe atij hiçgjë s'ka ç't'i bëjë! S'tha ndonjë gjë tē ndaluar Mësuesi!*

Të kujtohet xha Brahoja, apo jo? Po ajo ditë, kur na doli ai guri në fund tē pusit, tē kujtohet? Bamb me kazmë, e hidhu kazma përpjetë. Bamb me qysqi, e hidhu qysqia përpjetë. I kërkuam xha Brahos tē na ngjiste lart e ai s'dëgjonte. Kishte hall se mos na qe mbushur mendja e largoheshim nga puna. Na donte shumë. Ngushullohej kur na shihte. «Ikni, ore, se talleni, po ikni! Ku u gjend guri në kum?!» Më në fund i thamë tē zgjaste kokën e tē shikonte xixat. U bind. Se nga vajti e mori një daltë dhe një vare dhe i tha Kapos tē merrte në depo nja dy llokume dinamit. Zbriti vetë pér tē hapur birat. Mezi i hapi. Se ishte vendi i ngushtë. S'kishte nga tē rrrotullohej. Vetë e mbante daltën, vetë i binte me vare. Po ishte këmbëngulës xha Brahoja. Veç ai që s'dinte tē linte punë në mes. I vuri dhe llokumet e dinamitit, i lidhi dhe me fitil. Po nuk i ndezi. Na thirri ne. Hipi në kovë dhe, vetëm kur filloi Mullai ta ngrinte, i ndezi. Ne u larguam ca. Dëgjuam një krismë tē mbytur, pastaj gryka e pusit u mbush me tym. Si u shpërnda tymi, zbritëm, po gurët na ishin mbuluar përsëri me tokën ranore që ishtë vithisur gjatë shpërthimit. Dy ditë tē tërë punuam vetëm me lopatë, pastaj filluam tē

thyenim gurët dhe t'i ngjitnim. Xha Brahoja na fliste: «Mos i ngarkoni gjer në majë, more të uruar! Ju thashë një herë. Se do të më bëni ndonjë hata!»

Kishte frikë mos na binte ndonjë gur mbi kokë. Megjithëse e dinte që ne prapseshim e bëheshim njësh me faqen e pusit kur ngrinin ata kovën, prapë shqetësohej. Sa i dashur ka qenë!

Gdhihej një prilli i vitit 1942. Ne nuk kishim merak tjetër atë mbrëmje, veç kujdesit mos na gjennjente njeri. E për vete bënim njëqind plane për të gjenyer Mullanë dhe xha Brahon. Xha Brahon vendosëm ta trembnim. Unë do t'i thërrisja i lebetitur: «Xha Braho! Ngre kovën shpejt, se i ka rënë të fikët Comes! Xha Braho! Mulla, Mulla, more!» Ti do të futeshe në kovë. Dhe s'do t'i hapje sytë, gjersa të të shtrinin përtokë. Pastaj, kur, «të vije në vete», do të belbëzoje: «Xha Braho, sot duhej të na hidhje nga dy sheqerka për shoq, se është një prilli...» Kishte rrezik të hanim ndonjë të sharë vençë? Kishte. Po mund të hanim që të dy edhe nga një dackë? Mundej. Ne i morëm parasysh të gjitha. Për gazin që do të shpërthente, kur t'ua tregonim të tjerëve, ia vlente të hanim edhe nga një dackë. «Xha Brahoja s'do të na mbajë mëri. Se mos do të na qëllojë rëndë xha Brahoja! Le që, mbase s'na qëllon fare!»

Këto plane ishim duke bërë, kur dëgjuam një trokitje të lehtë te dera e pasme. I pari u ngrite ti, pastaj unë. I fundit fare u ngrit Pipi. Atë e kishte zënë gjumi duke dëgjuar kotësitë tonë. Dhe ndofta s'kishte për t'u zgjuar fare, sikur... Pipi u zgjua se,

ngaqë s'kishim si të delnim, u detyruam të hijnim një karrige nga «krevati» i tij. Pipit iu var këmba poshtë dhe u zgjua i llahtarisor. Kishte parë èndërr sikur i kishte rrëshqitur këmba në një greminë a në pusin ku punonim ne, s'më kujtohet mirë. Se s'pati kohë të na e tregonte shkoqur. E trokitura e lehtë te dera e pasme u përsërit. Pipi e humbi paksa... Ne pamë njëri-tjetrin në sy. «Ç'të jetë vallë, të jetë ngritur ustai pér të hapur dyqanin? Pse kaq shumë kohë humbëm pas fjalëve ne? Po ai ka çelës, pse nuk e hap me çelës? Jo, s'duhet të jetë ustai. Po Pipi c'ka?»

— Më paska zënë gjumi! Ju s'paski fjetur? Uh, sa u tremba, se m'u duk në èndërr sikur!... — tha Pipi, na prapsi të dy dhe doli përpara.

— Hape, ore, në qofsh pér mirë! — tha përgjumësh.

— Pér mirë jam, po s'kam çelës...

Pipi qeshi. Sytë e tij shkëlqyen me dinakëri në dritën e qiriut.

— Epo mirë, po ta hap unë, atëhere!

(Siç morëm vesh më vonë, kjo ishte parullë)

Nga deriçka e ngushtë u fut Mullai. Një thes të mbushur plot e përplot e mbante para duarve. «Me se ta ketë mbushur kaq shumë? O, me pambuk!»

Mullai, kur na pa, u step një hop:

— Hajde, s'ka gjë, Mulla, se janë tanët!

— Po të jetë pér «tanët», janë «të mitë» fare ata. Po ka ca rregulla në punën tonë. I ke marrë leje Mësuesit që po i fut në këtë valle?

Pipi heshti. Ne po na brente përbrenda. «Ç'të jenë këto punë të Mullait dhe të Pipit, që ne s'duhet

t'i marrim vesh? Ç'është kjo, valle? Hajde, Mulla, hajde! Dhe ne të quanim ty vëlla e shkuar vëllait. Ç'paske qenë edhe ti një tinzar i keq, që...»

Mullai na hodhi të dyve duart në qafë dhe, pasi na afroi te faqja e tij e ftohtë dhe e parruar, në fillim mua, pastaj dhe ty, vazhdoi:

— Nejse! Një ditë më vonë, një ditë më parë! Se në këtë valle do të hyjnë që do të hyjnë... Megjithatë, ju lutem si vëllezër, për të gjitha këto ç'dëgjuat e ç'do të shihni asnje gjysmë fjale jashtë! Morët vesh, apo jo? Se nuk është vetëm rreziku i kokës, por mund të prishim një punë të madhe që mezi e kemi rregulluar.

Kaq tha Mullai. Na shtriu dorën. Doli jashtë dhe u tret në terrin e natës. U bë erë.

Pipi nuk e hapi thesin.

Ramë për të fjetur. Dhe fjetëm sakaq, megjithëse na dukej vetja si në ëndërr.

Pipi s'desh të hapej gjer në fund, po të nesërmen, në orën pesë të mëngjezit ne e morëm me mend se çfarë kishte sjellë Mullai. Ishin ca letra të shkruara. Pipi i hiqte nga thesi, i mblidhës rrotullam dhe i fuste nga gryka në mataratë bosh të qumshtit... Ti më the:

— Me siguri do të jenë komunikata. I marrin pajtimtarët e qumshtit dhe i shpérndajnë staneve, fshatrave. Ah, të dinim të lexonim! Kushedi ç'është shkruar në ato letra! Si lum Pipi!

Po s'na u desh ta kishim zili për një kohë të gjatë Pipin. Pas dy ditësh, si mbyllëm qepenat, u futën nga dera e pasme Mullai, xha Brahoja, Coli, ustai i Pipit, nja dy hamej nga të portit, u ulën rrëth tryezës së shtruar me meze të varfëra dhe

Mësuesi filloi të na lexonte me zërin e tij të shtruar:

— U drejtohemë të gjithë shqiptarëve të nder-  
shëm që e duan me të vërtetë Shqipërinë, të bashkoj-  
më të gjitha forcat tona pér t'i vënë në shërbim të  
luftës. Lufta e hapur është i vetmi qëndrim kundrejt  
zaptuesit. Çdo bir i këtij vendi të jetë një ushtar i  
Luftës nacionalçlirimtare.

Të gjithë, pra, në luftë, të bashkuar! Pér çliri-  
min kombëtar, kundër zaptuesit fashist!

Pér një çast u bë heshtje. Pastaj xha Brahoja  
ngriti gotën.

— Gëzuar e pér shumë vjet, ore, djem! Festoni  
pashkët sot! — ne të gjithë qeshëm. E kuptuam me-  
njëherë se kjo ishte bërë pér ndonjë rast nevoje.  
Në qoftë se ndonjë ushtar i dehur ose karabinier, që  
donte të hidhte ndonjë gotë, do të ngulmonte t'i  
hapnin derën, ne festonim... pashkët...

Mësuesi na porositi edhe një herë në fund që  
të kishim mendjen, por të mos rrnim në asnje më-  
nyrë pa folur, me këdo që të na binte rasti, pér ne-  
vojën e luftës.

— Derri do plumb! — tha ai. — Duhet ta ngre-  
më gjithë popullin më këmbë. Ndryshe nuk e he-  
dhim dot Italinë në det. Apo jo, xha Braho?

— Ashtu, bir, ashtu...

Dhe ne u ndamë. Sa të afërt na ishin bërë pas  
kësaj xha Brahoja, Mullai, Mësuesi, Pipi... me-  
gjithëse Pipin e kishim zili, madje na vinte edhe  
pak inat me të. Se ai e merrte vesh çdo gjë më parë  
e na shitej si përgjegjës. Është kështu, apo jo? Dhe  
ç'është e drejta, tregojesh i shkathët dhe i zgjuar  
Pipi. Edhe më guximtar ishte. Të paktën atëhere,  
në fillim, se pastaj na le pa mend me guximin tënd

ti. Ti më habite jo vetëm mua, por edhe Pipin, që ishte i regjur në ato punë. Bile edhe vetë xha Brahon, që i kishte pritur në njëzetën plumbat në pëllëmbë të dorës. Sa të donte ty xha Brahoja! Ti nuk e vije re, por veç ta shihje se si të gëzohej jo vetëm kur ktheheshe shëndoshë e mirë nga ndonjë detyrë, por edhe kur delje nga pusi në mbarim të punës, edhe kur delje nga kova e shkundje supet dhe qafën që të mbusheshin me kum. Unë e kuptoja se xha Brahoja i gëzohej shkathësisë, zgjuarësisë dhe sidomos durimit e të përbajturit tënd. Ti nuk e nxirrje fjalën kot. I përtypje mendimet, siç thoshte xha Brahoja, prandaj të delnin të pjekura, të urta si të një plaku.

Nuk më harrohet një mbrëmje, nja dy ditë pasi na kishte mbledhur Mësuesi, kur na mori Pipi përkrahу, na futi në depo dhe na tha:

— Sot do të vijë përsëri Mullai. Do të na sjellë komunikata. Në Skelë do t'i ndajmë ne të tre. Do t'i bëjmë thirrje popullit të dalë në demostratë me rastin e 7 prillit. E, si thoni?

Pipit i lëvizën gëzueshmë sytë e tij bojë bari të çelur, ndërsa ti e pe buzëgaz dhe fërkove duart...

\*

\* \* \*

Sa lehtë u futëm në «valle». Pa e kuptuar fare. Por, me siguri, Mësuesi, xha Brahoja, Mullai edhe Pipi kishin kohë që na mbanin afër. Dhe neve na pëlqente kjo afëri, se kishim nevojë për ngrohtësi-në e tyre. Na pëlqente edhe besimi i tyre, se kishim nevojë për njerëz që të na besonin. Të na besonin,

se ishim gati të bënim të pamundurën për të qenë  
të denjë për miqësinë e tyre të dliërë.

Por natën e parë veç patëm frikë... Hiç, mos  
më kafsho buzën mua, edhe ti u trembe. Si, u trembe  
për Pipin? Kiske të drejtë të trembeshe për të: ai  
atë natë mori barrën më të rëndë për vete. Pastaj  
na doli përrpara një e papritur:

Ishte menduar çdo gjë mirë e bukur. Pipi na tha:

— Ju të dy do të bëni roje në anën tjetër të  
rrugës, në dy krahët e mi. Komunikatat do t'i mbaj  
dhe do t'i hedh unë që poshtë derës, në çdo dyqan  
e në çdo shtëpi. Ju, në rast rreziku, pasi të më lajmëroni  
mua, do të ngjiteni mbi tjegullat e dyqaneve  
dhe do të dilni mbi oborrin e parë. Pastaj nga oborri  
në oborr do ta keni lehtë. Merakun tim mos e keni,  
vetëm më lajmëroni me kohë.

Dhe ne dolëm. I pari dole në rrugë ti. Qetësi.  
Pas teje doli Pipi. Pëshpëritje:

— Ka hak xha Brahoja: në këtë orë patrullat  
mbështeten në ndonjë qoshe dhe i fshihen thëllimit  
të mëngjezit.

— Kjo është më keq. Kur ecin, dëgjohen  
hapat...

Dola dhe unë.

Pipi, me gjoksin plot, me këmbëzat e pantallo-  
nave të lidhura me spango në fund e të mbushura  
plot me komunikata, kur qëmtonte ashtu me sy,  
rreth e rrotull, ngjante si Sharloti në film.

Ne qëndronim pesëdhjetë-gjashtëdhjetë hapa  
larg tij. Ai i qetë nxirrte komunikatat një nga një,  
ulej, i fuste nën derë, ngrihej... Nxirrte prapë, ulej,  
ngrihej. Mbaroi gjithë serën e dyqaneve në krahun  
e majtë të sheshit. Mbaroi dhe serën e djathtë.  
Ç'qetësi e frikshme! .

Pipi na bëri shenjë të niseshim në drejtim të shtëpive. Mbaruam punë dhe atje. Ishim të gjëzuar sa s'ka më. Po ktheheshim për në dyqan. Në njerën anë Pipi, në anën tjetër të rrugës ne. Papritur dëgjuam hapa të rëndë ushtarësh. Po jo një e dy. As dhjetë a pesëmbëdhjetë, dhjetëra e dhjetëra. Jehona e hapave përplasej faqe dyqaneve, kthehej e përplasej me hapat e rinj e ngjante si trokthi i një kopeje me kuaj të hazdisur. Ne shtangëm në vend. Sa ta merrnim vesh se ç'po ndodhë, (ose, më mirë të them sa të mblidhним veten) u fshehëm prapa një çifti shtyllash telefonike në cepin e rrugës që ndante shtëpitë nga sheshi i dyqaneve. Këmishëzinjtë, në rresht për dy na kalonin fare pranë. Në dritat e rralla të rrugës shkëlqenin helmetat e tyre ngjyrë deti dhe tytat e mitralozëve të dorës. Të gjithë kishin mitralozë.

Sa të hapje e të mbyllje sytë, ata u rreshtuan në njëshkolonë dhe i erdhën sheshit rrotull. Pastaj u dëgjua një britmë e ngjirur. Ata të gjithë, në një kohë, hoqën mitralozët nga supet dhe i mbanin në duar. Heshtje. Ashtu i mbështetur në shtyllë dëgjoja të rrahurat e forta të zemrës. Dikush krojti zérin dhe bërtiti përsëri. Ushtarët, siç ishin, u shtrinë sakaq përdhe me mitralozët në dy këmbëzat e ngritura përpara. Dhjetëra tyta u drejtuani nga dyqanet, nga shtëpitë. Dhe dhjetëra të tjera u drejtuani në anën tjetër, andej nga na mbeti Pipi.

U shkëputëm si hije nga shtyllat dhe vrapiuam përpjetë rrugicës që të nxirrte prapa dyqaneve. Në fund të saj, sa do të hidheshim për të kapërcyer gardhin e parë, na doli përpara, sikur mbiu nga dheu xha Brahoja.

— Xha Braho!

— E di, bij, e di. Zunë rrugën qentë e zinj! Zunë sheshin. Po të gjitha shtigjet nuk i zënë dot. Shtëpitë kanë edhe deriçka, rrugët kanë edhe rrugica. Eh, ç'do të lëvojë sot, more djem! Eh, more, eh! — dhe papritur xha Brahoja ia mori nën zë:

*Ç'është kështu, ç'po dëgjojmë?  
Po bëhet dyfek në Vlorë,  
shqiptarët po luftojnë,  
me një mbret dyzet milion.  
Po me se luftojnë, vallë?  
Me sëpata, me hanxharë!*

Dhe po ashtu, papritur e ndërpreu këngën:

— Dëgjoni! Po të më thoni të drejtën, ama. Ju vanë shtatë, kur i drejtuan ato tytat nga ana juaj, apo jo?

Ti kafshove buzën. Pastaj shtrëngove nofullat. Nuk e kishe pasur këtë zakon. Ti po ndryshoje.

— Eh, more djem! Po nuk zbrazen vetë ata të shkretë mitralozë, more, jo. Do një pendë që ajo e shkretë këmbëzë të tërhiqet. Do zemër...

\* \* \*

Atë ditë nuk punuam. Pasdite, pas demostratës, tek po ndanim përshtypjet me Pipin, u fut në dyqan një njeri me uniformë, me pantallona të gjata, xhaketë me katër xhepa, kapele me strehë, me një çantë të madhe në kurriz dhe me një tufë letra në dorë.

Ai, me të hyrë te praku, bërtiti:

— Kush është Çomja nga ju, more?

Neve na shkoi mendja për keq. Nuk arritëm të flisnim, por vështrimet që shkëmbyem i shprehën bukur mendimet. «Na paskan pikasur. Me siguri na thérresin në karabinieri!» Ti e mbloqhe veten shpejt. Fute duart në xhepat e pantallonave, poshtë te pul-pët dhe the:

— Unë jam. Ç'kishe zotrote?

— E, letër kam, a rrënjjëdalë, e ç'do të kem tjetër!? Po është shkruar si me këmbët e pulës. Adresa e dyqanit sipër dhe «për Çomen» poshtë. Sikur është Çomja mbret... Dhe mbretit dhe ia bëjnë pak më të gjatë adresën...

Mua më shkruiu gjaku. U derdha i pari e mora letrën. Postieri kapadai u largua me një buzëqeshje nën buzë. Unë, kur kisha parë adresën, e paskesha mbajtur kokëposhtë.

Një pusullë e vogël. Ja dhe një tjetër. Nënët tona dikujt i kishin diktuar fjalët e tyre të zemrës për ne. Na i lexoi Pipi. Të dyja letrat ishin njësoj, kishin vetëm një ndryshim të vogël. Njera fillonte me emrin tim, tjetra me tëndin. Përbajtja ishte po ajo:

«*I dashuri djali im, Çome, të puth sytë me mall. Paratë që na dërgoje i morëm. Të lumtë dora e paç faqen e bardhë! Blemë një çikë misër...*

Po mirë, more djem, rrofshi për paratë, po nuk gjetët dot dy gisht letër e një njeri me gramë që t'i thoshit dy fjalë dhe të çmalleshim dhe ne!? Çome, të keqen nëna, mos më lërë pa letër. Dhe ruaju nga të ftohtët! Me të gjetur një njeri të sigurt, do të të dërgoj edhe një palë çorape me qafa...»

Pipi, me të mbaruar letrën, filloi të na ngacmonte. «Të keqen nëna, ruaju nga të ftohtët!»

— Epo kjo pikë e zezë — the ti me të qeshur,  
kur ramë për të fjetur. — Na tall Pipi, apo s'na tall.  
Po dhe ne, ama, kot bëjmë që nuk i vihem i abe-  
tares. Mësuesi na ka thënë kaq herë. — Dhe diç  
shtove tjetër për ta ngacmuar Pipin, por ai as që të  
dëgjoi. Pipin, me të vënë kokën mbi xhaketën e  
palosur, e kishte zënë gjumi. Dhe kishte të drejtë.  
Natën që shkoi kishte fjetur a s'kishte fjetur tri orë.

## VIII

### ... NE HYMË NË VALLE

Aq ishte. Pastaj ty të doli frika. Më kujtohet ajo natë, kur shpérndave komunikatat shkruar italisht te kazermat e ushtarëve italianë, rrëzë ullishtave.

— Bjeri, pa bjeri këtu! — i the Pipit, që deshi t'i hidhte nga telat në oborr. — Kam menduar një marifet që t'ua hedh mu mbi krevat, që sipër, si aeroplan.

Mbushe gjoksin dhe iu ngjite kodrinës. Shkove vetëm. Ne na le ndanë rrugës.

— Ju shtrihuni e bëni sikur flini — na the. — Po ju erdhi njeri, mos u zgjoni. Fukarenj jeni. Fukarai fle ku e zë nata... Kështu the dhe u bëre erë.

Tri roje kalove dhe asnjera s'të vuri re. Edhe neve na humbe nga sytë. Filluam të shqetësoheshim. Po bëheshim gati dhe do të të afroheshim, sikur të mos i kishin vajtur sytë Pipit mbi çatinë e kazermës së fundit. Një si hije zvarrisej mbi letrën katrama. Qëndronte paksa, pastaj zgjaste trupin poshtë, nën strehë dhe një dorë e shpejtë, sa të hapje e të mbyllje

sytë hidhte një tufë letra që sipër nga dritarja brenda në kazermë. Dhe ne të gëzuar filluam të përfytyronim se si përhapeshin ato e binin mbi kre-vatet e ushtarëve...

— I lumtë Çomes!

— Çome!? Ç'Çome, more! Ai është Tarzan. Shiko, shiko me ç'shkathësi hidhet nga një kazermë te tjetra!

Pipi mbeti pa mend atë natë. Sidomos kur u hodhe përsëri te kodrina dhe fillove të zbrisje në rrugë.

Si të përqafoi! Si të puthi! Dhe s'rreshtte së pyeturi. Po si hidheshe, xhanëm, si hidheshe aq leh-të? Si s'të ndien rojet?

Ti qëndrove i habitur. Pastaj vure buzën në gaz.

— E kam hapin të lehtë unë, s'jam gomar që të më pikasin rojet.

Dhe ne qeshëm, se na u kujtua se si disa ditë më parë, një roje, pasi kishte bërtitur tri herë «alt!», kishte qëlluar dhe kishte plagosur rëndë një gomar që ishte dhënë mbas barit të njomë ndanë telave me gjemba rreth kazermave...

— Po si u ngjite, xhanëm, si u ngjite? Këtë nuk e kuptoju unë — filloi përsëri Pipi.

Dhe ti, ashtu buzëgaz, sikur të flisje për një gjë fare të thjeshtë, na shpjegove:

— Kazerma e parë është ngjitur pas kodrës. Mbi katrama ka shtrirë krahët një ulli i madh. Hipë dhe... E di ky — dhe bëre shenjë me kokë nga unë

— kur u qepem atyre të shkretave pemë unë dhe...

— Dhe kujtuam dardhën e priftit. Rrugës ia tre-guam ngjarjen Pipit dhe ai u shkul së qeshuri.

Dhe ma the me të zbritur në pus.

— Dëgjo, ato dy napat me djathë qenë për xha Brahon. Xha Brahoja është komunist dhe me siguri është anëtar i njësitit guerril.

Unë as që e dija ç'do të thoshte «njësit». Ti ma shpjegove: «Ata janë komunistët më trima. Kryejnë detyrat më të vështira...»

— Po mirë, ku e di ti?

— Duket sheshit! Ato dy napat ishin plumb të rënda. Tani, kur na qerasi xha Brahoja me djathë, në copën tënde kishin mbetur të qarta format e fishekëve të revoles. Qenë fishekë naganti.

— Çfarë, ore!? Pse, ku ke parë ti fishekë naganti?

— E ka gjyshi. E ka fshehur në një vend. Kur ika, ma tregoi. Dhe sot me siguri do të bëhet ndonjë atentat. Pa lëre, ç'hotë xha Brahoja!

Unë vetëm pas fjalëve të tua i kuptova siç duhej ato që na kishte thënë xha Brahoja. Se ai na kishte lënë aq shumë gjëra pa thënë.

— Sot, kur të dalim nga puna, mos u largoni. Do të vijë një shok nga mali. Ai nuk i di dhe aq mirë rrugët e qytetit. Mund ta njohin dhe mund ta ndjekin. Ai mund të detyrohet të vrapijë. Po të jetë me bicikletë, s'dihet nga ç'rrugë do të dalë. Ju duhet ta ndihmoni. Do t'i tregoni rrugën më të sigurt. Po t'i afrohen shumë, do të ndërhyjmë dhe unë me Mullanë. Po ju përpinquni t'i ngatërroni ndje-kësit në krye të rrugës qorre. Ti — dhe xha Brahoja m'u drejtua mua — do të qëndrosh në ballë të rrugës me një karro dore të ngarkuar me dërrasa. Lëre atë të kalojë dhe ktheje karrocën këlliq, të zësh rrugën... Pastaj gjej ndonjë mënyrë për t'u marrë me-

ndjen ndjekësve që të mos e shohin ku do të futet ai shoku... Ndërsa ti, Çome, do të vish me mua. Do të shohim në vend rrugën dhe... nejse, ka kohë, shohim e bëjmë.

— Po në ç'rrugë do të rri unë, ku ta gjej karrocën...

— Po prit, or bir, prit! Ç'do gjë në kohën e vet. Eee... kështu e kanë këto punë. Shiko, Çomja i varfër s'pyet për asgjë.

Mua prapë më pushtoi një ndjenjë zilie për ty. Unë kisha vënë re edhe herë të tjera që ty të donte më shumë xha Brahoja (dhe jo pa të drejtë), por asnjëherë tjetër nuk i kisha pasur kaq shumë zili heshtjen tënde, durimin tënd, të përbajturit tënd. Kiske të drejtë xha Brahoja, ti ishe më i pjekur... Tjetër është se mua më vinte zili, ngaqë ti ishe disa muaj më i madh dhe po hidhje shtat më shpejt. Edhe fizikisht ishe më i fortë. Madje, një ditë Mullai tha me shaka: «Ore, Çome, mos e hidh shtatin shpejt, or babaçe, se nuk do të nxërë më pusi dhe do të të përzërë Kapua nga puna!» Ti vure buzën në gaz dhe heshte, ndërsa unë të dola krah: «S'ka gjë, Mulla, jo, se jam unë shtatvogël. Do të ngucem një çikë më shumë unë dhe...» Por Mullai ma preu: «Jo, jo, babaçe, edhe ti duhet të tritesh! Po di ç'të bësh ti, që të zgjatesh një çikë? Kur të ulim e të ngrejmë ne, mos rri galic, në fund të kovës, por varu me të dyja duart në litar, ashtu siç bën Çomja, që të zgjatesh.» «Posi», ndërhyri xha Brahoja, duke buzëqeshur nën mustaqet që kishin filluar t'i thinjeshin ndanë e ndanë. «Posi! Dhe të bëhesh më i hedhur... Se jeta, more bir, kërkon pelivanë. Jo vetëm sot, që jemi në luftë, po kurdoherë. I shkathëti kurdoherë...»

Dhe xha Brahoja, si zakonisht, e la të papërfunduar mendimin. E kishte këtë xha Brahoja. E dinte dhe vetë, madje dhe e mbronte këtë, kur shkëmbente ndonjë fjalë me Mullanë që kërkonte të thuheshin gjérat troç. «Eh, more bir! Fjala, po e nxore nga goja, fluturon. Prandaj i do lënë nga një verigë fjalës, që të kesh ku të mbahesh! Se janë kohë të këqia. Për një fjalë goje të merr tjetri e të rras brenda. Tjetër është kur ta sjell në majë të hundës, si puna e atij M... si e quajnë atë Mu... Myrtezait. Atëhere thua: ja unë, ja ai, ja bromb, ja bomb!»

I kishte ngelur pëng xha Brahos që s'ia kishte hequr një herë turinjve atij zotit Myrteza. Se bënte ç'bënte, e fuste në bisedë. Mbase e kishin kritikuar edhe shokët që kishte dalë aq hapur atë mbrëmje, kur u zu me zotin Myrteza. Kushedi, se mos merrnim vesh shumë gjëra ne atëhere!

\* \* \*

Kantieri i vogël ku ngrihej frigoriferi dhe punishtja e gazozave ndodhej në një fushë të hapur ranore pranë detit, në krah të djathë të Skelës. Që andej dukej moloja si në pëllëmbë të dorës. Asnjera nga ndërtesar rrëth sheshit të gjerë dhe në të dyja anët e rrugës që të nxirrin në molo nuk ishte aq e lartë, sa të fshihte prapa shpinës së saj direkët e gjatë të anijeve, bile edhe oxhakët e vaporëve ushtarakë të lyer me tri ngjyrat e flamurit italian. Nga qyteti kantieri ishte më larg se nga Skela. Për të arritur te shtëpitë e fundit më kallama të qytetit

duhej të ecje ndonja njëzet minuta të mira. Qyteti dukej vërtet interesant që këtej nga fundi i tij. Në fillim ishin kopshtet e rrethuara me lloj-lloj materalesh, druri e hekuri, që nga listelat e kallamat, deri te drizat e ferrat e prera, që nga dyert dhe shasitë e maqinave të vjetra, gjer te shtyllat prej hekuri e copërat e telave me gjemba. Dhe ndanë çdo kopshti, në krye ose në fund, pranë puseve ku shtriheshin si këmbë të ndera lejlekësh direkët e kovave, do të shikoje nga një tendë, përparrë së cilës gruaja dhe fëmijët e bastanxhiut, sipas stinës, që-ronin e lanin zarzavatet.

Në këtë territor rrugët e qytetit zgjeroheshin gjersa shpërndaheshin e treteshin ledheve, si ujët e ndonjë burimi në ndonjë arë ranore.

Si kapërceje kopshtet, të dilnin kasollet prej kallamash, të lyera me baltë. Në fillim ato shkëmbësheshin, aty këtu, me barraka të vogla dërrasash, por kjo vetëm në fillim se pastaj, radhiteshin njera pas tjetrës, gjersa më lart ua linin vendin shtëpive përdhese me dy-tri shkallë guri, me rrugicë të shtruar me kalldrëm ose edhe me çimento. Kopshtet rreth këtyre shtëpive ishin të rrethuara më bukur, me mure të ulëta e kangjella të larta, puset e tyre ishin me pompa, me gryka të mëdha betoni në krye dhe të shtruara rreth e përqark me çimento. Më lart shtëpitë ishin dykatëshe dhe avllitë e tyre prej guri mbaronin në një kulm gëlqereje ose çimentoje të mbushur me copa qelqesh e gryka shishesh të thyera, të kthyera përbys. Afër qendrës, pranë sahatit të madh të qytetit, rreth sheshit të tij shtëpitë arrin edhe në tri kate...

Ky ishte një qytet i çuditshëm, i ngritur rrëzë një kodre plot ullinj dhe, kur shihje që lart, nga kjo

kodër, të dukej si pjesë e saj, të linte përshtypjen sikur ishte një gjigant që mbështetëj në mal, që ishte shtruar këmbëkryq, kishte shtrirë mbi rërë, në drejtim të detit, të dyja duart e tij përrallore me të dhjetë gishtat hapur. E sheshi midis qytetit dukej si boshllëku midis dy pëllëmbëve të puqura pas rrërës. Në mes godinat ishin të dendura e rrugët thuajse s'dukeshin fare, si kurrizi i dorës. Dhe ndonjë vendë prej xhami dukej si unazë që shkëlqente në gishta, në vargun e gjatë të shtëpive.

Ne kapërcyem fushën që na ndante me një nga këto lagjet e fundit të shtëpive, ecëm buzë ledheve të ca kopshteve dhe pastaj dolëm në një nga të katër rrugët e drejta që ngjiteshin në qendër.

Ishte fillimi i majit. Vapa nuk kishte filluar ende, por në atë kohë që ecnim ne, pas punës, andej nga ora tre rëra ishte e nxehur e krijonte zagushi, madje, kur ktheje kryet nga ana e detit, shikoje si thurej një tis i shkëlqyeshëm rrezesh që të detyronte të kapsallitje sytë për të rikthyer qartësinë e shikimit.

Ne ishim të tre; unë, ti dhe xha Brahoja. Mullai se nga na ishte zhdukur. As që e pamë kur iku, se s'na tha as «me të mira, djem!», siç e kishte zakon të na thoshte në rastet e rralla kur nuk kthehetëm të gjithë së bashku te Pipi.

Pâ dalë mirë në qendër të qytetit, xha Brahoja u kthye nga e majta, në një rrugë të shtruar me gurë të mëdhenj lumi dhe ne, sa bëmë dhjetë hapa, fare papritur u ndodhëm përpara një hangari me dyer të mëdha, të hapura, ku e para gjë që na bëri përshtypje ishte një pizgëllimë shurdhuese. Dukej sikur ulërinin njëherësh dhjetë ulkonja zëholla, pas-

taj, si merrnin frymë, ulerinin serish me një ton më të lartë e më rrëqethës...

Qenë dy sharra hark që çanin dërrasa. Kur iu afroam atyre (ne e ndiqnim xha Brahon këmba-këmbës), unë e kisha humbur fare dëgjimin. Veç shikoja se si fliste xha Brahoja me një djalë të ri të veshur me kominoshe, që sillte një metër druri nëpër duar e më dukej se belbëzonin. Më erdhi për të qeshur me veten. Kështu qeshnim ne nganjëherë në fshat me shurdhin Kike, që dinte «të lexonte» mendimet. Ne belbëzonim dhe ai, nga lëvizjet e buzëve, pa nxjerrë ne ásnjë fjalë nga goja, e gjente ç'i thoshim... Të kujtohet Kikja, apo jo? Shkoi kot fare, i shkreti Kike. E vranë gjermanët në pazarin e qytetit. Ata kishin shpallur shtetrrethimin dhe kontrollonin këdo. Kikja u kaloi përpura, u tundi një herë kryet, kinse i përshëndeti dhe u ktheu kurrizin. Mirëpo ata deshën ta ndalonin. Për t'iu afruar, s'u mbante t'i afroheshin. I bërtiten nja dy-tri herë: «Alt!», «Alt!». Ai po, malum, as i dëgjoi dhe ata e qëlluan që prapa me një breshëri automatiku. I shkreti Kike!

Ja kështu dhe unë, si Kikja, nga lëvizjet e buzëve përpinqesha të merrja vesh ç'thoshin. Po më kot. Dhe vetëm kur xha Brahoja dhe ai djali m'u afroan fare pranë, dëgjove: «Domethënë ky djali do të marrë dërrasat e zotit Laze? Dhe ju thoni se jeni bahuçevani i tij? Mirë. Po ju besoj. Ja ku e keni karrocën të ngarkuar». Dhe djaloshi zgjati dorën në një kënd të oborrit të gjerë, përpura hangarëve, ku nën një stivë të madhe me trarë qendronte e mbështetur mbi dy rrota gome dhe mbi dy këmbëza te meshkujt një karrocë e vjetëruar e mbushur plot e përplot me dërrasa dhe qepra të gjata. Unë e kup-

mendjen as te boria e vazhdueshme e kamionçinës, nga kabina e së cilës më dole ti, sikur mbive nga dheu. Më kujtohet si tani, ti zbrite i kuq flakë në fytyrë, me ballë të djersitur dhe fole me inat:

— Hap, ore, rrugën! Kur s'je i zoti të mbash një dërrasë, pse merr përsipër të shtysh një karrocë plot e përplot! — dhe m'u afrove të më ndihmoje që ta nxirrnim rrotën nga një gropë dhe t'i hapnim rrugën kamionçinës. Por ti i fute më keq dërrasat nën maqinë dhe rruga u zu krejt. Ndërkaq kishin ardhur karabinierët dhe policët me pushkë në duar. Eh, ç'u bë atje! Mënjanë bërtisje ti, mënjanë bërtiste dhe i binte borisë shoferi, mënjanë filloj të grindej një marshall se policët ishin treguar të ngathët dhe dukej sheshit se s'ua kishte ënda ta ndiqnin nëpër rrugica atentatorin... Pastaj marshalli, iu shkreh shoferit, shoferi ty, ti mua... Po sa bukur e luaje rolin; pa! Të thoshe se ne të dy shiheshim për herë të parë.

Ndërkaq fashistët blokuau lëvizjen dhe filluan të kontrollonin shtëpitë më të afërtë. Aty ti më le pa mend. Iu afrove pa të keq fare një polici dhe e pyete se mos kërkonin atë djalin që «shtiu kundër atij oficeri të lartë, kur po delte nga dera e Bashkisë».

— Po, po — tha polici me një interesim të shtirë.

— Dhe e kërkon këtu?! — ti lëshove me ironi buzën e poshtme. — Po atë tani sa e pashë unë. Sapo kaloi në rrugicën tjetër. Kishte një revole në dorë...

Polici shkoi i raportoi marshallit. Dhe ai e pezulloi kontrollin. Aq më tepër që edhe një fëmijë tjetër, të cilën e kishte pyetur vetë, i tha se kishte parë një njeri me revole në dorë që shkoi me vrap

në rrugën tjetër... Çfarë organizimi! Kush ta kishte organizuar këtë aksion, vallë? Këtë unë as sot nuk e di... Veç ai bëri bujë të madhe. Çfarë s'thoshin për djaloshin cë i doli përpara kuestorit që shoqërohej nga tre policë dhe i tha: «Kështu i dënon populli tradhëtarët e atdheut!» Dhe ia numroi mu në ballë. Dikush shtonte se djaloshi, fare gjakftohtë, i qe afruar dhe i kishte thënë se kishte dy fjalë. Kuestori kapadai i qe përgjegjur: «Ç'ke, more rjepacak!» «Ja, dua të provoj a e shpojnë lëkurën tënde të krimbur plumbat e komunistëve. Populli të ka dënuar me vdekje!» — i kishte thënë djaloshi. Dhe ia kishte numruar. Kjo, thoshin, ndodhi sepse kuestori e hiqte veten për trim dhe mburrej se nuk e zinin plumbat e komunistëve. Sido që të ishte, ai u shtri shakull mbi pellgun e gjakut të tij të pluhurosur, ndërsa rojet u hutuan aq shumë, saqë s'vunë dot re jo vetëm fytyrën, por asnjë shenjë dalluese të atentatorit. Kjo, siç morëm vesh, e kishte tërbuar fare marshallin që ishte vënë në ndjekje.

Pas këtij aksioni ti u bëre më i myllur. Unë çuditesha më ndryshimet që po ndodhnin në karakterin tënd. S'dija si t'i shpjegoja. Atëhere nuk i kuptoja mirë ligjet e ashpra të luftës dhe, më kujtohet, t'u zëmërova një herë. Të pyeta pse kishe hipur në kamionçinë. Ti më pe me ngulm drejt e në sy. «Nuk e kuptove?», — deshe të thoshe. Unë e kisha kuptuar, veç desha hollësira. Ti shtrëngove nofullat, shtire buzën në gaz dhe, pasi buzëqeshë me mua, si ndonjë i rritur me një të mitur (mua ky qëndrim më zëmëroi më shumë), më the:

— Dëgjo, babaçe. Si thotë Mullai, lufta ka ligje të ashpra. Luan me kokën. Por këtu nuk është halli

i kókës, éshtë halli i shokëve, éshtë halli i punës. Prandaj secili kryen detyrën që i ngarkohet dhe s'flet. As në gjumë me veten e vet s'flet.

Kjo ishte hera e parë që po flisje aq seriozisht me mua. Ti po ndryshoje. Ndoshata sepse ne të dy s'punonim më bashkë. Për të fjetur ti vije vonë, në mëngjerez ngriheshe herët. Unë lodhesha, këputeshë gjithë ditën e ditës më këmbë. Tanimë i jepja të drejtë Pipit që e zinte gjumi me t'u shtrirë mbi karrige dhe me të vënë kokën mbi xhaketën e palosur.

\* \* \*

Punimet në pus mbaruan. Sollën një vinç dhe zbritën tubat e gjerë prej betoni. Vendosën gjithsej 4 tuba të tillë. U ngrit edhe ndërtesa e frigoriferit dhe e punishtes së gazozave. Mua më përzunë nga puna. Ty të mbajtën që të punoje së bashku me Mullanë për transportimin e arkave me piye freskuese dhe të akullit nëpër klientë. Mësuesi më tha se kishte biseduar me ustanë e Pipit që të veja dhe unë të punoja atje. Kjo gjë më habit, se puna ishte pakësuar dhe ustai e kishte hequr bile edhe tabelën e re «Bar-restorant» dhe kishte vënë të vjetrën, «Restoran-bulmetore». Se gjithë klientelën e barit e thithi, si një magnet gozhdët e vogla të këpuçarëve, një «Bar-kafe» me drita, që ndezi nja pesëdhjetë hapa më larg, në një godinë më të mirë, një italian. Italianët as i hidhnin më sytë nga ne, po shkonin drejt e te ajo kasierja e bukur në krye të «Barit», ku

grumbullohesin si bletët mbi një copë mjaltë. Nuk e di kush tha një herë me të tallur, ti a Mullai, s'më kujtohet: «Italianët janë gati ta porositin një gotë verë katër herë, vetëm të kapërcehen dy herë më shumë përpara buzëve të kuqe të kasieres». Ajo ishte e re, e bukur dhe e mbante me qëllim derën e kullës së vogël prej xhami gjysmë të hapur, që t'i duke-shin pulpët gjer rrëzë kofshës. Po kështu, me qëllim ngrihej edhe më këmbë e përkulej mbi paratë e tallonat, t'u jepte rast klientëve të shikonin se ç'fshi-hej dekolteja, që dhe ashtu mezi mbahej mbi supet e rrumbullakëta. Më kujtohet, ti e kishe shumë inat atë dhe e quaje «bushtër», megjithëse ajo, siç të ngacmonte Mullai, të kishte përkëdhelur cullufet dhe s'kishte dashur të të mbante as të hollat për akullo-ret, që herën e parë kur vajte për të qerasur Mullanë. Dhe Mullai nuk më hiqet nga mendja. Ç'njeri ishte! Ku e gjente gjithë atë humor e optimizëm?! Nuk e dëgjova një herë të ankohej, paçka se e kishte kurri-zin tërë kallo.

## IX

### KU VAJTI PIPI? KU U ZHDUK XHA BRAHOJA?

Një mbrëmje, kur po rregullonim karriget për të fjetur, ti m'u afrove dhe më the:

— E more vesh? Zoti Myrto ia zuri vendin kuestorit të vrarë. Kishte hak xha Brahoja i varfër!

— Jo, more!

— E pashë sot, kur çova akull tek italianka, po e di si më erdhi, apo jo? Ishte ulur me një bushtër tjetër në tryezë dhe diç po pinte, duke u zgërdhirë. Qe veshur kokë e këmbë me të zeza. Çizmet me qafa të ngrira i vetëtinin. Mirë thoshte xha Brahoja i varfër, ka kohë që ha në atë grazhd ai. Po...

— Ore, Çome, ku u zhduk xha Brahoja? Vajtën dy javë që s'e kam parë...

Të them të drejtën, më kishte marrë malli për xha Brahon. Atë ditë që u mbaruan punimet dhe Kapua nuk e kishte caktuar më në punë, më erdhi keq për të më shumë se për veten time. Por ai vetë s'e kishte për pesë. «Eshtë mësuar», thashë pastaj. «Ehu, sa herë ka mbetur pa punë në jetën e tij

xha Brahoja!». E dija se nja dy herë e kishte pu-shuar nga puna vetë zoti Myrto, kur kishte qenë në AIPA. Një herë bile, kishin dashur ta futnin edhe në burg se kishte mbledhur punëtorët, u kishte folur dhe ua kishte mbushur mendjen të bënин grevë. Greva qe bërë se punëtorët italianë, megjithëse kishin punët më të lehta, trajtosheshin më mirë e paguheshin më shumë. Një herë tjetër ishte zënë me zotin Myrto për punën e vajgursjellësit që ndërtohej nga Ku-çova në Ujët e Ftohtë.

«Ja, tani do të na e vjedhin naftën ditën me diell», kishte thënë xha Brahoja.

«Nuk e vjedhin, po e marrin ta ripunojnë!»

«E pse s'ndërtojnë distileri këtu, a rrënjjëdalë?!»

«Ehu, ti i ke marrë zët italianët që në njëzetën. Edhe shëndet të të thonë, plaç të duket...»

«Jo, po do t'u lëpihem si ti!»

«Kujt i thua...»

«E, ore, ty të them.»

Zoti Myrto qe bërë gati ta qëllonte por xha Brahoja e kishte përfshirë për xhakete dhe e kishte flakur mbi një vandak me shpendra në anën tjetër të rrugës, ku e kishin mpleksur këtë bisedë. Atëherë edhe e kishin gjobitur. Ia kishin mbajtur rrrogën e pesëmbëdhjetëditheshit.

— Po ti, dëgjon ç'po të them, apo jo? Zoti Myrto është bërë kuestor.

— Epo mirë, ç'lidhje ka kjo me xha Brahon!

— Sa i trashë tregohesh nganjëherë! Ata të dy e kanë halë në sy njëri-tjetrin, ti thuaaa... E di ti që gjer tani... Nejse. Më thoshte Mullai dje se gjer tani xha Brahoja ka kërkuar tri herë leje për ta vrarë atë qen. Dhe nuk e kanë lejuar.

— S'e kanë lejuar? E kujt u paska marrë dorën pér të vrarë një qen të zi, si ai?

— Përgjegjësve kryesorë, kujt? Pse, ç'kujton ti, se bëhen atentatet me të tekur?

— Po ai le ta vrasë, ashtu vetë, pa bërë atentat.

Ti heshte. Pastaj queshe. Ishte errët dhe nuk ta pashë shprehjen e fytyrës, por me siguri do ta kesh tundur kryet si pérpara një fëmije, kur dëgjove këto fjalë. Dhe pér çudi, nga e qeshura jote, kësaj here s'po më vinte më inat, si zakonisht, kur t'i tregoheshe më i rritur. Përkundrazi, u binda se edhe ata muaj që ishe më i madh se unë nuk qenë pak, ashtu siq kisha menduar më parë.

Dhe ti e theve heshtjen përsëri:

— Kështu që xha Brahoja s'mund të punonte më në qytet. Ai iku me urdhër. Mullai më tha se edhe Pipi do të largohet. Dhe punën e Pipit tanë e tutje do ta bësh ti... por e kupton çfarë do të thotë kjo, apo jo? Kjo do të thotë se ndonjë nga ato napat me djathë mund të vijë në adresën tonë... Dhe tha-sët pér të mbushur mataratë me komunikata nuk do të t'i sjellë më Mullai, por do të vemë t'i marrim vetë...

Të them të drejtën, mua atëhere shoqëria jote m'u duk e domosdoshme dhe të thashë:

— Me ndihmën tënde jo ato, por... Mos ki merak. Do t'i bëjmë.

— Dhe unë jam i bindur që do t'i bëjmë! Nejse, do të të flasë vetë Mësuesi më gjatë. Ai më foli sot dhe mua... Kështu, babaçë, si thotë Mullai. Prandaj t'i vemë gishtin kokës.

Deshalbe të pyesja më, por u përpoqa t'u jepja vëtë përgjegje pyetjeve që më buronin njera pas tje-

trës. Më erdhi keq për ty. Desha të flije ti, ndërsa për vete s'kisha gjumë. Për xha Brahon e kisha të qartë se ku kishte shkuar: në çetë. Eh, mor xha Braho! Prandaj më hoqi mënjanë, më shtrëngoi në gjoks fort, më puthi faqen sa më shpoi me mjekrën e thinjur dhe më futi në xhep një kaush me karamele! Prandaj iu përlotën sytë. Unë thashë se i kishte ashtu të ndezur nga duhani i fortë që pinte, po jo! Si nuk e kuptova më parë! Ai më foli aq hapur:

— Dëgjo, bir, ruaje Çomen! Se është pak i rrefkët ai. Ruaj veten dhe shokët. Se këtë valle do ta hedhim gjer në fund. Jemi arbër ne. S'jemi mësuar t'i lëmë në mes vallet e dasmës, edhe kur marrim mandatën e djalit të vetëm. Kështu, bëhu burrë! Dorën këtu. Ashtu, të lumtë! Ah, të keqen xha Brahoja ty! Po ti je akoma i vogël, more! Skamje, skamje! Dëgjo. Dy armiq kemi pasur ne shqiptarët: të huajt dhe ata që na kanë lënë në skamje! Je ti për punë? Po s'ka gjë. Lufta do të të burrërojë. Lufto gjer në vdekje! O ne, o ata. Po do t'i vrasim qentë! — dhe u kthyeshpejt që të mos i shikoja sytë e përlotur... Eh, xha Braho, xha Braho! Ç'njeri ishte! Jo ti, o Çome, që ke mbetur djalosh gjashtëmbëdhjetë vjeç, por edhe unë, që tani po i kaloj të dyzetat, s'kam takuar tjetër njeri si ai. Kur e shihja ashtu të butë e të dashur, thosha: «Nga vajti gjithë ajo ashpërsi, ku vajti ai vështrim i egër, ku dukej sikur pasqyrohej zjarri i një vullkani të mbarsur gjer në grykë me llavë?» Kur e shihja ashtu të ashpër, me ballë të rrudhur, me cigaret e dredhur vetë midis gishtave gjerdallë, thosha: «Ku e mban ajo zemër e përvuajtur gjithë atë butësi e dashuri për njerëzit, ku gjen vend ajo midis asaj urejteje të grumbulluar në

shekuj? Ku ka vend atje për të mbajtur një dashuri kaq të madhe për fëmijët e të tjerëve, për shokët e hallevë?»

Ç'më vajtka mendja sot, kur e kujtoj, tek ai mali që rrinte galiç mbi qytetin ku e njoha, që buzëqeshte e shkëlqente me njëmijë ngjyra dimër e verë, nën rrezet e diellit, sidomos pas shiut dhe shikonte ashtu vrenjtur, paksa vëngër, tejpërtej mjegullës e reve që donin t'i zinin sytë. Si i çante retë, si dilte mbi to! Si i priste ai rrufetë e qiellit të zemëruar që donte t'i ulej përsipër. Ç'më vajtka mendja, kur e kujtoj, tek ai det i gjerë që qeshte dimër e verë nën rrezet shpresëdhënëse të diellit e daldisoj, e frynte e shfrynte gjoksin e tij thinjak pas shkëmbinjve, kur varej mbi ta reja e zezë e shtrëngatës kur e dokëndisnjn erërat...



Atë mbrëmje ty të zuri gjumi shpejt. Mua s'po më zinte. Po prisja Pipin. Doja ta pyesja se ku kishte ndër mend të vente ai, që po më ngarkonin mua me detyrat e tij. Isha shtrirë dhe po shikoja fashat e gjata të dritave të rrugës që hynin nga të çarat e qepenave. Çudi me ato drita! Rrezet vinin si pluhur i artë që lëvizte vazhdimisht gjer në mes të sallës, duke çarë errësirën në formën që merrnin kur hynin te të çarat, pastaj dukej sikur ai pluhur tretej në errësirë. Papritur një fashë drite u ndërpri. Tek e çara dikush mbështeti trupin. Pastaj rrezja e dritës çau përsëri errësirën dhe u ndërpri tjetra, në të çarën e qepenit tjetër. Dikush

po përpinqej të shikonte brenda. «Kush të jetë vallë? Ndonjë ushtar italian i pirë? Apo është ndonjë nga punëtorët e gurorës që s'ka arritur të hipë në kamionin e fundit dhe ka ardhur me ndonjë mjet të rastit? Apo është ndonjë spiun?» Se ditët e fundit spiunët ishin shtuar shumë. Ata i pikasje menjëherë, se rrinën e pinin duhan në ndonjë tryezë vetëm për vetëm, me ndonjë gotë raki përpëra, duke pritur me ankth që t'u ulej atje qoftë edhe një tietër. Sa për të këmbyer ndonjë fjalë dhe për të humbur gjurmët. Apo ndoshta edhe se kishin frikë nga atentatorët. Ata i pikasje sakaq edhe në qoshet e rrugëve, mbështetur pranë ndonjë qepeni apo shtylle, me fytyrë të verdhë dyllë nga pagjumësia dhe tmerri i përditshëm. E, duke thithur ashtu, si të pangopur, cigare, pas cigaresh dukej sikur u depërtonte tymi e nikotina nën lëkurë...

U ngrita në majë të gishtave dhe pashë jashtë nga vrima ku futej hekuri i qepenit. Postjeri! Ai postjeri me uniformë, me kapelen me strehë të fortë si të studentëve dhe me çantë përpëra. Kishte lënë biçikletën mbështetur te një shtyllë dhe po shikonte i çuditur brenda. Ç'është e drejta, nuk kishte ardhur ende koha për të mbyllur dyqanet, por Pipi dhe ustai i tij se ç'kishin një punë dhe ne i mbylliën qepenat me kokën tonë. Mua m'u kujtua se si postjeri qeshi me qesëndi atë ditë, kur unë mbaja letrën së prapthi dhe më vajti menjëherë mendja se edhe ky mund të ishte spiun. «Do ta hap derën, thashë. Do t'i fut një të sharë dhe një të pështyrë dhe do ta mbyll menjëherë. Ç'do të më bëjë? Apo të zgjoj edhe Comen? Jo! Le të flerë!»

Ndërkaq postjeri i ra derës dy-tri herë rresht me

majën e këpucës. E hapa. Por, në vend që ta shaja, e futa brenda.

— Mos i ndiz dritat! — më tha. — Na këtë letër dhe çoja me vrap Mësuesit. Po s'e gjete atë, gjej patjetër Mullanë. Po tani, ama! Pas njëzet minutash zihen rrugët dhe shkon si qeni në vresht.

Unë as që e vura re se ishe ngritur edhe ti.

— Ky nuk e lë dot vetëm dyqanin, se vijnë çobanët i sjellin djathë, qumësh, por po shkoj unë.

— Aq më mirë! Po tani, ama! Erdhe? Akoma... Unë vëja dhe vetë, po s'bën...

Dhe ti fute letrën në gji e çave sheshit përpjetë:

— Po s'erdha gjer në «kopri fuoko», mos më prit. Asnjeri mos prit... — më pëshpërite para se të ikje. Dhe, sa hapa e mbylla dy herë sytë, u zhduke. E mbylla derën me çelës, i vura dhe një tryezë nga mbrapa për siguri dhe u shtriva përsëri. Por gjumi më ishte arratisur fare. Pas pak në trotuar filloj hapi ritmik i karabinierëve. Kishte filluar shtetrrethimi. Patrullat qëllonin kudo, në mes të rrugës, pa paralajmëruar fare, sidomos andej nga lagjja e Kumeve ku kishte zënë Mësuesi një dhomë me qera. Nga fundi i qytetit, ku kishte shtëpinë përdhese Mullai, që edhe më keq, megjithëse andej patrullat qarkullonin rrallë. Kishin frikë ta çanin atë errësirë të dendur me fenerët e dorës, së bëheshin objekt i plumbave dhe i gurëve... Edhe kalamajtë i qëllonin me llastiqe.

Edhe ti atë natë nuk erdhe. Si të kam pritur!

Erdhe në mëngjez bashkë me barintjtë. Ishe i shqetësuar. Dukeshe menjëherë, se shikoje truallin dhe shtrëngojënofullat. Mua s'më pritej sa të largoheshin barintjtë e të të pyesja. Po ti, me të zbrazur

qumshtin, u ule galiç për të futur në matare rrrotullat me komunikata dhe fillove vetë. Nuk e kishe zakon. Dukej që ishe i ngarkuar shumë me mbresa e emocione. Nuk i mbaje dot në gjoks. Doje të flisje. Kushedi, mbase dhe ti mezi prisje sa të gdhihej, si dhe unë, që numroja sa herë çanin e riçanin errësirën fashat e dritave të rrugës, që hynin nga të çarat e qepenave. Përpinqesha ta përcaktoja nga hapat se çfarë ishin ata, kur shkonin e ktheheshin patrullat e milicëve, xhandarëve dhe ushtarëve me hap të rëndë mbi trotuar. Më iritonin sidomos përplasjet e këpuçëve të rënda me gozhdë të dala të ushtarëve alpinë. Kishte ardhur një regjiment i tërë alpin në qytetin tonë atë ditë. Se do të fillonin një «operacion spastrimi» në zonën malore, ku çeta qe bërë batalion. Thoshin se operacioni do të fillonte në shkallë të gjerë në qershor. Oh, si ma bënte te tëmthat ajo jehona e këpuçëve të tyre. Sa herë ua shava pendën atë natë. Dhe përsërisja papra fjalët e tua, kur folëm për ata ushtarë: «Do t'u bien pendët, do t'u bien! Veç të shikosh se c'gërxhe janë ato! Më keq se brinjët tonë». Ti apo i kishe parë ato vende, kur vajte e bujte një javë të tërë në shtëpinë e xha Brahos.

\* \* \*

— Dëgjo! Mullanë e zunë.

— C'thua?!

— Mbrëmë është bërë njera. Unë nuk arrita dot në kohë. Jo, unë arrita, por as Mësuesin, as Mullanë nuk i gjeta në shtëpi. Më vajti mendja mos ishin në

një vend tjetër dhe shkova atje. Nuk e dija në se kishte rënë sinjali i shtetrrethimit ose donte dhe tri-katër minuta të binte. Unë isha ende në krye të rrugës... Kur q'të shoh: u ndal një kamion dhe prej tij zbritën me vrap milicë e policë kuesture. U ndal dhe një tjetër. Dhe një... Po rrethonin gjithë lagjen. Shyqyr që arrita të fshihesha prapa një rogoevecke. U ngjita si mace dhe u hodha në avllinë e parë. Pastaj nga çatia në çati, arrita te vendi. S'deshën të më linin brenda. Mezi më futën, pasi ia dhashë letrën Mësuesit. Hyra në bimsë. Ç'të shikoja! Aty Mullai, aty Pipi! Qenë nja dhjetë. «Shpejt — u them, se po rrethojnë lagjen!» Ata e kishin parashikuar dhe rrithimin. E kuptova, sepse dikush u tha: «Shokë! Të shpërndahemi sipas planit! Kujdes! Shtini vetëm kur nuk ju mbetet rrugë tjetër!»

Mullai dhe nja dy a tre të tjera u caktuan për të mbuluar tërheqjen e shokëve kryesorë.

Dhe Mullai e kreu siç duhet detyrën e tij. I mbajti fashistët njëzet minuta vetëm, nën zjarrin e revolverit e të bombave. Kushedi sa shtriu atë natë. Mirëpo, kur kishim dalë të gjithë jashtë rrezikut, jo vetëm shokët kryesorë, por edhe unë, në kohën kur po kapërcente një gardh për të ikur dhe ai, plagoset në këmbë. I ranë dhe një herë... Mbeti në vend pa ndjenja. E kapën. E kanë futur në spitalin e burgut. Kishte vajtur vetë zoti Myrto e kishte parë. Dhe kishte thënë: «Ja, kush paska qenë! Këtë rjepacak do ta var vetë me duart e mia. Të gjithë kam për t'i varur. Të gjithë. Po të mos e shuaj farën e komunistëve brenda muajit, le të ma ndërrojnë emrin, le të më thérresin...»

Pastaj ishte përmendur e nuk e kishte zgjatur.

Kishte hak xha Brahoja i varfér! Ai duhej qëruar me kohë. Kushedi si do ta torturojnë Mullanë!

— E, a rrënjjëdalë, se do ta gjejë dhe ai kokën e kandilit, mos ki merak, Çome vëllai — tha bariu i ri me zërin e trashë që kishte sjellë napat me djathë.

Ty të shkrepëtinë sytë.

— I sjell vëllait ti një nga ato napat me gjalmë të zi? Po ia rregulloj vetë samarin unë atij Mu... Mirë thoshte xha Brahoja.

— A, Çome! Një xha Braho përcolla, një xha Braho gjeta... Duhet leja e Stopanit pér këto punë. E di ti...

Se ç'kërkove në të vërtetë dhe se kush ishte ky Stopani, unë dhe sot e kësaj dite vetëm me mend mund ta marr. Por s'më mundoi shumë kurreshtja pér këtë. Më vinte keq pér Mullanë. Nuk kisha asnjë dyshim, ashtu si të gjithë, se Mullai s'kishte pér të nxjerrë fjalë nga goja, sikur mishin më gërshtë-rrë t'ia prisnin, por më vinte keq që e kishin kapur të plagosur. E njihja natyrën e tij dhe e merrja me mend se sa do të tronditej, kur të vinte në vete dhe të shihte se kishte rënë në grackë, si zogu krahëthyer. E mbanin lidhur këmbë e duar.

Zoti Myrto e urrente Mullanë, njësoj si xha Brahon, ndoshta edhe më shumë, se Mullai e kishte gjuhën brisk. E tallte hollë. E kishte vënë në lojë edhe në sy tonë. «Me siguri do të na e vrasin Mullanë!» — më the ti i shqetësuar, pas katër ditësh. «Dhe, po veproi zoti Myrto më Mullanë, ashtu siç tha, ja ku ta jap fjalën se s'kam pér të pyetur as Mësues, as Stopan. Që të nesërmen do t'ia marr shpirtin. Nuk e shoh dot me sy. Pothuajse çdo ditë vete atje te kasierja e bukur. Dhe çdo natë me nga një bushtër të re e shikoj... E shoh kur shpie akull e gazoza...»

*Dhe na e vranë Mullanë. E varën një natë fshe-hurazi, mu në mes të sheshit, që ta shihnin të gjithë; të nesërmen gdhihej ditë pazari. Po asnje s'shihte Mullanë. Të gjithë shihnin vëngër rojet me pushkë ngrehur rrëth e rrrotull trekëmbëshet. Shkuam dhe ne; deshem t'i jepnim lamtumirën e fundit atij trimi. Pastaj vajtëm e ngushulluam nënën e tij plakë. Vetë, me kokën tonë shkuam. Dhe i lamë kursimet e pesëmbëdhjetë ditëve. Mbahej plaka, qe mësuar me fatkeqësi. Para Mullait kishte varrosur edhe një djalë tjetër... i kishte vdekur nga një plevit. S'kish-te pasur mundësi ta shëronte. Dhe jetonte në qytet plaka! Ti the t'i dorëzonim edhe çetelen e veresies, që i kishte mbetur në xhepin e përparsës së Pipit. Po unë s'desa, e mbajtëm për kujtim. E kam ende. Nuk e di si të bëj, më dhimset t'ia dorëzoj muzeumit të qytetit. Plaka ka kohë që ka vdekur dhe shtëpia e tyre përdhese nuk është më. As që mund ta njohësh atë lagje. Kur vajta para ca kohësh, nuk orientohesh dot, është mbushur vendi me pallate. Përrpara tyre një shesh me lojëra fëmijësh dhe një lulishte e bukur. Ja, aty t'i ngrinin një monument Mullait.*

Edhe ndanë pazarit, gjithë vendi që kishte zënë trikëmbëshi është mbuluar me mermer të kuq dhe mbi të është ngritur një lapidar. Në faqen e tij, nën yllin e kuq, është skalitur emri, mbiemri dhe datë-lindja e Mullait. Sa mirë që nuk kanë shënuar datën e vdekjes. Mund të jetë rastësi, ndoshta dhe harresë, por...

Kështu është më mirë, apo jo?

Të nesërmen ti erdhe në mbrëmje vonë. Sapo mbetëm një çast vetëm, më pyete:

- Sollën pasdreke djathë?
- Napa me gjalmë të zi?
- E pra!
- Plot...
- Mos u tall! Dëgjon? Mos u tall!

Tani, kur e kujtoj këtë bisedë, them me vete: «Me siguri ti ishe që atëhere anëtar i njësitet guerril dhe prisje urdhër për të qëruar ndonjë qelbësirë. E pse them «ndonjë»? Unë e di mirë kë kishe ti halë në sy. Ti ishe betuar se, po të na vrissnin Mullanë, do t'ia merrje shpirtin atij zotit Myrteza. Mullanë na e vranë. Ti doje të merrje hak. Dhe kjo ishte hakmarrja më e drejtë që mund të ketë pjellë ndonjë herë në zemrën e njeriut zemërimi dhe urrejtja klasore. Unë të kuptoja fare mirë. Dhe atëhere të kuptoja po kaq mirë. Unë vetë i isha lultur Colit: Aman, bre Coli, ku të gjejmë një bombë, pa ia vërvit unë atij qeni, që nga çatia e dyqanit mu para maqinës, sa ta ngadalësojë për të qëndruar te «Bari» i Kasieres. — Coli më pa dhe qeshi. «Do ta gjejë ai që do t'i duhet, do ta gjejë! E di atë historinë e atij që vajti për të ngarkuar drutë, ti?» Unë e dija atë histori. Ai, dikushi qe mësuar të vente për dru së bashku me vëllanë e madh. Njëri ngarkonte, tjetri i mbante anën. Një ditë vëllai i tha:

- «Shko vetëm».
- «Po kush të ma mbajë anën?»
- «Thirri nevojës.»

Dhe ai shkoi vetëm. Ngarkoi njerën anë. Mirëpo,

sa u kthye për të ngarkuar anën tjetër, drutë i têr-hoqën samarin... I thirri nevojës. Ajo nuk i përgje-gjej. Një herë, dy, të tretën tha:

«Pa t'i vë një stengë kësaj ane...»

Kjo ishte historia. «Po pse ma kujtoi këtë histori Coli? Unë atë e kam mësuar që kur fillova të haja përshest me dorën time... Mos do të thotë që fa gjej vetë një bombë? Po ku ta gjej? Neve, për dreq, s'na vijnë më as ushtarë italianë në dyqan... Ej, bela!» — mendoja me vete.

Ta qava hallin ty.

— Po sikur ta gjejmë vetë një bombë? Dhe leje s'kemi pse të marrim. E kush do të na qortojë, po të qërojmë një spiun kaq të vjetër dhe kaq të ndyrë të fashizmit, që ka harruar prej kohësh se është shqiptar? Jo, s'do të na qortojë njeri. Përkundrazi do të na lavdërojnë. Për ne do të shkruajnë në komunikatë...

Po ti u preve në fytyrë. M'i ngule sytë. S'po flisje asnjë fjalë. Dhe unë prisja që ti të férkoje duart nga gëzimi, si atë natë që të tha Pipi se do të ndanin komunikata... Pa, për të përqafuar, e dija se s'do të më hidheshe në qafë. Ti ishe bërë më i përbajtur. E, pse ta fsheh, pas vrasjes së Mullait dhe largimit të Pipit më dukeshë ca i ashpër. As xha Brahoja, burrë me një barrë halle mbi supe, nuk i mblidhë vetullat ashtu i vrenjtur, si ti... Unë, në fund të fundit, edhe për të të lehtësuar ty e vrava mendjen. Se e dija që ti s'do të qetësohesë gjersa t'i merrje hakun Mullait. Se e dija (ti ma kishe thënë vetë) që sytë e atij zotit Myrto të dukeshin si sy gjarpëri, që kishe neveri për të, që doje t'ia shtypje kokën... Kur çoje akull e gazoza, pasi e shihje atë

me ndonjë bushtër gju më gju duke pirë cigare rëndë-rëndë, duke skërmitur dhëmbët e duke ngri-tur gotën me vështrimin e ngjitur te buzët e saj të lyera, doje dy orë ta merrje veten... Më kishe thë-në, apo jo?

Edhe tani më tingëllojnë në vesh fjalët që më the atë ditë:

— Mos u bëj fëmijë! Ç'u bë lufta jonë, luftë kakësh? Ne kemi disiplinë. Ne jemi ushtarë të pullit dhe do të punojmë ashtu si duhet. Çdo gjë me radhë! Të gjithëve do t'ua hamë kokën. Lufta është e gjatë...

Dhe unë e kuptova: me siguri të kishin folur rëndë. Jo vetëm s'të kishin dhënë leje, por edhe të kishin qortuar. Fjalët e kujt po më përsërisje? Nejse, ç'rëndësi ka. Ti ato po i bëje të tuat. Nuk i kishe përtypur mirë (s'ishte vështirë të vihej re se dëshira për ta vrarë zotin Myrto të ishte shtuar), por po i bëje të tuat...

— Prandaj, kryej atë detyrë që të kanë ngarkuar dhe léri fjalët! Fjalët e shumta... — dhe t'u duk se e zgjate shumë. Heshte. Apo heshte se e pe që më fole rëndë? Në fund të fundit ti kishe të drejtë. Edhe unë duhej të bindesha, siç ishe bindur ti, se lufta jonë nuk ishte lojë kalamajsh. Ishte luftë për jetë a për vdekje. «O ne, o ata!», si thoshte xha Brahoja. Dhe unë vendosa të të qetësoja ca. Buzë-qesha.

— Mirë, mo, mirë, dakord. Po pse s'më ke thënë çfarë të fali xha Brahoja, kur u ndatë?

Mua më kishte thënë Coli dhe e dija, po doja të të ngacmoja pak «për të zbutur gjakrat».

Xha Brahoja të kishte marrë edhe ty mënjanë,

siç më mori mua. Të kishte folur për luftën, pastaj të kishte përqafuar. Të kishte puthur si baba i dhemshur dhe të kishte futur një kaush me sheqerka në njërin xhep. Pastaj të kishte thënë: «Mbyll sytë e shtri dorën!» — dhe me një ashpërsi të shtrirë, duke të thënë shpesh «mos i hap!», të kishte lëshuar mbi pëllëmbë, njërin pas tjetrit, sikur t'i numronte, gjashë fishekë naganti. Ti kishe shtangur.

— Po t'i fal për revolverin e gjyshit që të mos i mbetet mulliri me dy fishekë...

Dhe unë të ngacmova përsëri.

— E ke revolverin ti, je kaluar, prandaj më flet kështu... Ç'të bëj unë i varfëri!

— Ti, ti... Ti të vesh e të na e marrësh atë revolver, atë të bësh ti, Se mua s'më lënë...

Dhe unë isha gati të veja të bisedoja me ustanë që në atë çast, se më kishte marrë malli për nënën dhe do t'i gjeja mënyrat për ta sjellë revolverin, po të ma jepte gjyshi yt, por...

## X

### AMA, TANI QE PIVA UJE NE «GURREZEN E LIRISE», ORE!..

Atë mbërmje, siç duket, ne ramë pas fjalëve dhe u vonuam në depo, ku ndiznim zjarrin për të zier qumshtin. Ustai kishte thirrur dy-tri herë. Nuk e kishim dëgjuar. Kishte mbyllur qepenat vetë, kishte sistemuar si çdo mbrëmje arkën... Dhe përsëri kishte thirrur. Ne prapë s'kishim dëgjuar. Atëherë kishte ardhur për të na kërkuar vetë. Meqë unë e vura re i pari, m'u drejtua mua:

— Ejani, pak, ejani, se ju kam një punë.

Mori një karrige dhe u ul në një tryezë ku binte më shumë drita e llambës së vendosur te murri. Ne në fillim menduam se do të na lexonte ndonjë komunikatë, se edhe atë e mbanin afër dhe ia jepnin të gjitha për t'i lexuar... Por jo, Ai nxori nga xhepi një zarf me anë të zeza dhe tha:

— Do të më falni, se e hapa pa ju pyetur, por ju e kuptioni dhe vetë... Kur pashë zarfin... s'kisha si të veproja ndryshe...

Mua m'u drodh zemra. E pashë se dhe ti ule vetullat dhe shtrëngove buzët. E ngule vështrimin te këpucët e mëdha ushtarake që të kishin mbetur pa lyer.

Ustai më tha:

— Letra të drejtohet ty, por është për Çomen. Po jua lexoj më mirë.

«I dashuri biri im, Çome. Jemi mirë. Atë dë-shirojmë edhe për ty: të jesh mirë. Paratë që më dërgove me postë i mora, të lumtë dora! Por, të them të drejtën, more bir, paratë s'më hyjnë në sy fare, kur s'mora dy gisht letër prej teje. Më shkruaj dy fjalë, të keqen nëna, se m'u përvëlua shpirti për të dëgjuar zërin tënd dhe, kur marr letër, më duket sikur fjalosem. Le për mua, po nuk të vjen keq për gjyshin e për gjyshen që u përgjëruan, të varfërit, për ty? Apo gjyshja që ka qenë sëmurë. «Mos më daltë shpirti, thotë e mjera, pa i marrë erë edhe një herë djersës së tij, kur arrita dhe unë të ha nga djersa e tij...» Prandaj, meqë s'pate mundësi të na vije një natë e të na ngopje sytë, na dërgo dy gisht letër... Kështu, hë, të keqen nëna! Dhe ruaju nga të ftotët, pa për ne mos ki merak. Gjyshja ka qenë vërtet shumë sëmurë, po tani është më mirë. Edhe gjyshi mirë është. «S'vdes unë, thotë, pa i parë djalit edhe një herë sytë...»

Unë rrija si i hutuar. Nuk po merrja vesh, pse ishte prekur ustai aq shumë dhe pse ishte futur kjo letër, që s'kishte asgjë të jashtëzakonshme, në atë zarf me anë të zeza? Por s'm'u desh të mendohesha gjatë. Ustai e ktheu letrën në anën tjetër, ku një dorë tjetër kishte shkruar:

«Çome, bir! Këto fjalë po t'i shkruaj unë, Gore

Qeraxhiu. Letrén jot émë ma dha ta postoja që njéditezaj. Po unë nuk zbrita dot të shtunën e parë dhe po zbres sot. Prandaj, bir, letrén e ke të vonuar. Prandaj, Çome, bëhu burrë, mbaje veten, se e ndjera gjyshja jote të ka lënë uratën dhe ka vdekur me ty në gojë. Prandaj, Çome, bir, bëhu burrë. Po munde, shkëputu e hajde ndonjë natë, se e do puna dhe për atë të varférin gjysh...»

Ty nuk të ndryshoi shprehja e fytyrës, po një çurkë lotësh të zbriti faqeve si rrëke e rrëmbyer, u grumbullua te gropëza në mjekër dhe filloj të rridh-te pikë-pikë mbi këmishën e madhe ushtarake pa jakë...

Kaq pashë, se u shkriva në vaj dhe shkova në të ndarën tjetër t'u hidhja ujë syve. Kur erdha, ti po pije cigaren, në heshtje, së bashku me ustanë.



Në fshat nuk u nise dot as të nesërmen, as pas një javë. S'kishe si të niseshe. Kursimet ia kishe dhë-në nënës së Mullait dhe rrogën do ta merrje pas dhjetë ditësh. Ustai im të lejoi të mos i paguaje detyrimet për atë pesëmbëdhjetëditësh, madje ai të huajti edhe pesë franga që t'ia ktheje kur të të bëhej mbarë. Ç'është e drejta, ai kishte detyrimet ndaj teje, ashtu siç kishte dhe ndaj meje para se të largohej Pipi. Se ti vazhdoje të më ndihmoje. Bile punoje edhe më shumë. Unë vija më i dobët se Pipi. Atëhere ti me-

rreshe vetëm me zierjen e qumështit, po mua më ndihmoje edhe për punë të tjera. Ti nuk e bëje veten, përkundrazi, tregoheshe se ia dije për nder që të linte të shtrije koskat në karrige e që të besonte aq shumë...

Nuk e di as tani se kur u nise dhe me se udhëtovë se, edhe kur u ktheve, nuk më the gjë. Ishe i mbushur me përshtypje nga fshati, nga udhëtimi i kthimit. Dhe unë të kisha zili. E si të ndodhët ndryshe? Ti kishe parë atë javë partizanët, kishe parë edhe armiq të mundur. Ti kishe parë fshatarë të armatosur që ngriheshin me të dëgjuar tri pushkë e një bombë e zinin grykat sa të hapje e të mbyllje sytë. Kishe parë Gore Qeraxhinë me dogranë e vjetër pas krahëve që u çonte partizanëve bukë e fishekë në front. (Kështu quanin ato ditë kodrat e qytetit tonë të vogël që i kishin rrethuar partizanët e tri çetave dhe batalionet territoriale të dy krahinave). Ti kishe parë pas betejës fshatarët që punonin të gjithë së bashku për të sjellë ujët e ftohtë të Burimit të Drejtëve në fshat dhe asaj çesme me tre sylynjarë ia kishin vënë emrin «Gurrëza e lirisë»... Kishe qëlluar me pushkë, me revolver, kishe hedhur lirisht bomba që nga Shkrepri i Bardhë përposh në përrua. Pastaj i ishe lutar komisarit të një çete të mbante dhe ai të kishte pranuar, por, për fat të keq, në atë çetë paskësh qenë një djalosh që të njihet se ishe aktivizuar brenda në qytet dhe komisari të nisi përsëri... Të kishte nisur së bashku me atë... Ti u shkulle së qeshuri, kur më tregove pas disa ditësh për atë që të kishte ndodhur me djaloshin:

— *Sikurse kisha lidhur fjalë me atë partizanin e ri, për t'i shpëtuar kontrollit të postblokut dhe për*

të mos e bërë kot më këmbë gjithë atë xhade, do të dilja buzë rrugës, aty ku zbriste monopati. Ai do të blente biletat, do të më ruante vendin dhe do të ndalonte maqinën. Unë po prisja së bashku me Savën, ulur mbi një gur, me një trastë e dy shporta me fiq te këmbët. Me të parë shtëllungën e tymit që dridhej tej në xhade, u ngrita dhe bëra shenjë me dorë, por autobusi vazhdoi të ecte. U ndal larg. Sava deshi të më përcillte gjer atje, por unë hodha shpejt e shpejt trastën në sup, rrëmbeva shportat dhe iu qepa maqinës që priste me motor të ndezur. Me t'u hapur dera, sa vura këmbën në shkallën e parë më doli përpara një polic kuesture dhe deshi të më ndihmonte që të ngjitja shportat. Sa e pashë, u preva në fytyrë. Ai çoi dorën pikërisht te shporta me fiq, në fund të së cilës kisha fshehur revolverin e gjyshit... U ruajta nga shiu, po rashë në breshër; nuk e mbajta me vete nga frika e ndonjë kontrolli, ja tani, polici, sikur ta dinte, sikur të ishte lajmëruar, zgjati dorën drejt e tek ajo shportë... «Tradheti? Rastësi? Grabitje? Pa dale ta provoj një herë».

— Urdhëro, urdhëro, merr këtë! — dhe i zgjata shportën tjetër.

— Futu, futu, një herë, pa do t'i hamë të gjitha, ku na del një shportë neve... Shih sa jemi. — Ata që ishin në rreshtat e parë qeshën. Unë e humba më keq, se m'u afrua shoferi e më tha: «Biletën»... Kërkova me sy, vetëtimthi djaloshin, por s'po e gjeja.

As që e vura re se kush i kishte zgjatur shoferit biletën. Polici? Jo?! U qetësova pak, kur shoferi ma ktheu biletën e grisur, më ra lehtë në sup dhe më tha: «Atje, te radha e katërt. Ja, atje, ku janë

ato dy vendet bosh...» Pashë edhe një herë me kujdes pasagjerët, desha t'i merrja policit shportën e t'i thosha «falem nderit», por ai as që kishte ndër mend ta lëshonte. Më hipi gjaku në kokë. Sa nuk bërtita: «Kjo është grabitje në mes të ditës, bjere shportën këtu! Jeni mësuar ju, por tek unë nuk ju shkon...» Dhe, të mos kishte qenë ajo shportë, ndofta do ta kisha bërë, ndofta do të kisha nxjerrë edhe revolverin e ta kisha çarmatosur. Me siguri të gjithë do të më dilnin krah. Por e përbajta veten dhe vajta e u ula te vendi që më tregoi shoferi. Mendoja me vete: «Hallall shporta me fiq, kush po e qan, po kam hallin e revolverit. Atë kujtim kisha nga gjyshi. Pastaj, pse ta fsheh, edhe frikë kisha... Çudi, si nuk ka ardhur ai partizani i ri. Të këshillohesha me të, të paktën. Për dreq, polici nuk m'u nda. Më ndoqi këmba-këmbës, me shportë në dorë, po edhe unë s'e hiqja dorën nga shporta. Do ti, sikur të mos mjaftonin të gjitha, erdhi e m'u ul pranë. Apo nuk u kapar-dis! Ai hap këmbët e mbështetu te gjuri im, unë tërhiqu. Se si më vinte kur më prekte ajo rrobë... Kështu, kur më nguci në qoshe, s'ù përbajta:

— Mirë shportën që ma more, more zoti polic, po pse më nguc kështu?! — i thashë.

— Jo, more vëlla, nuk të nguc njeri. Ti vetë po prapsesh. Edhe i zgjebosur të kisha qenë, s'do të ma bëje kështu...

M'u duk si zë i njohur... S'fola. Pashë edhe një herë në të dyja rradhët e ndenjëseve mos takoja vështrimin e atij djaloshit. Më kot. Gjithmonë më rëndonte mbi krye vështrimi ngulmues i policit.

Ndërkaq dielli qe ngjitur mjaft lart. Jashtë filloi vapa. Brenda kishte një zagushi të tmerrshme. Dikush

provoi të hapte dritaret, por nja dy të tjerë bërtitën se u mbush autobusi me pluhur. Polici hoqi kapelen dhe zërtheu xhaketën... Mua s'më hiqej mendja nga shporta: «Do t'i jap fiqtë, thashë, t'i hajë dhe t'i marr shportën.» E kisha mbuluar aq mirë revolverin me gjethje fiku, saqë, edhe sikur një kokërr të mos mbetej, si zor ishte të dukej...

— O zoti polic! Po merr, ore, merr një fik, se janë të freskët...

— E di. Keni fiq të mirë ju. Kam qenë në fshatin tuaj. Ja, aty, para... Më priten mirë!

Prapë zë i njojur. Ky s'kishte si të ishte polic. Në fshatin tonë kishte gjashtë muaj, ndoshta edhe më shumë... që s'kishte shkelur këmbë armiku...

— Urdhëro, atëhere, ha! — dhe i zgjata shportën tjetër.

Ai qeshi paksa nën buzë.

Ja, kështu ishte puna me policin... E more vesh tani kush ishte polici. Ai kishte qenë vërtet polic. Atë ditë që qëruan kuestorin, ai paskesh qenë te rruga. Mbante mend edhe si kisha «spiunuar» unë. Dhe ai kishte vajtur e i kishte raportuar mareshallit, se një djale me revolver në dorë kishte shkuar nga rruga tjetër. Ai i kishte dhënë edhe atë letrën postierit për Mësuesin dhe Mullanë. Do ta njoħeš dhe ti, do ta njoħeš. Ç'djalë që eshtë!

Më qau hallin, kur zbritëm nga autobusi. Ishte bërë derr. Nuk donte të rrinte më në polici. «Më duket sikur jam i zgħebosur», thoshte. Kishte shkuar me leje në fshatin e vet. Edhe ata të shtepisë e kishin bërë maskara. Dhe ishte hedhur në çetë. «Por, sa u għeu, kur i zhvesha këto të shkreta e ngħesha għerdanin, aq u hidhheruan kur më panë përséri polic.

Plaku u ndez në fytyrë si prush dhe më bërtiti: «Mo-re, do të ta marr shpirtin me këto duar, more gjidi jezit! Tani të vesh e të zhvishesh! Po s'të pranuan në Parti, mbytu në lumë, po me këtë rrobë mos më dil më para syve!» Si t'i thosha. Ika fshehurazi. S'di si të veproj. Nga vajta e u 'pleksa me këtë dreq rrobë! Më mori më qafë një shoku im. Ishim të dy ushtarë dhe deshëm të dezertonim. Kur, një ditë, se si iu mbush mendja e më tha: «A s'bëjmë një lutje pér t'u veshur policë? Dhe rrogë marrim, edhe nga ushtria shpëtojmë.» U kandisa. Të kisha shkuar që atëhere në fshat, tani do të isha, si umë, në çetë...»

E shikon ç'bën disiplina?

\* \* \*

Me Sabirin jemi bërë tani shokë të ngushtë. Vemë e vijmë te njëri-tjetri. Kemi fëmijët në një klasë. Edhe ata duhen shumë. Përpara ca ditësh u takuam dhe shkuam së bashku te Pipi. I bëmë një vizitë. Pipi nuk e njohu atë, ndërsa ai e njihet mirë Pipin. Bile më tha se e kishte shpëtar nga arrestimi. Se si më duket, si çudi, kur mendoj tani pér ato gjëra. Do të arrestonin Pipin! Pipin e lajmëruan dhe ai doli në ilegalitet. Thua s'të vjen çudi? Mua më del i gjallë para syve, ashtu i mbështjellë i téri me atë futën e tij të gjatë! Më del para syve me atë gjoksin e fryrë, me këmbëzat e pantallonave plot me komunikata, si atëhere, në orën tre të natës... Të kujtohet? Sabiri më tha se kuestura e kishte në listën e komunistëve më të rrezikshëm.

Hë, të ka faj Pipi!?

Na priti mirë. Sabiri e kritikoi: nuk kishte vajtur në stërvitje ushtarake. Si? Nuk po më kuhton? Ne tani vazhdimisht stërvitemi. Sabiri na jep mësim në vijën e shënjimit. Si stërvitemi? Ja, ore, vete se cili në repart, ose në qendrën e punës, merr pushkën, vishet ushtar, në rresht për dy dhe në poligon! Po, po, stërvitemi. Nuk kemi nevojë t'ua fshehim shokëve, ashtu siç bëre ti, kur ike me xha Brahon në pyjet e fshatit dhe u ktheve me fytyrë të pjekur në diell, sikur ishe thekur në plazh. Të kishte zënë keq ai diell i majit, se kiske qëndruar brenda në pus për ditë e javë me radhë.

Të kujtohet puna e plazhit, apo jo? Unë, duke vështruar fytyrën tënde të nxirë, të ngacmova: «Hajde, ore Çome, hajde, ç'më bredh plazheve si bir arhondi...»

Ti vure buzën në gaz e me të njëjtin ton m'u përgjegje: «Është për kë është plazhi, vëlla... pa neve të mjerëve na mbetet mendja te kokrra e misrit, si pulës në shkurt...»

Dhe hodhëm sytë nga plazhi. Madamat, të veshura me rroba banje, thekeshin në diell. Te veranda ishin shtruar e po hanin ca zotërinj e ca zonja të tjera me shishet e birrës përpara. Duke vështruar andej, ti u vrenje: mblodhe buzët, tunde një herë kokën dhe the: «Ka hak Mësuesi, Keq është ndërtuar kjo botë. Ca hazdisen, s'dinë ç't'i bëjnë paratë, të tjerëve...»

Pse vë buzën në gaz? C'kujton ti, i harroj fjalët e tua unë? Nuk e ke aty hallin? Aha, do të dish se kush më tha që ike atëhere te xha Brahoja për të mësuar si të qëlloje me revolver?

Sabiri më tha, Sabiri, atë ditë që shkuam së bashku te Pipi. Si? Të paskemi kujtar?! Ne gjithë atë pasdreke me ty në gojë mbetëm.

Sabiri: *Aha, për të qëlluar as ti as Pipi s'ia shkrepnit. Ju tani dhe... Një kishit ju atëhere që të përlante, Çomen! Ai ta ndizte cigaren në gojë dyzet hapa larg. Më thoshte xha Brahoja se, një herë, kur pat qenë me të në fshat, edhe lebërit me gojë hapur i kishte lënë. Kokrrën e vezës mbi gur të bardhë kishte qëlluar. Në pisk të vapës... xha Brahoja kish-te mbetur pa mend. «Dre, po dhe unë që e kam zënë luftën që në kohën e Italisë së parë, s'qelлоj dot ashtu», thoshte...*

Pipi: E, mor e, po s'kishte xhamë para syve Çomja atëhere...

- Sabiri: *Nuk është puna te xhamet, jo. Mirë ti, hajde, po të lëmë ty... Po ky!? I ke thënë Pipit si jemi rinojohur bashkë, apo jo?*

Unë: Kështu si ke ndryshuar ti, jo unë, po edhe Çomja vetë do të të ngatërronte prapë si atëhere në autobus...

Dhe, ndërsa Sabiri i tregonte Pipit atë ngjarje gazmore mua m'u kujtua ajo ditë, kur u takova me Sabirin pas njëzet e ca vjetësh...

Në vijën e shenjimit na priti një oficer shtatlarëtë dhe thatim. Ishte krejt i thinjur, mjaft serioz, thuajse i ashpër. Veç, në buzëqeshje, si kundër dëshirës së tij, i mbetej diçka rimore. Por dukej sikur pikërisht kjo e nxehë dhe buzëqeshja zhdukej shpejt, shumë shpejt nga buzët e tij të holla...

Unë mora fishekët dhe vajta u shtriva të pozicioni që kishin preqatitur disa të rinj e të reja me

dega fieri dhe me plisa. Ai më pa me inat dhe më bërtiti:

— Prapa kthehu!

Unë po e shikoja i habitur. Si një vegim vetë-time në qiellin bunacë u duk në fytyrën e tij ajo buzëqeshja eëmbël, pastaj u vrenjt si qielli për shi dhe bubulliu:

— Kush përplasët ashtu në pozicion si notari i keq kur hidhet me bark mbi ujë?! Ashtu merrët pozicioni?!

Dhe nuk e bëri të gjatë, por ma rrëmbeu pushkën:

— Shiko!

Sa lehtë u shtri ai. Shtrëngoi qytën në sup. Këmbët i la të hapura në një mënyrë të tillë që unë, edhe pse e përsërita tri herë, nuk isha në gjendje ta imitoja.

Unë po kulloja në djersë. Ca ishte vapë, ca më vinte zor kur shikoja nja dy vajza e djem të rinj që kafshonin buzën për të mos qeshur... Eh, bela! Nuk e kisha ndjerë kurrë veten më ngushtë. Unë s'dija as të shtrihesha sipas rregullave, e lëre më pastaj për të shtënë. «Eh, ç'do të turpërohem», thosha me vete.

E pikërisht në këtë kohë, kur unë po dëgjoja nga toka të rrahurat e zemrës sime, ndjeva rrëzë veshit frysëmarrjen e tij. Dëgjova një zë përkëdhelës që m'u duk se e kishte pasur dikur një i njojur e që tani e kishte marrë ky oficer «noprani»... «Mos' u emociononi! Qetë! Ashtu! Puqeni mirë qytën në sup! Shënoni objektin! Kini kujdes që ai të jetë në një vijë me thepin dhe shtjekëzën! Ashtu... Merrni frysëmë thellë! Mbajeni! Tërhiqeni tani gishtin ngadalë,

sa edhe vetë të mos e kuptioni kur të shkrehet pushka...»

Buzëqeshja vegoi përsëri vetëm pér një çast dhe u tret në fjalën:

— Zjarr!

.....

Pipi ngriti pak gjyzlykët me gishin tregues, mblodhi buzët, hapi sytë sikur desh të depërtonte me vështrimin e tij pak si të humbur përtej mjegullës së ngjarjeve më të reja dhe pyeti:

— Kur ndodhi kjo? Aha, në qershori të dyzete-treshit... Po, isha larguar unë, isha larguar...

Unë: Çomja atëhere punonte si ngarkues e shkaromatik... Shoferit, që s'punonte dot në kabinë të myllur, edhe me motor i merrej fryma, kur kishte zugushi. Prandaj e ndihmoi Çomen që të mësonte motorin. Dhe Çomja e mësoi... Shoferit mirë i bëhej. I shpërndante nganjëherë akullin...

Sabiri: Çomja kishte një aftësi të jashtëzakonshme pér të zënë miqësi me shoferët. Edhe unë çuditesha. Nuk ishte ai shoferi i kamionçinës, si e quanin atë? E pra, ai që punonte me të përpara se të vinte në fshat. Më kujtohet, sa herë i prishej ndonjë gjë, Çomen thërriste pér ta ndihmuar. Dhe Çomja, kurresh-kur e shihja me duart gjithë vaj e graso, me ndonjë kyç në dorë... Sa ia kishte ënda ato të shkreta he-kura!

Unë: Ai edhe kamionçinën kishte mësuar ta ngis-te, por shoferi i saj s'para e linte, se policët e gjur-monin shumë pér ta zënë në gabim.

Sabiri: (*Fytyra e tij u ndriçua nga ajo buzëqeshja rinore*) Donin të pinin nga një birrë, ose gazozë qyl. Kishte ca grepса... Ndërsa motorit s'para i binin më qafë.

Pipi: Dhe pse këmbyet fjalë, the?

Sabiri: Për mënyrën e kryerjes së aksionit. Ai ngulte këmbë që të futej në «Barin» e Kasieres së bukur, ku vente e kalonte pasditen zoti Myrto dhe ta qëllonte midis të gjithëve. Dhe, ç'është e drejta, ai e kishte atë mundësi. Se për të nuk dyshonte njeri. Se ai shpinte atje akull e piye freskuese dy-tri herë në ditë. «T'ia numroj qenit, tha, pastaj ia hipi triçiklit dhe... Le të më zënë! Sa të marrin veten ata, unë bëhem erë...» Dhe s'kishte burrë që t'i kthente mendjen...

Pipi: Nuk e kuptoj, ç'të keqe kishte në këtë mes?

Sabiri: Si, ç'të keqe?! Zotin Myrto, kur rrinte në bar, e ruanin jashtë dy policë dhe një civil. Bufetieri ishte agjent i tij. Zoti Myrto mund të shpëtonte dhe ai do të rrezikohej kot. Do ta kapnin patjetër. Nga do të dilte? Nuk ishte punë ajo, të bazoheshe në panikun e tyre! Duhej gjetur një mënyrë tjetër... E mira ishte të qëllohej me bomba në kohën kur zbriste nga vetura.

Në atë kohë rojet e përqëndronin vëmendjen tek ai. E shikonin kur zbriste, kur i hapte derën dhe i përkulej, për t'i vënë krahun bushtrës së vet... Do të shkonte dhe ajo? Aq më mirë. Ato ishin që të gjitha agjente të SIM-it. Më mirë do të ishte sikur të gjendej ndonjë minë me sahat dhe të kurdisej për në orën shtatë e dhjetë, kur zoti Myrto kthehej... Atë kohë ai e ngiste maqinën vetë. S'donte që ta merrte vesh as shoferi se ku do ta conte dashnoren e vet... Por mina ju s'na dërguat...

Unë: *Ja, kjo e paska shtyrë të kërkonte mënyra të reja...*

Sabiri: *Po, po! Dhe gjeti një mënyrë fare të thjeshtë, që na habiti të gjithë.*

...Ja kështu, Çome vëllai, rijetova edhe një herë, tanimë, duke i dëgjuar nga goja e Sabirit ato ngjarje të ethshme të asaj kohe nervanderë...

Unë nuk isha në një mendje me Sabirin. Unë isha atëhere në një mendje me ty. Po, ashtu doja edhe unë! Që ti të futeshe drejt e në sallën e «Barit». T'i dilje përballë. Ta dënoje në emër të popullit me grykën e revolverit drejt tij... Kështu! Sa herë e kisha përfytyruar atë skenë gjatë atyre ditëve! E përfytyroja se si zotit Myrto do t'i binte hija e vdekjes pa e zbruzur mirë ti revolverin, do t'i shkonte buza mënjanë e do t'i dilte hunda si çomange mbi faqet e vdekura. Pastaj, një dy, tri krisma e ai do të rrëzohej nga karrigia, do të përpëlistë këmbët në pellgun e pijeve, gjakut dhe vrerit të tij. Nuk e di pse, por mua më dukej se zoti Myrto, përpara se të nderte çizmet me faqe të forta në pllakat e «Barit», do të villte vrer, se këmisha e tij e zezë dhe rrobat e tij të zeza do të mbuloheshin me një lëng jeshil, si ai që lëshon vemja, kur e shtyp me këmbë...

Ti thashë dhe ty një ditë:

«Po, kështu duhet të ndodhë», më the. «Le të tmerrohen larot rreth e rrrotull! Le t'i lagin karriget nën vete bushtrat e huaja!»

Sabiri: Veç të shikonit, Pipi! Ato ditë ishte i pa-përbajtshëm në aksione. Ishte gati t'i bënte ai të gjitha. Por, mos kujtoni se e humbi ndonjëherë gjakftohtësinë. Jo. Më kujtohet, dikush propozoi të hidhnin në erë një depo dinamiti që e ruanin fa-

shistët te kazermat e ushtarëve italianë, atje rrëzë ullishtave. Mësuesi ia ngarkoi këtë detyrë Colit dhe grupit të tij, më duket. Nuk më kujtohet mirë...  
Çomja ngriti gishtin si nxënësit në shkollë:

«Me leje, shoku Mësues».

«Urdhëro, Çome!»

«Pse ta hedhim në erë dinamitin?»

Mësuesi heshti i habitur: «Çomja që është gati t'u vërë flakën një për një të gjitha depove e kazermave, po ta lejonin, po bën këtë pyetje të çuditshme!» Dhe nuk i tha gjë. E vështroi gjatë, gjersa Çomja e sqarroi mendimin e vet:

«Unë them, shoku Mësues, t'i ndërrojmë vendin dinamitit. Pse ta djegim?! Të shpërthejmë vetëm një pjesë, sa për të humbur gjurmët...»

Mësuesi ra në mendime. Çomja vazhdoi.

«E marr përsipër vetë që me triçiklin tim ta çoj dinamitin në çetë që atë ditë...»

Mësuesi buzëqeshi:

«Aha, shih sa bukur! Dashke të vrasësh dy zogj me një gur, Çome... Mendimi yt është i drejtë... Vërtet, pse ta prishim dinamitin në një kohë kur ne duam t'ua ndezim flakë nën këmbë të gjithë tokën tonë të huajve? Do parë mundësia e... sa bukur e the, pa: «T'i ndërrojmë vendin dinamitit...» Mirë, dakord. Studjojeni së bashku me Sabirin edhe këtë mundësi...»

Unë: S'përmbahej vërtet ato ditë që ishte kthyer nga fshati. Më duket sikur i kam përpala ata sytë e tij të ndezur atë natë që mori lejen për atentatin...

Mësuesit, si e falënderoi, i tha vetëm këto fjalë:

«Mos ki merak, shoku mësues. I vdiq nëna asaj pune. Pregatit komunikatën!»

Sabiri: *Që kur ishte kthyer nga fshati, e përdorte shpesh fjalën «shok».*

Unë: *Ashtu, ashtu. Më parë nuk ia kisha dëgjuar ndonjëherë...*

Sabiri: *Po e dini ç'më tha një ditë që e këshillova të ishte më i kujdesshëm? «Ama, tani që piva ujë në Gurrëzën e lirisë, ore, tani s'pyes nga vdekja!*

Dhe përsëri mendja më fluturoi tek ajo kohë e ashpër.

...Unë, si ato gratë shtëpiake qëmoti, sillesha gjithë ditën nga banaku te tryezat, nga tryezat në depo, nga pjatat te gotat, nga tenxheret te kazanët. Kjo ishte bota ime. Shpezat ustai i bënte vetë. Le që shumicën e gjérave ia sillnin aty. Kasapi i dërgonte me një djalosh të vogël, që mbante përparse si ajo e Pipit, mishin; një bahçevan i dërgonte me djalin e tij zarzavatet; një bakall, që ishte aty pranë, i dërgonte me shegertin e tij oriz, fasule e kripë; një pijeshitës i dërgonte verë e kështu me radhë. Ata djem të vegjël që i sillnin këto ishin të vetmet fije që më lidhnin me botën tjetër përtej qepenave dhe prakut të dyqanit tonë... Por ata s'qëndronin shumë dhe ik-nin duke shqiptuar të gjithë një frazë, që e pasonte një buzëqeshje e hidhur: «Ika. Se na i shkul veshët ustai!...»

Kështu kalonte mëngjezi. Pastaj vinte dreka, që fillonte nga ora dymbëdhjetë e s'dihej kur mbaronte. Se unë shumë rrallë isha në gjendje të viaj kufi midis drekës dhe darkës. Unë shkoja e viaj varavingo më këmbë... Mërzitesha sidomos kur rralloheshin myshterinjtë. Ndjeja shumë nevojën tënde. Fillonte ankthi i pritjes... Ato ditë ky ankth më ishte shtuar.

Unë e dija se ti do të kryeje atë aksion të rëndë-

sishëm dhe, sipas lodhjes e humorit që kisha, mezi të prisja të vije i gjëzuar e me lajme të mira; më duke-shin orët muaj e ndonjëherë më shkonte mendja edhe për të keq...

Një javë të tërë prisja të të shikoja me fytyrën prush e sytë të ndezur, prisja të më thoshe: «Mbaroi ajo punë! E qëruam dhe një qelbësirë». E dija, isha i sigurtë se kështu do të më thoshe. Dhe unë do të ta shtrëngojë dorën fort!..

Po ç'lajme prisja unë e ç'më sillje ti!

Më kujtohet, një mbrëmje erdhe vetëm nga pesë minuta përpëra orës së shtetrrethimit. Atë ditë kisha dëgjuar krisma e shpërthime në qytet. Ta kisha frikën. Nja dy a tri herë u ngatërrova me klientët. Diskush më porositi ujë dhe unë i shpura verë. Ai më buzëqeshi, e piu dhe më tha: «Falem nderit. Më qerase, apo jo?! Se unë të kërkova ujë!..» Por në fund ma pagoi. Një tjetër më porositi mish me bathë, unë i shpura djathë të njomë. «Or, çun, ku e ke mendjen? E paske humbur sot».... Mua menjëherë më vajti mendja se ai do të ishte ndonjë shok, se ai diç dinte për ty dhe po priste rastin të ma thoshte... Eh, çfarë ankthi! Ti s'besoj ta kesh provuar ndonjëherë, se ishe edhe më mendjembledhur ti... .

Dhe atë mbrëmje ti u fute papritmas, shend e verë... me një boçe të mbështjellë. Kur mbetëm vetëm, më tregove ca gjëzhoja të topave kundërajrorë. Dukeshin si pjesa e poshtme e mullirit të kafesë.

— Do t'i bëjmë zile! — the ti dhe i vendose në një kënd të depos, prapa thasëve të qymyrit, kur vure re se po të shikoja me kurrestjtje.

Unë kujtova se do t'i bëje vërtet zile, se u kishe shpuar edhe nga një vrimë të vogël në fund për

të futur gjuhëzën. Thashë se t'i kishin kërkuar barinjtë që na sillnin qumshtin... Dhe të besova...

Por, pasi mbyllëm qepenat, fshimë sallën, prapsëm tryezat e vendosëm karriget përballë njëra-tjetrës, për t'u shtrirë mbi to, ti më the se kishe shpikur një bombë me sahat për të hedhur në erë zotin Myrto, se e kishit provuar në një depo dhe kishte bërrë alamet pune. Kishte shpërthyer depoja pesë minuta pas largimit të shokut që e kishte vendosur. E kishe provuar edhe vetë në një maqinë ushtarake të ngarkuar me municione. Edhe asaj i kishte fluturuar motori në erë brenda pesë minutash, sa piu shoferi një gotë birrë...

Unë të ngacmova:

— Grive dynjanë me nagant dhe tani, që t'u mbaruan fishekët e xha Brahos, po shpik mina me sahat....

Ti heshte. Ishte errësirë. S'di ç'shprehu fytyra jote në ato çaste, por e ndjeva se të erdhi zor. Ti asgjë tjetër nuk urreje më shumë se sa shprehjen e mosbesimit ndaj teje.

— Mos u tall! Dëgjon? Mos u tall! Nuk më lejojnë me revolver...

Sabiri: Për fat, atë pasdite që do të kryhej atentati unë isha me shërbim. Dhe ku më kishin caktuar, mu përballë «Barit». Do të ruaja zotin Myrto. Ndodhin ca gjëra të çuditshme nganjëherë. Mbase kishte edhe donjë dorë më të fortë që i drejtonte, kushedi...

Unë veja e viaj trotuarit me një krenari të shtirë, duke u qëndruar me zor shpotive të një lustraxhiu dhe të një gazetashitësi, që i kishte vënë gazetat vandak mbi një karrige dhe, vetëm kur afrohesha unë, bërtiste: «Kombi! Kombi në rrezik!» Ndërsa lustraxhiu ia priste: «Shiko, shiko se ç'tym po lë-

*shojnë maqinat nga prapa. Na nxinë rrobat!» «More, léri rrobat që na i bënë sterrë, po na nxinë edhe faqen...»*

Të gjitha në adresën time. Një herë nuk u përmbyajta. Iu kërcënova çunit që shiste gazeta: «C'është ky komb, more? C'është ky rrezik që po dërdëllis?!» Por ai, me një mospërfillje që s'tregohet ma ktheu: «Unë s'dërdëllis, zotëri! Unë reklamoj titujt e gazetës! Unë s'di të lexoj, zotëri! Unë, si më ka mësuar ustai, ashtu thërres. Pse, mos e kam gjë gabim, zotëri? Unë, kështu, duke thirrur dhe s'po e shes dot... Shiko si më ka mbetur «Kombi» mbi karrige, si vandak...»

C'ti thosha?! Veç kësaj u dëgjua rënkimi i zgjatur i gomave të veturës së zotit Myrto që mori kthesën për të qëndruar përpëra «Barit». Zoti Myrto, si zakonisht, i hapi derën dashnores. (Nuk ia kisha parë ndonjëherë tjetër atë. Ishte një femër me flokë të lyer, me kërcinjtë e gjatë jashtë, që dukej sikur ishte mbërthyer mbi një palë këpucë me takë të larta dhe të trasha prej tape; gjoksin dërrasë e kishte zbuluar përgjysmë dhe kishte tri palë rruaza të mëdha përreth qafës së hollë dhe të gjatë. Qafë më të gjatë se ajo e asaj as kam parë, as do të shoh. «I është zgjatur, me sa duket, duke parë nga vrimat e çelësave, si patave që kërkojnë krimba në ujë... mendoja) I hapi derën, i vuri krahun dhe, duke përshtendetur me kokë ata që qenë ulur në tryezat mbi trotuar dhe që njeri pas tjetrit i ngrihen pak, sa luanin nga vendi, me një buzëqeshje të shtirë vesh më vesh, ai u fut në «Bar» dhe u ul në tryezën e rezervuar për të. Vendi ishte zgjedhur me kujdes. Edhe nga jashtë s'dukej, edhe që brenda e mbulonin shtyllat prej mermeri, me riska të gjata pasqyrash gjer në mes...»

Zoti Myrto nuk ishte ulur ende mirë te vendi, kur dëgjova zhurmën e motokarros së fabrikës së pijeve freskuese. Gër-gër zinxhiri, gër, gër... Më në fund ndaloi nja tri-katër hapa prapa veturës së zotit Myrto. Shoferi kishte hapur derën dhe po shfletonte një revistë të ilustruar. Çomja shkoi nga motori te karroceria, mori një kallëp akulli dhe, kur kaloi pranë shoferit, i shkeli synë buzëgaz. Pastaj u fut brenda. E përsëriti këtë nja katër a pesë herë. Pastaj mori dy kallëpë dhe, kur kaloi para veturës, zgjati kokën për të parë revistën. «Dale, ore, pa dale ta shohim një çikëzë atë bukuroshen që më qenka shtrirë ashtu safi, siç e ka bërë nëna...» Shoferi që e njihte, (se Çomja hynte e dilte në «Bar», si në shtëpinë e vet), ia tregoi: «E bukur, hë?.. «Për të bukura janë të bukura këto bushtra, s'ke ç'u thua! Uf, dreqi e hëngërt, se më rrëshqiti dhe për pak. Më ngrinë duart... Bobo!»

Ndërkaq kallëpët e akullit, njëri pas tjetrit, i rrëshqitën nga duart, njëri brenda, te këmbët e shoferit, tjetri nën maqinë.

Unë bëra sikur s'vura re fare. E kisha mendjen nga zoti Myrto. Po shoferin e dëgjova fare mirë kur i tha: «S'ka gjë, jo. Po atë që ra nën vete hiqe, se më pengon kur të nisem. Ti e di që zoti Myrto nuk duron dot kur vonohet në nisje».

Kaq ishte. Çomja u fut nën maqinë, vuri shpejt e shpejt minën me sahat që e kishte preqatitur vetë. Ia nxori fitilin te skapamentua që të mos dallohej tymi kur t'i vinte zjarrin dhe çoi brenda copat e akullit. Pastaj vajti mori edhe kallëpin që e nxori shoferi në trotuar. «Tani do të vete ta ngarkoj me gazoza. Apo të marr birra? Se kam për të sjellë edhe birra», i tha shoferit që kishte dalë jashtë dhe

e shikonte si i jepte levës me këmbë për të ndezur motorin.

— Sill ç'të duash, pash nderin, se na u tha goja... — i tha shoferi dhe, si mbeti përsëri vetëm ndanë trotuarit, u fut brenda e filloj të shfletonte përsëri revistat...

Kaq di unë. Se si e ndezi, se si shpërtheu dinamiti pikërisht në minutën e caktuar, se si u bë copë e çikë zoti Myrto me gjithë dashnoren, këtë e dëgjova më vonë, pasi erdhi dhe Çomja në batalion. Që atë natë mua më dhanë urdhër të hidhja dy nga ato bombat e Comes mbi urë dhe të dilja në mal... I bëri bukur fort ato mina ai. Se si e dridhte kular atë fitilin përbrenda e përjashta, se si e llogariste me aq përpikmëri, vetëm ai e dinte. Unë ua tregova një ditë rezervistëve të xhenjos që kishin ardhur për të bërë qitjen në poligonin tonë, s'më besuan...

Pipi: Eh, sa kemi për të mësuar ne nga përvoja e asaj lufte...

Dhe ngriti gjyzlykët xhamëhollë me gishtin tregues...

Sabiri buzëqeshi më gjatë se çdo herë që e kisha parë. Dhe m'u duk më i ri. Ç'them. M'u duk i ri, fare i ri, si atëhere...

— Epo, profesor... — tha dhe ngriti grushtin ushtarakisht...

## XI

### PÉRZIERJA E GJAKUT. . .

Unë nuk e dija, Çome, tani vonë e kam marrë vesh, se të shoqen e Sabirit, Dritën, ti e ke pasur komisare kompanie. Madje, as më kishte vajtur ndonjëherë mendja se ajo grua fytyrëmbël, me atë trup të brishtë, me atë të ecur të lehtë dhe me atë zë të shtruar do të kishte qenë dikur partizane e, aq më tepër, komisare. Ajo duket ende aq e re! Dhe tani që e kam marrë vesh, kur e shikoj, nuk më besohet. Kur e dëgjoj që flet për ty, të them të drejtën, më duket sikur i zbukuron pak bëmat e tua. E di pse? Se nuk e kam dëgjuar asnjëherë të thotë një të metë, prandaj. Madje edhe një herë që kujtova se më doli në shteg, ajo, me shumë takt, me atë buzëqeshjen e saj plot pastërti fëmijnore, me atë heshtjen e saj, me atë vështrimin e saj të përqëndruar, më shpëtoi... E di si ndodhi? Unë të thashë se në shkojmë te njëri-tjetri pa droje, se jemi dhe afër me shtëpi tani. Një pasdite, kur dola nga puna e po kthehesha në shtëpi, e pashë rastësisht Dritën te dyqani i ushqimeve

i blokut tonë. Kishte marrë një dy shishe verë. Sa më pa, që brenda nga xhamet më bëri shenjë me dorë ta prisja. Unë thashë se do të më jepte ndonjë porosi për ndonjë punë shoqërore (e kemi anëtarë të këshillit popullor) dhe po mendoja ndonjë shaka, t'i thosha se bëra gabim që s'ndërrova rrugë, ose ndonjë shaka tjetër nga ato që i kemi në majë të gjuhës, por ajo s'më la ta hapja gojën fare.

— Shih sa mirë! Sabiri të ka lënë në shtëpi një ftesë sa një çarçaf... Tani s'ke pse i ngjit shkallët... Eja me mua.

As që e kuptova ç'më tha dhe as që më vajti ndër mend pse po më merrte me vete, megjithëse buzëqeshja e saj dhe shishet e verës flisnin hapur për një ngjarje të gëzuar. E pashë ngultas dhe tunda kryet e hapa duart, siç pyesim pa fjalë në raste të tillë, kur gjendemi fare të papregatitur. Por ajo, me të njëjtin ton, jo dhe aq të zakonshëm për natyrën e saj të shtruar, vazhdoi:

— Asnjë fjalë! Sabiri të ka pregetitur një surprizë. Por, që të mos ndodhesh para të papriturash, po të jap vetëm një këshillë: Kujto tani, duke ngjitur shkallët, se kur e ke përvjetorin e martesës. Jam e bindur që Sabiri, për të fituar pikë, do të ta bëjë këtë pyetje.

Të të them të drejtën, fillova, si nëpër mjegull, t'i bija në të se ku e kishte fjalën, por asaj nuk i dhashtë të kuptonte dhe, ashtu kot, për t'i shtuar bukurinë lojës së tyre, i thashë:

— Moj Drita, e di ti që e kam harruar me të vërtetë vitin e martesës...

— Kujtoje, kujtoje! Se do të ndodhesh ngushtë...

— E po ç'të bëj unë tani?! Në këto prita që më keni ngritur...

As që arrita ta mbaroja mendimin. Te dera e hapur e apartamentit të tyre na priti Sabiri. U mënjanua, u përkul paksa, shtriu dorën përpara dhe bëri një nderim, si portierët e oborreve mbretërore në filma. Unë u habita me të vërtetë, kur e pashë atë alamet oficer serioz me llërë të përveshura dhe me një futë grash përpara, por e humba fare toruan, pasi hapa derën e kuzhinës dhe pašë time shoqë që po shtronte gotat e verës në tryezën e mbushur plot e përplot me meze...

Sabiri më zgjati llérën e përveshur (duart i kishte të lagura) dhe shkoi përsëri te lavapjata, ku kishte qenë kur na pa që u futëm me Dritën në shkallën e tyre. Po lante gotat. I biri i fshinte dhe ime shoqë i vendoste në tryezë... Bukur, besa! E qartë, çdo gjë e qartë. Ata festonin përvjetorin e martesës. «Vërtet, sa vjet ka i martuar Sabiri? A t'i dal përpara së priturës?» — thashë me vete, me të zhveshur pallton dhe i pyeta se në ç'vit ishin martuar.

Nëpër fytyrë Sabirit i rrëshqiti vegimthi që nga sytë gjer te mjekra një buzëqeshje si ajo te poligoni. Pastaj me një seriozitet të shtirë u afrua dhe, duke zgjatur dorën drejt një pjatelle me sallatë alaruse që ishte vendosur në mes të tryezës, më tha:

— Ne, i dashur, e kemi të fiksuar në dokumen-  
tin kryesor zyrtar të kësaj dreke me majonezë të  
pregatitur nga kjo koskë. Ju keni një çerek shekulli  
që e keni zhdukur analfabetizmin dhe mund ta lexo-  
ni pa gjyzlykë... Po, meqë më erdhët në shteg, më  
thoni, ju lutem, në praninë e shoqes Drita, të anë-  
tares së këshillit popullor, kur e keni festuar për  
herë të fundit përvjetorin e martesës?

Të gjithë po prisnin përgjegjen time, duke mbaj-

tur gazin që ngjallën fjalët e shumta të Sabirit dhe serioziteti i tij i shtirë.

— I dashur Sabir! Në shtëpinë time është zhdukur fryma e patriarkalizmit. Dokumentacionin e mban gruaja... Dhe kjo që bëni ju është e palejueshme: të mos i besosh gruas as larjen e gotave! Të mos i besosh gruas as preqatitjen e sallatës! Kjo është tmerrësisht e tmerrshme. Unë, në shtëpinë time...

Së qeshurës që shpërtheu i dha një vrull të ri ndërhyrja e sime shoqeje:

— Na hap ato shishe ti, atë bëj!

— Si urdhëron, grua!

Pas pak ra zilja dhe erdhi Pipi me gjithë të shqen.

Ishte vërtet një atmosferë e këndshme. Kuzhina e madhe, plot dritë, shkëlqente nga pastërtia. Në krye të saj, ndanë bufesë, një fotografi e madhe e shokut Enver. Ai kishte dalë duke ecur, me një tufë të madhe me lule të freskëta në dorën e majtë, ndërsa me të djathën përshtendoste ata që e prisnin. Kur e shihje ashtu, dukej krejt i gjallë e të lindte dëshira t'i hidheshe në krah...

Pipi, pasi u përshtendet me të gjithë, u ul. Nuk para e nxiste bisedën. Ashtu ka mbetur ai, paksa i mbyllur, siç ishte edhe atëhere, e di ti, po tani më dukej edhe i prekur. Edhe në divan nuk u fut ashtu thellë, siç e ka zakon ai, por ndenji buzë tij, me njerën dorë në kaptellin prej rimesoje, ndërsa tjetrën e mbështeti në gjunjë. Lëvizte pak. Rrallë, kur hidhte vështrimin nga Sabiri, që sa kishte filluar një punë tjetër përmbi sobën e bardhë elektrike, ngrinte me gishtin tregues gjyzlykët e tij xhamhollë dhe buzëqeshtë mendueshëm, si me një ngjarje të vjetër të fëmijërimendueshëm,

së. Dhe vetëm kur Sâbiri vari pranë sobës futën, shpërveshi mëngët, hodhi xhaketën ushtarake supeve dhe po bëhej gati të ulej, tha: «Ju falem nderit shumë për ftesën...» Dhe heshti. Dhe buzëqeshi prapë mendueshëm.

— Ju lutem, profesor... Nuk të kam thënë ty, Drita — iu drejtua ai së shoqes — që kam dhënë një provim me profesorin dhe nuk më njoju fare...

— Provim?! — ndërhyri Pipi. Dhe ngriti gjyzlykët me gishtin tregues. Dhe sytë e tij bojë bari filluan të lëviznin e të picërrroheshin prapa tyre. — Sikur nuk më bie ndër mend...

— S'keni faj, profesor, ka kohë... Organizohej atentati kundër...

— Lëre, m'u kujtua!

— Më keni detyruar t'ju përsërisja fjalët që do t'i thosha eprorit kur t'i raportoja të dhënët...

— E, Çomes!,

— Ku e dija unë atëhere, kush qe Çomja...

— Asnjë nuk e dintë, asnjë! Ai ishte thesar, (ç'them dhe unë). Ai ishte trimëria vetë, guximi, fisionikëria dhe zgjuarësia! Ç'djalë! Edhe sot në mëngjez e kujtova. Po prisja autobusin për të shkuar në universitet, kur filloj të rigonte një vesë shi. Nuk e prisja që të prishej moti: s'kisha marrë çadër me vete dhe vajta të mbroja...

— Kostumin — ndërhyri e shoqja duke qeshur.

— Jo, kostumin, grua, jo, po tullën se ne, që i kemi pak flokët të rrallë, jemi të ndjeshëm ndaj vesës — ia priti po me atë ton Pipi.

Të gjithë qeshën. Sabiri shfrytëzoi pushimin e shkurter, i mori leje Pipit dhe ngriti dollinë e parë...

— Profesor, vazhdo, profesor, se tek unë, vetëm pas pesë vjetësh do të gjesh meze të tilla. S'kam nge unë të rrash me pirun dy orë të tëra, pandërprerë, majonezën...

— Mos u mburr shumë, Sabir, se ka sallatë të gatshme...

— A, Drita, të lutem! Sallatë si kjo s'ka!

— Jo!

— Vazhdo, profesor, të lutem!

— Të vazhdojë, hë? Të pëlqen komplimenti, domethënë — ndërhyri më shkathësi Drita, ndërmjet të qeshurave tonë.

— Po jo, moj grua! Unë i them të vazhdojë tregimin...

Drita mbushi përsëri gotat dhe, në heshtjen që u krijua nga kjo, filloi të tregonte përsëri Pipi.

— Siç ju thashë, vajta nën një shkallë te pallati prapa stacionit të autobusit. Nuk është ngritur ai gjashtëkatëshi i ri tanë, atje ku që hoteli i vjetër? Në një shkallë të atij pallati u futa. Po i shikoja shkallët, se më bëri përshtypje pastërtia, dukej sikur porsa ishin lyer dhe më vajtën sytë te një dërrasë mermeri, ku ishin gdhendur këto fjalë:

«Këtu, në këtë vend, më 16 nëntor 1944, një ditë para çlirimtë të Tiranës, kanë rënë për lirinë e popullit... Poshtë emrat. Katër shokë dhe një shoqe. Dy prej tyre i njoha...

— U, mami! Atje përballë bunkerit, ku keni luf tuar dhe ju me babin — ndërhyri në bisedë djali i vogël i Sabirit...

Drita: Ai ishte lubi, sishte bunker! Ai përpinte si përbindësh përrallor çdo gjë që i dilte përpara... Dhe vetë qëndronte edhe përballë antitankut, edhe

përballë bombave. Qëndronte ashtu, me sy të skuqur e të përgjakur, ditë e natë zgjuar... Se e dinte që, edhe një copë herë po të dremiste, do të flinte gjumin e madh... Ah, ai bunker! Dhjetë ditë rresht sfidoi edhe vullnetin, edhe guximin, edhe trimërinë, edhe zgjuarësinë e Çomes, të xha Brahos, të Lirisë... Ndërtesar e Lagjes së Vjetër ranë njëra pas tjetrës. Morëm urdhër të çlironim Lagjen e Re. Shtëpitë e para, duke luftuar kat më kat e dhomë më dhomë, i zumë. Gjermanët tërhiqeshin... Po ato dhjetë ditët e fundit u futën në bunker. Dhe s'lëviznin. Edhe për t'i furnizuar vinin u sillnin ushqime e municione dy tanke. Njërin prej tyre e dogji Çomja me benzинë. I hodhi njerën pas tjetrës dy shishe. Pastaj mori një shkop, në majën e të cilit kishte mbështjellë një top zifti, e ndezi dhe ia hodhi përsipër nga dritarja kur ai kaloi pranë për të furnizuar bunkerin. Kështu deshi të digjte edhe bunkerin ai, por nga ndërtesa që kishim kapur ne nuk arrinin shishet as në mes të udhës. T'i afroheshe s'të linin mitralozët. Vendi rrreth tij qe i zhveshur. E provoi një herë Sabiri vetë me shishka të vogla. Se ato hidheshin më larg. Po ku donte t'ia dinte ai nga benzina e tyre... Çomes i vinte plasja. Kërkoi leje të zvarrisej në rrugë gjer afér tij. I tha Sabirit: «S'vdes unë, pa e djegur atë. Dhe në vdeksha, ia vlen barra qeranë. Ne s'do ta lëmë Tiranën pa çliruar...» Por Sabiri nuk e lejoi as atë, as xha Brahon, që i tha: «E, a rrënjjedalë, ç'më kursen, se nuk do të rroj gjithë jetën, i mbusha të gjashtëdhjetat unë... Për Çomen, po, mirë e ke, se është i ri ai, pa për mua kot e ke...»

Sabiri: Kishin zgjedhur pozicion të mirë, derrat! Bunkerin do ta kishim djegur me kohë, se do të zvarriteshim gjer atje, do t'ia gjenim anën, po s'na

linin mitralozët që kishin vendosur në ballkonet dhe dritaret e hotelit, kundrejt ndërtesës së fundit ku ngelëm ne...

Drita: Prandaj të propozoi edhe Çomja ty që të merrnim atë godinë një herë...

Sabiri: Qe vërtet pozicion i keq. Rreth i mbyllur. Pa marrë hotelin, s'digjej dot bunkeri. Pa djegur bunkerin, as që mund të ëndërroje për të marrë hotelin...

Drita: Po Çomja ia gjeti çelësin... Në lagjen e Vjetër, që në kohën e italianëve kishte mbetur një autoblindë e prishur. Kishte mbetur në një kopësht, ku qenë futur italianët për të rrëthuar nga dy anëtarë të një njësiti guerril ato ditë që kishte kapitulluar Italia dhe as që i kishte vajtur mendja njeriu për të. Ato ditë, kur luftonim atje, Çomja i kishte hipur nga dy a tri herë. Ne kujtonim se vente e flinte, (kështu thoshte xha Brahoja, kur e zëvendësonte në barrikadë te mitralozi) ndërsa ai seç ngatërronte me hekura. Një ditë se nga gjeti edhe ca benzinë dhe e ndezi. Mirëpo ne atë natë sulmuam, i prapsëm gjermanët shumë, gjer te ndërtesa përballë bunkerit dhe s'kishim kohë të mendonim për autoblindën. Një mbrëmje Çomja më vjen në pozicion (unë isha mbështetur ndanë një dritareje në kat të dytë) dhe më thotë: «Shoqja zëvendëskomisare! Bisedo, të lutem, me komandanatin e kompanisë ta lejojë skuadrën time për të sulmuar hotelin. Kam menduar një plan. Do t'i çoj që prapa me autoblindë... Pesë e nga pesë. Gjer në mëngjez hoteli është në duart tonë.» «Po kush do ta ngasë autoblindën, more Çome — i thashë. Ne edhe Frederikon që kishim, na u vra!» «Thuaj komendantit ti, pa e zgjidh unë atë punë!» «Të kujtohet, apo jo?» — dhe Drita u drejtua nga i shoqi.

Sabiri: *Si nuk më kujtohet!*

Drita: *Veç ta shihnit si i shkëlqyen sytë, kur i thashë se qemë dakord. Veç për një gjë mezi e binda. S'donte ta merrte Lirinë më vete. Liria u fye... Nejse, u bind më në fund...*

Unë hodha sytë nga Drita. Atë e kishin rrëmbyer tanimë kujtimet. Të them të drejtën, për herë të parë i dhashë asaj gruaje fytyrëmbël më shumë vjeç nga ç'ishte. Ajo dukej vërtet në këto çaste afër të pesëdhjetave. Drita që i binte kundrejt, për çudi, ia thellonte më tepër vijat midis tipareve të saj të rregullta: dy rrudha midis vetullave, dy të tjera ndanë hundës së drejtë. Ato zbrisnin gjer poshtë ndanë buzëve me vija të theksuara e dukeshin sikur kishin ngelur e s'çanin dot më në pjesën e poshtme, midis faqeve të mbushura e mjekrës së rrumbullakët që shprehte sa butësi, aq edhe vullnet e këmbëngulje.

Dhe unë, fare pa sukses, desha të thyeja hesh-tjen:

— Jam kurreshtar të di, si do të reagonte Çomja sikur të shihte Sabirin me futë... Ai s'duronte dot kur e kritikonin femrat... Kush më tha se jua kish-te prerë juve një herë: «Në ka vërejtje komanda përmua, jam gati t'i paraqitem në raport komandantit, s'kam nevojë për këshilla shoqërore». Ndërsa xha Brahos i kishte thënë: «Qenka e rëndë, xha Braho, më e rëndë se mitralozi i rëndë, kur të komandojnë femrat...»

Sado që e stërzgjata, sado që e shoqërova këtë bisëdë me buzëqeshje të vazhdueshme, as zgjatja, as buzëqeshja nuk e mbuluan dot mungesën e taktit... Drita, sidomos, nguli sytë diku ndanë bufesë dhe vazhdoi të heshtte. Vetëm Pipi, më shumë për mirë-

sjellje, si për të mos më lënë vetëm në atë atmosferë që krijova rrëth vetes, pasi i ra dy-tri herë tryezës me gishta, si për t'i dhënë një të shtyrë në humnerë asaj heshtjeje, tha:

— Vështirë do ta kishte dhe ai, natyrisht —  
dhe ngriti gotën e verës... — Gëzuar!

Dhe, ndërsa ata pinin, mua më dole para syveti, ashtu si të kam njohur atëhere... Dhe vjeçët e mi u rrëzuan si mur i ndonjë karakatine, e unë mbeta përsëri para teje më i vogël, ndërsa ti u ngrite lart më i pjekur, më serioz, më mendjembledhur, si atëhere, kur më the: «Mos u tall, dëgjon? Mos u tall! Ç'kujton ti se është lufta jonë?...» E prapë një ndjenjë zylie, një ndjenjë që nuk e kisha provuar prej disa dekadash më pushtoi të gjithin. U përpoqa të të përfytyroja edhë një herë të rritur, të martuar rrëth asaj tryze, po ishte e pamundur. Mua dhe vetja m'u duk i vogël, pa takt, i papjekur... Ku vanë vitet e mia, ku? Ku vajti përvoja ime, ku? Pse, gjithë jetën kështu do të më shikosh mua ti, nga lart poshtë? Ah, Çome, Çome! Edhe një të metë të tillë, kaq të zakontë për brezin tonë, s'guxojmë të ta veshim ty sot. Vëllaçkë, sa lart që më je ngjitur!

U përpoqa ta merria veten, u përpoqa të hyja prapë në bisedë, por ishte e pamundur. Unë isha i shtrënguar të rrija tanë ashtu, i topitur si atëhere, kur nuk e ndjeja mbi supe barrën e këtyre viteve që më ka ngarkuar koha, pasi jemi ndarë... (Ç'them dhe unë!?. Po ku ta gjej atë fjalë, që të shpreh me saktësi këtë që ka ndodhur me ne?! Ku ta gjej? Një fjalë e tillë mungon! Një fjalë të tillë do ta shuanë populli me nervozizëm, edhe sikur t'i tekej ndokujt ta trillonte...)

Jo, më mirë unë po rri, po hesht, po dëgjoj me admirim, si atëhere, kur dritaret e qytetit u tronditën nga ato dy shpërthime që buçiten vërtik, njëri pas tjetrit, si dy gjëmimet e para të shtrëngatës së parë në verë... Si atëhere kur gjithë qyteti fliste për ty...

*Drita:* Gjermanët u vunë midis dy zjarreve. Skuadra e Comes pushtoi katin e parë dhe një pjesë të korridorit të katit të dytë.

*Sabiri:* Fundin e «L»-së; siç thoshte Çomja, se korridori kishte një kthesë në formën e gërmës «L»... Atë e përforcuan shpejt e shpejt me thasë rëre... Të tmerrshëm ishin, s'ke ç'u thua!

*Drita:* Po edhe asaj barrikade ia gjeti anën Çomja. Mbi korridorin e shkallëve të katit të dytë, në bisht të «L»-së, kishte në tavan një baxha. Iu lut xha Brahos dhe një tjetri, nuk më kujtohet mirë se kujt, që të qëndronin më këmbë dhe ai t'i qepej baxhasë. Një këmbë në parvaz të shkallëve, një mbi supet e xha Brahos, e hapi baxhanë dhe u ngjit lart. Gjermanët brenda! Vajti një herë pa vendin. Pastaj erdhì kërkoi shishet me benzinë dhe iu ngjit çatisë. Vërviti njerën pas tjetrës tri shishet plot mu mbi kubenë e bunkerit. Ne shikonim nga ndërtesa kundrejt se si u reflektua drita e zbetë e hënës mbi kokën tullace të lubisë. Pastaj një të ndezur shkopin me zift dhe e hodhi. Po do ti, për dreq, zifti nuk arriti i ndezur. U shua rrugës, gjatë fluturimit. Çomja hoqi nga brezi njerën pas tjetrës dy bomba. Flaka bëri të llamburitnin edhe tjegullat e hotelit, ku po tërhiqej i përkulur me atë trupin e tij të hellë e të gjatë si lastar... *Mirëpo, me të arritur te baxhaja, ndjeu krisma.* Gjermanët, që kishin dashur ta braktisin hotelin, kishin ndeshur në korridorin e shkallëve me majën e belxhi-

kut të xha Brahos. Njëri ishte shtrirë shakull në këmbët e tij. Dy të tjerët po afroheshin duke qëlluar me automatik. Çomja, me t'i parë, qëlloi njërin me revolver. Tjetri, i lebetitur, u kthyte përsëri nga kishte ardhur... Ndërkaq Liria, që ruante hyrjen, la përposh dy partizanë duke luftuar dhe erdhi të njof-tonte skuadërkomandantin se kishin ardhur përforcimë të reja që donin të hynin brenda. U ndez nëpër shkallë një luftë e ashpër...

Sabiri dha urdhër që të hidhej në sulm gjithë kompania për të marrë hotelin. Edhe gjermanët u ndodhën midis dy zjarreve. Jashtë ne. Në katin e parë ata, në shkallë dhe në një pjesë të katit të dytë Çomja me Lirinë, xha Brahon e plagosur rëndë dhe me dy-tre shokë të tjerë. Keq të qëllonim, keq të hesht-nim. Kishim frikë mos vrisnim tanët. Gjermanët dërguan përforcime të reja. Ne u angazhuam me prapsjen e tyre. Edhe ne, gjithë kompania u vumë midis dy zjarreve. Na erdhën nga batalioni përforcime të reja. Gjermanët që ishin jashtë, u tërhoqën në një ndërtesë pranë. Ata që ishin brenda luftonin shkallëve me Çomen dhe pjesëtarët e skuadrës së tij. Xha Brahoja po humbiste gjak. Çomja vendosi Lirinë në krye të shkallëve, mori xha Brahon në kra-hë dhe e futi në një dhomë për t'i lidhur plagët. Kur u kthyte, e gjeti edhe Lirinë të plagosur. Dy shokë po luftonin. E mori edhe Lirinë në kra-hë dhe e çoi te xha Brahoja. Kur arritëm ne, pamë që xha-kaventoja i qe lyer me gjak. Gjakut i Lirisë, gjaku i xha Brahos... Apo ishte i plagosur edhe vetë. Aty, në krye të shkallëve, mbështeti kryet te gjunjët dhe më tha: «Kujdes! Kujdes Lirinë dhe xha Brahon! Në dhoma ka ende gjermanë! Njëri më qëlloi tani që pra-

pa... Po veç të hidhet nga ballkoni, se s'ka ku të  
vejë, qeni! Hoteli është yni...»

Dhe gjermani i fundit u hodh me të vërtetë  
nga ballkoni. Hapi krahët dhe u hodh, duke bërtitur,  
me automatik në dorë, sikur do të kapërcente ndonjë  
hendek. Një partizan, i nxehur për humbjen e Çomes,  
e shoqëroi në fluturim me një breshëri automatiku.  
Lebetitjet pushuan dy méttra përpëra se të përplas-  
sej përposh në trotuar.

Luftrimet vazhduan gjithë natën. Të nesërmen,  
në Tiranë shihje vetëm koloni ushtarësh gjermanë  
me xhaketa të zberthyera, me kopsa të këputura, me  
duar të lidhura. Ndonjëri hiqte zvarrë këmbën e pla-  
gosur dhe shikonte me egoizëm kufomat e ish-bashkë-  
luftëtarëve të tij të vrarë ndanë trotuarëve; u shi-  
konte ftyrat që kishin filluar t'u enjteshin dhe i gë-  
zohej plagës. Në fund të fundit kështu ishte më  
mirë. Logjikë e vjetër e ushtarëve të pandërgjegj-  
shëm: më mirë të mundur, se sa të vdekur... Po  
kush kishte kohë të merrej me ta? Ne filluam prega-  
titjet për parakalimin e fitores: në Tiranë, nga ora  
në orë, pritej të hynte qeveria jonë.

P È R M B A J T J A

Faqe

I. Kujtime, kujtime .....	5
II. Dardha e priftit .....	11
III. Largimi nga fshati .....	15
IV. Uratë, më huaj navllon .....	19
V. «Ty të mbajkan erë edhe fjalët, moj qirickë» ..	31
VI. «Sa paska si ne!» .....	37
VII. ABC.-ja .....	45
VIII. ... ne hymë në valle .....	64
IX. Ku vajti Pipi? Ku u zhduk xha Brahoja? .....	80
X. Ama, tani që piva ujë në «Gurrëzën» e lirisë, ore!... .....	95
XI. Përzierja e gjakut .....	116

Redaktor SAMI ÇABEJ  
Kopertina SAFO MARKO

Tirazhi 8.000 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204 - 72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974